



ISBN 978-9928-210-22-7

ISSN 2413-1334

Konferenca VII Shkencore Ndërkombëtare



Policimi dhe **SIGURIA**

Kërkimi shkencor dhe siguria publike

MAJ
2022

PROCEEDINGS
Botim i Akademisë së Sigurisë, Tiranë 2021

KONFERENCA VII NDËRKOMBËTARE

Kërkimi shkencor dhe siguria publike

Ky botim është pjesë e aktiviteteve të Projektit të Binjakëzimit, financuar nga BE,
“Për forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë”, 18 IPA JH 01 19



This project is funded
by the European Union

© - Akademia e Sigurisë, Tiranë.

Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ripublikohet, modifikohet, shpërndalet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje penale të së drejtave të autorit.

Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Policinë e Shtetit dhe Arsimin e lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve gëzojnë liri të plotë akademike, me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, ata të zbatojnë të gjithë legjislacionin përkatës si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme. Autorët janë të vetëdijshëm dhe mbajnë përgjegjësi individuale lidhur me problemet e plagjiaturës. Çdo shkelje në këtë drejtim i ngarkon ata me përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Akademia e Sigurisë
Kërkimi shkencor dhe siguria publike : konferenca V
ndërkombëtare / Akademia e Sigurisë. –
Tiranë : Akademia e Sigurisë, 2022
170 f. ; 16.5X24cm.
ISBN 978 - 9928 - 210 - 22 - 7
1.Kërkime shkencore 2.Siguria 3.Konferenca
001.8(062)

NR 25

MAJ

2022

BORDI EDITORIAL

Kryetari i Bordit

Prof. Asc. Dr. Xhavit SHALA

Anëtarët e Bordit

Prof. Dr. Ilirjan MANDRO

Prof. Dr. Ismet ELEZI

Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI

Prof. Dr. Giovanni ARCUDI

Prof. Dr. Laura TAFARO

Prof. Asc. Dr. Snezana MOJSOSKA

Prof. Asc. Dr. Bejtush GASHI

Prof. Asc. Dr. Zaho GOLEMI

Prof. Asc. Dr. Idriz HAXHIJA

Dr. Frank HARRIS

Dr. Albert HITOALIAJ

Dr. Adnan XHOLI

Redaktor shkencor

Dr. Albert HITOALIAJ

Punimet grafike

MP Andi OSMANI

Realizimi teknik

Qendra Kërkimore Shkencore,
Akademia e Sigurisë

AKADEMIA
E SIGURISË

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»



**AKADEMIA E SIGURISË
QENDRA KËRKIMORE SHKENCORE**

KONFERENCA VII SHKENCORE NDËRKOMBËTARE
"KËRKIMI SHKENCOR DHE SIGURIA PUBLIKE"

Në bashkëpunim me:

Projektin e Binjakëzimit, financuar nga BE, "Për forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë", 18 IPA JH 01 19, Akademinë e Shkencave, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Akademinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë

Akademia e Sigurisë, organizoi
konferencën VII shkencore ndërkombëtare: "Kërkimi shkencor dhe siguria publike".

26 prill 2022, Tiranë

Përmbajtja

SESIONI I PARË

Kërkimi shkencor dhe siguria publike
(këndvështrimi dhe përvoja shqiptare)

Dr. Bilbil MEMAJ

Drejtor/Rektor i Akademisë së Sigurisë (AS)

“Kërkimi shkencor dhe siguria publike” – kontributi i Akademisë së Sigurisë10

Prof. asc. dr. Xhavit SHALA

Drejtori i Qendrës Kërkimore Shkencore, AS

Kërkimi shkencor dhe siguria publike: eksperiencia e QKSH-së, arritje dhe sfida.14

Prof. asc. dr. Bejtush GASHI

Dekan i Fakultetit të Sigurisë Publike, Akademia e Kosovës për Siguri Publike

Modeli i kërkimit shkencor në AKSP, Kosovë36

Znj. Mirela MUÇA

Drejtoreshë e Përgjithshme, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Mbështetja e AKKSHI-t për projektet e kërkimit shkencor në fushën e sigurisë publike. 42

Prof. dr. Irakli KOÇOLLARI

Drejtori i Projekteve, Akademia e Shkencave

Bashkëpunimi me institucionet simotra të kërkimit shkencor, një kërkesë dhe nevojë për të garantuar më tej sigurinë publike 44

Dr. Albert HITOALIAJ,

Shefi i sektorit të botimeve, QKSH, AS

Domosdoshmëria e botimeve shkencore në fushën e sigurisë publike 48

Prof. asc. dr. Zaho GOLEMI,

Shefi i sektorit të kërkimit shkencor, QKSH, AS

Kërkimi shkencor dhe institucionalizimi në AS (nga tradita e kërkimit shkencor në Shqipëri te ajo në AS) 54

SESIONI I DYTË

Kërkimi shkencor dhe siguria publike
(këndvështrimi dhe përvoja finlandeze)

Dr. Vesa MUTTILAINEN

Shef i sektorit të kërkimit shkencor, Kolegji Universitar i Policisë, Finalndë
Kërkim, zhvillim dhe inovacion në Kolegjin Universitar të Policisë (POLAMK)68

Dr. Mika KARJALAINEN

Shef i sektorit të kërkimit shkencor, Kolegji Universitar i Policisë, Finalndë
dhe,

Dr. Anna-Liisa OJALA

Kërkuese shkencor, Universiteti i Shkencave të Aplikuara (JAMK), Finalndë
Elementet thelbësore të të nxënës, në trajnimin e sigurisë kibernetike.74

Dr. Tiina KOIVUNIEMI

Kërkuese shkencore, Kolegji Universitar i Policisë, Finalndë
Këshilltar Rezident i Binjakëzimit (RTA)

Projekti i Binjakëzimit "Forcimi i kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë": Një fillim i shkëlqyer për bashkëpunimin ndërkombëtar për kërkim dhe zhvillim78

Dr. Vesa HUOTARI

Studiues i lartë, Kolegji Universitar i Policisë, Finlandë
Efektiviteti i zbatimit të ligjit të trafikut86

CONFERENCE PAPERS (ENGLISH)

PhD. Bilbil MEMAJ

Director/Rector of the Security Academy
"Scientific research and public security" - contribution of the Security Academy94

Prof. Assoc. PhD. Xhavit SHALA

Director of Scientific Research Center at the Security Academy
Scientific Research Center experience, achievements and challenges.98

Prof. Assoc. PhD. Bejtush GASHI

Dean of the Faculty of Public Safety, KAPS
The model of scientific research at the Kosovo Academy for Public Safety.120

Mrs. Mirela MUÇA

General Director, National Agency for Scientific Research and Innovation (NASRI)
National Agency for Scientific Research and Innovation (NASRI) and public security126

Proff. PhD. Irakli KOÇOLLARI

Director of Projects, Academy of Sciences, Albania
Cooperation with similar institutions of scientific research, a request and need to further guarantee public safety128

PhD. Albert HITOALIAJ
Head of Publication Sector, Scientific Research Center, Security Academy
The importance of scientific publications in the Security Academy..... 132

Prof. assoc. PhD. Zaho GOLEMI
Head of the Scientific Research Sector, Scientific Research Center, AS
Scientific Research and its institutionalization in the Security Academy 138

PhD. Vesa MUTTILAINEN
Research, development and innovations at the Police University College, Finland
Research, development
and innovations at the Police University College. 148

PhD. Mika KARJALAINEN
Researcher, Finnish Geospatial Research institute (FGI), Finland
PhD. Anna-Liisa OJALA
Senior Advisor at JAMK University of Applied Sciences, Finland
Important learning elements in cyber security trainings.154

PhD. Tiina KOIVUNIEMI
Researcher, Police University College, Finland
Resident Twinning Advisor (RTA)
Twinning-project “Strengthening the Capacities and Efficiency of the Security Academy”:
An excellent start for international R&D cooperation 158

PhD. Vesa HUOTARI
Senior researcher, Police University College, Finland
Research, development
and innovations at the Police University College. 164



~ *Sesioni I* ~

Kërkimi shkencor dhe siguria publike
(këndvështrimi dhe përvoja shqiptare)

“Kërkimi shkencor dhe siguria publike” – kontributi i Akademisë së Sigurisë



Drejtues i Lartë Dr. Bilbil MEMAJ
Drejtori/Rektori i Akademisë së Sigurisë

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emrin e Akademisë së Sigurisë së Shqipërisë, të bëj hapjen e kësaj konference me temë: “Kërkimi shkencor dhe siguria publike”. Që në fillim të fjalës time dua të theksoj se shoqëritë dhe organizatat që shërbejnë për to, në çdo aspekt të jetës, gjenden në proces ndryshimi; ky tashmë nuk është thjesht një nocion filozofik por është thujse një ligjësi. Detyra jonë është të studiojmë, hulumtojmë dhe zbulojmë rrugët më të mira në interes të këtij ndryshimi pozitiv. Edhe siguria publike si një shërbim jetik ka zhvillimin dhe ndryshimin e vet duke u përpjekur të zgjidhi problemet dhe sfidat me të cilat ndeshet shoqëria në këtë kohë të globalizmit dhe zhvillimit shumë të vrullshëm të teknologjisë.

Rrugët e zgjidhjes të këtij procesi gjatë gjithë historinë e është kërkuar dhe i kërkohet shkencës, si e vetmja qasje e efektshme dhe bindëse për shoqërinë. Në drejtim të sigurisë publike si pjesë edhe e sigurisë kombëtare veprimtaria e kërkimit shkencor duhet të jetë permanente, është një shërbim kaq jetik sa nuk mund t’i lihet projekteve dhe vetëm personave të shkëputur që mund të japin kontribut për pasion ose në zbatim të një projekti spontan. Kërkimi shkencor duhet të bëhet së pari nga akademitë e sigurisë, nga institucionet e tjera shkencore dhe përgjegjëse për inovacionin në Shqipëri, të koordinuara dhe udhëhequr këto nga Akademia e Shkencave.

Për sigurinë publike duhet një paketw e cila në thelb, do të jetë siguria për mbrojtjen e jetës së qytetarëve, pasi është krijuar përshtypja që për sigurinë e brendshme apo atë publike kemi Policinë e Shtetit, e cila vërtet është institucioni më i rëndësishëm për sigurinë e rendit dhe për goditjen e kriminalitetit, por siguria nuk mund të arrihet vetëm me policinë, për të kërkohet pjesëmarrja e shoqërisë. Ne nuk mund të neglizhojmë pasigurinë për jetën nga fenomene të cilat nuk janë të dukshme të rendit dhe të raportojmë që kemi siguri të kënaqshme sepse krimet kundër jetës nuk janë shtuara bazuar sipas statistikave. Siguria publike sot është e kërcënuar nga krimi, ai i Organizuar apo krimet në volum, nga korrupsioni, nga krimet mjedisore e shëndetësore, pasiguria nga ushqimet, nga pasiguria nga lëngjet, nga pasiguria kibernetike, pasiguria në transporte rrugore ajrore e detare, nga pasiguria në punë etj.

Të gjitha këto fusha të sigurisë nuk mund të zhvillohen pa dije dhe njohuri shkencore dhe po e theksoj se në të gjitha këto fusha mund të hulumtohet nga të gjithë disiplinat shkencore që përbëjnë shkencën aplikative të sigurisë publike. Këtu kërkohet kontributi i të gjithëve jo vetëm i policisë.

Për policimin, si kryefjala e sigurisë, më lejoni të nënvizoj se jemi duke përsosur filozofinë e policimit në komunitet si filozofia më rezultative deri tani në procesin e policimit. Në këtë drejtim, nevojitet që të ketë një zhvendosje filozofike dhe metodologjike, lidhur me mënyrën se si duhet të zhvillohet policimi në të ardhmen. Kjo nuk mund të arrihet pa përpunuar format e reja të policimit ku akademia ka dhe do të ketë objektin e saj të punës. Nga ana tjetër, duhet të ketë një filozofi se si mund të përdoren metodat kërkimore shkencore të orientuara, të policisë, nga komuniteti. Kjo do të krijonte një mënyrë të re për vlerësimin e përparimit dhe efektivitetit të punës së saj me qytetarët të cilëve policia u shërben. Kjo që po sjell në plan të dukshëm, është nevoja e një avancimi në drejtim të kërkimit shkencor në polici, me qëllim që shërbimi ndaj komunitetit, të ofrohet edhe në këtë mënyrë. Me anë të punimeve kërkimore, projekteve, studimeve, hulumtimeve të orientuara edhe drejt nevojave të komunitetit. Kërkimet do i shërbenin policisë në vetvete për qëllimet e saja kërkimore, por edhe shoqërisë në tërësi. Për këtë gjë nevojitet që të fuqizohet aspekti kërkimor në polici dhe të hidhen hapat të tjerë para, si dhe të fuqizohet bashkëpunimi me institucionet kërkimore të arsimit të lartë e jo vetëm.

Akademia e Sigurisë mund ta çojë akoma më tej këtë rrugë të kryer deri tani në drejtimin e kërkimit shkencor. Shembulli i aktivitetit kërkimor të realizuar përmes Qendrës së Kërkimeve Shkencore të Akademisë së Sigurisë, ka rezultuar pozitiv. Botimi i njëzetekatër numrave të revistës “Policimi dhe siguria” dhe realizimi i gjashtë konferencash ndërkombëtare e dy konferencash të spikatura kombëtare, janë tregues real i punës së kryer. Këtyre treguesve u duhen shtuar edhe projektet e realizuara dhe projekti i fundit me AKKSH-in. Gjithashtu janë realizuar edhe një sërë aktiviteteve trajnuese për rritjen e kapaciteteve kërkimore në institucionin e Policisë së Shtetit.

Eksperienca e botimeve të punimeve të konferencave shkencore të realizuara nga AS-ja, ka hedhur hapin e parë në këtë drejtim. Mjafton të përmendim këtu se tema të tilla si: siguria kibernetike, siguria mjedisore, vetëvrasja, arsimimi në fushën e sigurisë, terrorizmi, narkotrafiku, drejtësia etj., prekin gjithë shoqërinë. Qasja që është bërë përmes punimeve shkencore që ne kemi botuar si akademi, është një qasje e cila duhet të zgjerohet në të ardhmen, me qëllim që policia të ketë një rol më të gjerë në kërkimin shkencor. Nëse ka diçka për të cilën duhet të jemi të vetëdijshëm dhe të kënaqur që ka ndodhur, është pikërisht shembulli që ka dhënë QKSH-ja, e cila sjell shembullin më të

mirë se si mund të kalojmë nga policimi në komunitet te kërkimi shkencor policor për interesa të komunitetit, me qëllim final, transformimin e policisë në një polici moderne dhe të pëlqyer nga qytetarët. Qasjet e reja organizative të policimit bashkëkohor mund të jenë:

- policimi ligjor;
- policimi në komunitet;
- Policim orientuar nga problemi (POP);
- policim kompas;
- policimi i udhëhequr nga intelijenca;
- policim i zgjuar (*smart policing*);
- policimi asimetrik;
- policimi parashikues;
- policimi hard dhe soft;
- e-policing (policimi digjital).

Këto metodologji te reja policimi të përdorura nga kolegët tanë në vende të tjera na angazhojnë ne për të përgatitur teorikisht në kushtet dhe specifikat që ka shoqëria shqiptare, për t'iu qasur metodave të tilla rezultative. Punimet shkencore në këtë drejtim duhet të jenë atribut i kërkuesve shkencor jo vetëm të policisë, por edhe të shkencave sociale, psikologjike, juridike, kompjuterike etj.

Këtyre pikave duhet t'u shtojmë edhe zgjerimin e aktivitetit të AS-së si institucion i cili formon e trajnon punonjës nga agjenci të tjera shtetërore të fushës së sigurisë. Zgjerimi i aktivitetit të AS-së çon detyrimisht edhe në zgjerimin e njohurive dhe domosdoshmërisht në zgjerimin e dimensionit të kërkimit shkencor. Akademia ka mundësinë që të jetë një institucion lider në fushën e kërkimit shkencor në Shqipëri, pasi interesat që mbulon arsimimi që ajo ofron dhe misioni që ka janë shumë të gjera dhe prekin shumë rrafsh të organizimit e aktivitetit shoqëror kombëtar.

Para thujtjes së vitit të ardhshëm, në vitin 2015, Akademia e Sigurisë filloi botimin e një reviste shkencore, të titulluar "Policimi dhe siguria" dhe sot me kënaqësi mund të shprehem se kjo shënon një arritje të Akademisë dhe pse jo, edhe të Policisë Shqiptare. Natyrisht, shtatë vjet janë pak për një revistë, për ndërtimin e një tradite, por materialet e botuara në të janë një set dijes për punonjësit e policisë dhe jo vetëm. Në këtë moment ne mund të shprehemi se akademia tashmë ka krijuar një profil të saj botimesh e konferencash, të qëndrueshëm të lexuesit e vet. Botimi në tërësi, sidomos botimet shkencore në veçanti, janë një sfidë për ata që angazhohen në këtë drejtim.

Të shkruash është sfidë për individin, por të botosh është sfidë për botuesin apo institucionin që e merr përsipër. Pavarësisht të gjitha vështirësive, mungesave apo mangësive që mund të kemi, sfida e Akademisë së Sigurisë, si institucioni që kontribuon për kërkimin shkencor në Shqipëri, mendoj se është përballuar me sukses. Besoj se kemi lënë një gjurmë serioze të punës sonë. QKSH-ja dëshmon për një përpjekje të dukshme për ndërtimin e një hapësire ku të diskutohet mendimi shkencor policor.

Gjithashtu, kam qenë mbështetës i hershëm i zgjerimit të botimeve periodike shkencore në gjuhë të huaj dhe i ambicies që kemi pasur si institucion për realizimin e një reviste rajonale, ndërkombëtare, shkencore që të trajtojë sfidat të shumta të sigurisë publike. Janë projekte që do të realizohen në të ardhmen, por është e sigurt që ne duhet t'i japim më shumë hapësirë analizave në gjuhë të huaj, pasi edhe nevoja për informacion

dhe shkëmbim mendimi mes ekspertësh ndërkombëtarë, sa vjen e rritet.

Jam i bindur se edhe konferenca e sotme do të jetë një kontribut në drejtim të kërkimit shkencor në fushën e sigurisë publike!

Kërkimi shkencor dhe siguria publike: eksperienca e QKSH-së, arritje dhe sfida



Drejtues i parë, prof. asc. dr. dr. Xhavit SHALA
Drejtor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore, Akademia e Sigurisë

Qendra Kërkimore Shkencore me qëllim mbledhjen, përpunimin dhe zhvillimin e mendimit të kualifikuar shkencor në fusha të caktuara që përbëjnë interes për Akademinë e Sigurisë, Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme, për përballjen me rreziqet dhe kërcënimet për sigurinë nga forma të ndryshme të kriminalitetit bashkëkohor, ka organizuar me sukses nëntë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjithashtu QKSH realizon botime shkencore për finalizimin e punës së saj kërkimore-shkencor si dhe shpërndarjen e njohurive shkencore jo vetëm për punonjësit e organizatës policore por dhe për një komunitet shumë më të gjerë. Këto botime janë të karakterit shkencor, të regjistruara sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Vetë revista shkencore “Policimi dhe siguria” është organ periodik, teoriko-shkencor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore të Akademisë së Sigurisë, ofron një platformë studimore, debati shkencor e profesional për studiues të ndryshëm, brenda organizatës së Policisë së Shtetit dhe më gjerë. Në analizën SWOT, të veprimtarisë së kësaj qendre, realizuar nga projekti i BE-së “Forcimi i Kapaciteteve dhe Efikasitetit të Akademisë së Sigurisë - Shqipëri, AL 18 IPA JH 01 19”, lidhur me elementet që përbëjnë fuqinë e kësaj strukture, ka rezultuar se QKSH (Qendra Kërkimore Shkencore) ka krijuar një eksperience pozitive 7 vjeçare në drejtim të kërkimit shkencor, projekteve të suksesshme, botimeve cilësore kërkimore, konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare si forume të mendimit kritik.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

1. Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është skanimi, analizimi, vlerësimi dhe identifikimi i problematikave që lidhen me raportet mes kërkimit shkencor dhe sigurisë publike duke u përqëndruar kryesisht në veprimtarinë e deritanishme të Qendrës së Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë, me synim nxjerrjen e përfundimeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e politikave në këtë fushë.

Qendra Kërkimore Shkencore (QKSH) ishte një ndër njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë, e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 185 datë 22.5.2015. Me VKM-të e tjera të dala më vonë, Qendra Kërkimore Shkencore nuk është përfshirë në njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë. E organizuar në formën e një institucioni të lartë kërkimor-shkencor, QKSH është struktura që realizon përgjegjësitë institucionale të Akademisë së Sigurisë dhe Policisë së Shtetit në një fushë specifike, në atë të kërkimit dhe përgjithësimit shkencor.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”; Strategjisë zhvillimore të Akademisë së Sigurisë; Strategjisë për veprimtari kërkimore dhe zhvillimore të Qendrës Kërkimore Shkencore si dhe të politikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për veprimtarinë kërkimore shkencore, Qendra Kërkimore Shkencore në Akademinë e Sigurisë gjatë kësaj periudhë, veprimtarinë e saj kërkimore shkencore e ka mbështetur në tre shtylla kryesore dhe konkretisht në:

- (a) kërkimin shkencor përmes projekteve;
- (b) kërkimin shkencor përmes aktiviteteve;
- (c) realizimin e botimeve shkencore për finalizimin e punës e kërkimore-shkencor si dhe shpërndarjen e njohurive shkencore.

QKSH, gjatë kësaj periudhe, me kërkuesit e saj shkencor, ka realizuar 13 projekte kërkimore shkencore sipas kërkesave të Akademisë së Sigurisë, Policisë së Shtetit dhe

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

Ministrisë së Brendshme, duke vënë në dispozicion të porositësit, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse në funksion të politikëbërjes së organizatës tonë policore dhe jo vetëm. Pothuajse të gjitha projektet e zbatuara nga ana jonë janë në funksion të sigurisë publike, rendit publik por dhe të sigurisë kombëtare. Studimet e realizuara në përfundim të këtyre projekteve kërkimore shkencore janë vënë në dispozicion të porositësit (klientit) si dhe strukturave të shtetit shqiptar, studentëve e pedagogëve të Akademisë së Sigurisë dhe jo vetëm, ligjvënësve, shoqërisë civile etj.

Përveç projekteve kërkimore shkencore që realizon më stafin e saj, Qendra Kërkimore Shkencore me qëllim mbledhjen, përpunimin dhe zhvillimin e mendimit të kualifikuar shkencor në fusha të caktuara që përbëjnë interes për Akademinë e Sigurisë, Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme, për përballjen me rreziqet dhe kërcënimet për sigurinë nga forma të ndryshme të kriminalitetit bashkëkohor, ka organizuar me sukses nëntë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Aktivitetet dhe shërbimet për realizimin me sukses të këtyre konferencave në pjesën më të madhe janë mbështetur financiarisht drejtpërsëdrejti nga aktor privat, publik dhe organizata ndërkombëtare të interesuara për sigurinë publike dhe kërkimin shkencor në këtë fushë.

Gjithashtu QKSH realizon botime shkencore për finalizimin e punës së saj kërkimore-shkencor si dhe shpërndarjen e njohurive shkencore jo vetëm për punonjësit e organizatës policore por dhe për një komunitet shumë më të gjerë. Këto botime janë të karakterit shkencor, të regjistruara sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Vetë revista shkencore “Policimi dhe siguria” është organ periodik, teoriko-shkencor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore të Akademisë së Sigurisë, ofron një platformë studimore, debati shkencor e profesional për studiues të ndryshëm, brenda organizatës së Policisë së Shtetit, por dhe më gjerë, ku të shkëmbehen mendime në lidhje me policimin, rendin e sigurinë publike dhe jo vetëm si dhe luftën ndaj krimit e çështje të tjera të lidhura me to. Realizimi i botimit të revistës menaxhohet nga sektori i botimeve të QKSH-së. Gjatë kësaj periudhë janë përgatitur dhe botuar 24 numra të revistës “Policimi dhe Siguria”, revistë periodike shkencore e Akademisë së Sigurisë.

Në analizën SWOT, të veprimtarisë së kësaj qendre, realizuar nga projekti i BE-së “Forcimi i Kapaciteteve dhe Efikasitetit të Akademisë së Sigurisë - Shqipëri, AL 18 IPA JH 01 19”, lidhur me elementet që përbëjnë fuqinë e kësaj strukture, ka rezultuar se QKSH (Qendra Kërkimore Shkencore) ka krijuar një eksperience pozitive 7 vjeçare në drejtim të kërkimit shkencor (projekteve të suksesshme, botimeve cilësore kërkimore, konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare si forume të mendimit kritik.

Pavarësisht veprimtarisë kërkimore shkencore në fushën e sigurisë të zhvilluar nga Akademia e Sigurisë (Qendra Kërkimore Shkencore), sot, përballë kërcënimeve të reja sfiduese në fushën e sigurisë, ka ardhur koha që veprimtaria kërkimore shkencore në këtë fushë të ngrihet në një nivel më të lartë, duke ristrukturuar QKSH-në në një institut të kërkimeve shkencore në fushën e sigurisë publike e jo vetëm.

Qendra Kërkimore Shkencore, me Vendimin e Këshillit të Ministrave të vitin 2015¹, vendim i cili rikrijoi Akademinë e Sigurisë si institucioni arsimit të lartë, u përcaktua si njëra nga tre njësitë kryesore të kësaj akademie. Me VKM-te e tjera të dala më vonë, Qendra Kërkimore Shkencore nuk është përfshirë në njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë.

Qendra Kërkimore Shkencore në Akademinë e Sigurisë është strukturë që kryen

¹ Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 185 datë 22.5.2015.

veprimtari me karakter kërkimor, studimor, botues e koordinues, në përmbushje të misionit dhe përgjegjësi të saj. QKSH realizon këto përgjegjësi e detyra kryesore²:

- Për interesa të përbashkëta të karakterit studimor, kërkimor dhe zhvillimor, të strukturave akademike të Akademisë së Sigurisë, ajo bashkëpunon me njësitë kryesore, me departamentet dhe sektorët e trajnimeve në AS-së, si dhe me struktura apo sektorë të tjerë studimore në Policinë e Shtetit.

- Ofron botime në fushën e policimit dhe të sigurisë sipas standardeve të cilësisë dhe të etikës akademike si: revista, tekste, broshura, guida, si dhe produkte të tjera informuese të shfrytëzueshme, për komunitetin shkencor akademik dhe një audiencë më të gjerë.

- Realizon botimin e revistës “Policimi dhe Siguria”, si botim periodiko-shkencor për njohjen dhe publikimin e veprimtarisë akademike e kërkimore-shkencore të AS-së, në përmbushje të standardeve dhe kërkesave të kohës.

- Sektorët dhe specialistet e QKSH-se në bashkëpunim me stafin akademik të AS-së dhe specialistë të strukturave të policisë, realizojnë projekte kërkimore, studimore e botuese në fushën e policimit, të sigurisë dhe luftës ndaj krimit, në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të Policisë së Shtetit.

- Mbështet personelin akademik dhe studentët e Akademisë lidhur me hulumtimet dhe metodologjitë e kërkimit shkencor.

- Me specialistët dhe personelin e vet qendra merr pjesë dhe mbështet procesin mësimor-akademik (mësimdhënie, udhëheqje punimesh, recensime, etj.).

- Zhvillon veprimtari bashkëpunimi në fushën e kërkimit e përgjithësimi shkencor me institute/qendra kërkimore të institucioneve të arsimit të lartë publik e privat brenda e jashtë vendit, me strukturat homologe të vendeve partnere të Policisë së Shtetit.

- Shpërndan rezultatet studimore në fushën e rendit dhe sigurisë si dhe informon publikun duke përdorur strategji dhe teknika të ndryshme si: publikime, promovime studimore, diskutime në grupe specialistësh, seminare, simpoziume, konferenca shkencore, panele akademike etj.

- Organizon konferenca shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare në bashkëpunim me struktura e institucione kërkimore të vendit e të huaja dhe veprimtari të tjera hulumtuese-zhvillimore, në fushat që mbulohen nga programet e studimit të Akademisë së Sigurisë.³

Në zbatim të kërkesave të ligjit “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”⁴; Strategjisë Zhvillimore të Akademisë së Sigurisë; Strategjisë për Veprimtari Kërkimore dhe Zhvillimore të Qendrës Kërkimore Shkencore si dhe të politikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme për veprimtarinë kërkimore shkencore, Qendra Kërkimore Shkencore në Akademinë e Sigurisë gjatë kësaj periudhë, veprimtarinë e saj kërkimore shkencore e ka mbështetur në tre shtylla kryesore dhe konkretisht në:

(a) Kërkimi shkencor përmes projekteve, përfshin projekte kërkimore të realizuara për qëllime/kërkesa të Akademisë së Sigurisë, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme. QKSH ka krijuar një eksperiencë të mirë dhe me kërkuesit e saj ka realizuar disa të tilla në funksion të politikëbërjes së organizatës tonë policore.

² Rregullore e QKSH, miratuar nga Senati Akademik i Akademisë së Sigurisë, në mbledhjen e datës 29.01.2016, Neni 7.

³ Rregullore e QKSH, miratuar nga Senati Akademik i Akademisë së Sigurisë, në mbledhjen e datës 29.01.2016, Neni 7.

⁴ Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”

(b) Kërkimin shkencor përmes aktiviteteve të ndryshme përfshin organizimin, koordinimin e bashkëpunimin me institucione të tjera, për organizimin e konferencave shkencore me qëllim të mbledhjes dhe përpunimit të mendimit më të kualifikuar shkencor në nivel kombëtar e më gjerë, në funksion të luftës kundër krimit dhe kërcënimeve më të reja të sigurisë. Këto konferenca shkencore janë të natyrës kombëtare dhe ndërkombëtare..

(c) Realizimit të botimeve shkencore. Këto botime janë të karakterit shkencor, të regjistruara sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Nëpërmjet publikimit të arritjeve shkencore në këto botime jo vetëm finalizohet puna e kërkimit shkencor por mundësohet shpërndarja e njohurive shkencore për gjithë punonjësit e organizatës policore dhe jo vetëm. Gjithashtu publikimi i thirrjeve për botim të artikujve në revistën shkencore po na mundëson në vazhdimësi thithjen e mendimit të kualifikuar të punonjësve të policisë dhe të strukturave të tjera të sigurisë në funksion të një policimi proaktiv.

1.a - Realizimi i projekteve kërkimore shkencore.

QKSH, gjatë kësaj periudhe, me kërkuesit e saj shkencor, ka realizuar 13 projekte kërkimore shkencore sipas kërkesave të Akademisë së Sigurisë, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, duke vënë në dispozicion të porositësit, gjetjet dhe rekomandimet përkatëse në funksion të politikëbërjes së organizatës tonë policore dhe jo vetëm. Konkretisht projektet kërkimore shkencore të zhvilluara e të konkretizuara në studimet janë si me poshtë:

1. Projekti kërkimor shkencor “Mbi menaxhimin e karrierës e të sistemit tonë arsimor policor” dhe ndikimin e tyre në plotësimin e nevojave të Policisë së Shtetit me specialistë të aftë si dhe adresimi i problemeve e sfidave me qëllim për të mbështetur vendim marrjen në rishikimin dhe formësimin e politikave të nevojshme për përmirësimin e menaxhimit të zhvillimit të karrierës, duke synuar rritjen e treguesve dhe përmirësimin e punës së Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit. Në këtë projekt dhe studim në përfundim të tij, u përcaktua dhe niveli mesatar vjetor i nevojave të pranimeve të kandidatëve në Akademinë e Sigurisë për periudhën në vazhdim.

Në përfundim të këtij projekti, pasi studiuam, për një periudhë thuajse 10 vjeçare(2006-2015), procesin e ecurisë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë kryer shkollimin bazë policor si dhe menaxhimin e këtij procesi, mbështetur në hulumtime, analiza e sinteza, u arrit në përfundimin⁵ shkollimi bazë policor ka luajtur një rol të rëndësishëm për përgatitjen e një shërbimi policor shqiptar drejt standardeve euroatlantike, ndërsa sistemi arsimor i përzgjedhur për ecurinë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë përfunduar shkollimin bazë policor, nga niveli bazë për në nivelin e parë të drejtimi, keqmenaxhimi i këtij procesi si dhe mbyllja e Akademisë së Policisë, kanë penguar plotësimin e nevojave sasiore dhe cilësore të Policisë së Shtetit me specialistë nënkomisar, që të zotërojnë aftësitë parësore të kërkuara dhe të jenë të aftë për të përbushur përgjegjësitë e vendit të punës e përballur me sfidat e kohës, pasoja të cilat janë ndërjet në përgjithësi në të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit e, në

⁵ Dr. Xhavit Shala, Studim “Mbi menaxhimin e karrierës dhe sistemin arsimor policor”, fokusuar në Nivelin Bazë dhe Nivelin e Parë të Drejtimit në Policinë e Shtetit. Gjetje dhe rekomandime për politika që përmirësojnë punën për menaxhimin e procesit të ecurisë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë mbaruar shkollën bazë të policisë”, Tiranë, Nëntor 2015, f. 12-24.

veçanti, në strukturat e hetimit të krimeve.

Në përfundim të këtij projekti u përshinë dhe rekomandimet⁶ për përmirësimin e politikave në këtë fushë si dhe një prognozë e përafërt për të ardhmen.⁷

2. Projekti kërkimor shkencorë “Vetëvrasja në Shqipëri. Prognozë analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave (fokusi në vitet 2005-2015)”

Duke marrë shkas nga tendenca në rritje e dukurisë së vetëvrasjeve, vëmendja e madhe dhe përballja e vazhdueshme e strukturave policore dhe e vetë shoqërisë shqiptare me raste të tilla, si dhe nga mungesa e një studimi të mirëfilltë në këtë fushë u propozua dhe u realizua projekti kërkimor “Mbi trajtimin e dukurisë komplekse e gjithëpërfshirëse të vetëvrasjes”. Kjo u bë në një këndvështrim psikosocial, statistikor, historik dhe analitik duke evidentuar problematikat, faktorët nxitës, nivelin e riskut të vetëvrasjes, grupet potencialisht më të rrezikuara në shoqërinë shqiptare, si dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave për parandalim dhe reduktim të vetëvrasjes. Projekti u konkludua me një studim të veçantë⁸, i cili përfshiu një periudhë relativisht të gjatë (1945 – 2016), duke u fokusuar sidomos në vitet 2005-2015. Një kapitull i veçantë i këtij studimi i është kushtuar studimit dhe analizimit të rasteve të vetëvrasjeve nga radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit.⁹

Në këtë studim u arrit në përfundimin se, në Shqipëri, dukuria e vetëvrasjes ka një prirje në rritje, sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit. Grupet potencialisht më të rrezikuara rezultojnë të jenë nga mosha e mesme; me arsim 8 ose 9 vjeçar; janë më shumë meshkujt; ekziston një prirje rritëse tek femrat të vetëvrasjeve të mbetura në tentativë; me tendencë në rritje drejt zonave urbane; me shpërndarje gjeografike më shumë në qarqet Tiranë, Durrës, Lezhë, Fier, Shkodër; më shtrirje stinore kryesisht në muajt e verës dhe pranverës.¹⁰

Në përfundim, në përputhje dhe me qëllimin e realizimit të këtij projekti, për parandalimin dhe reduktimin fenomenit të vetëvrasjeve, sensibilizimin e shoqërisë shqiptare për një vëmendje më të shtuar ndaj saj si një problem me tendencë në rritje si dhe në shërbim të një polici më efektiv në raport me këtë dukuri, u dhanë rekomandimet për përmirësimin e politikave në këtë fushë¹¹, si dhe një prognozë¹² e përafërt për të ardhmen.

3. Projekti kërkimor “Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri: prognozë juridike, historike, analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2007-2016”.

Duke marrë shkas nga perceptimi i një tendence në rritje të dhunës dhe të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, vëmendja e madhe e përballja e vazhdueshme e strukturave policore dhe e vetë shoqërisë shqiptare me raste të tilla, ndikimi i tyre në çështjet e rendit dhe të sigurisë në vendin tonë si dhe nga mungesa e një studimi të mirëfilltë e të thelluar në këtë këndvështrim, Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë

⁶ Po aty, rekomandime, f. 25-27.

⁷ Po aty, prognozë e përafërt, f. 28.

⁸ Dr. Xhavit Shala, Msc Anisa Agastra, “Studimi vetëvrasja në Shqipëri. Prognozë analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave (Fokusi në vitet 2005-2015)”, Tiranë, Korrik 2016.

⁹ Po aty, f. 57-58;

¹⁰ Po aty, përfundimet dhe gjetjet, f. 17 - 50

¹¹ Po aty, rekomandimet për përmirësimin e politikave, f. 50-58.

¹² Po aty, Prognoza për të ardhmen, f. 59.

së Sigurisë planifikoi dhe realizoi projektin kërkimor shkencor “Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri: prognozë juridike, historike, analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2007-2016”¹³.

Qëllimi i këtij projekti kërkimor shkencor ishte trajtimi i problemit të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare në këndvështrim historik, ligjor, kronologjik, social e psikosocial, analitik e statistikor, duke u përqendruar në dhjetëvjeçarin 2007-2016. Tjetër qëllim ishte realizimi i një analize krahasuese me periudha të mëparshme me synim evidentimin e problematikave, faktorët nxitës si dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave për parandalimin e reduktimin e dukurisë së vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare dhe menaxhimit të konflikteve e dhunës në shërbim të përmirësimit të mëtejshëm të procesit të një policimi komunitar të ndërthurur me atë të bazuar në inteligjencë në lidhje me këtë çështje.

Në përfundim të këtij projekti, në përputhje me qëllimin e realizimit të tij, për trajtimin, parandalimin dhe reduktimin e dhunës ekstreme e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare, si dhe zanafillës së tyre, dhunës e konflikteve, ndërgjegjësimin e shoqërisë shqiptare për një vëmendje më të shtuar ndaj tyre si një problem shqetësues dhe i vazhdueshëm, pavarësisht shifrave aktuale në rënie të vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare si dhe në shërbim të një policimi më efektiv në raport me këtë dukuri, janë dhe në përfundimet dhe gjetjet¹⁴, prognozën¹⁵ dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave në këtë fushë¹⁶.

4. Projekti kërkimor “Krimi dhe kërcënimi kibernetik në Shqipëri. Prognozë analitike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave.”

Zhvillimi i vullshëm i komunikimit masiv në hapësirën kibernetike (virtuale), sidomos pas vitit 2000, po i përball strukturat e Policisë së Shtetit, të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit si dhe strukturat e sigurisë me një problematikë të re, në një rritje progresive të veprave penale në fushën kompjuterike, por edhe të kërcënimit kibernetik.

Në vendin tonë, në vitin 2017, krahasuar me vitin 2010, janë evidentuar 3.3 herë më shumë vepra penale në fushën e krimeve kompjuterike dhe me një nivel zbulueshmërie vetëm 27%¹⁷. Kjo veprimtari kriminale paraqet vështirësi për t’u gjurmuar dhe ndjekur sepse nuk kufizohen nga kufijtë kombëtarë gjeografikë. Ndërkohë, janë rritur ndjeshëm kërcënimet/sulmet kibernetike, si përpjekje të qëllimshme për të marrë akses, manipuluar, ndërhyrë ose dëmtuar integritetin, konfidencialitetin, sigurinë ose disponibilitetin e të dhënave të sistemeve kompjuterike, pa pasur autoritet ligjor për ta bërë këtë¹⁸. Kërcënimet mund të kenë origjinë të ndryshme, duke përfshirë sulme kriminale, të motivuara politikisht, sulme terroriste apo të sponsorizuara nga shtetet si dhe fatkeqësi natyrore e gabime të paqëllimshme. Kriminelët kibernetikë po përdorin metoda gjithnjë e më të sofistikuara për t’u futur në sistemet e informacionit dhe vjedhjen e të dhënave kritike. Rritja e spiunazhi ekonomik dhe aktivitetet e sponsorizuara nga

¹³ Dr. Xhavit Shala, Msc Anisa Agastra, Kryekomisar Msc Bilbil Dervishi, “Studimi vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri: prognozë juridike, historike, analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2007-2016. (Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet)”, Tiranë Mars 2018.

¹⁴ Po aty, përfundimet dhe gjetjet kryesore, f. 28-198.

¹⁵ Po aty, prognoza për të ardhmen, f. 206.

¹⁶ Po aty, rekomandimet dhe politikat, f. 198.

¹⁷ Informacion përmbledhës i analizave të Sektorit për Hetimin e Krimeve Kompjuterike, për vitet 2016 - 2018, dinamika e punës, prioritetet, kërkesat.

¹⁸ Dokumenti i Politikave për Sigurinë Kibernetike 2015-2017, miratuar me VKM Nr. Nr. 973, datë 02.12.2015. f. 7.

shteti në hapësirën kibernetike përbëjnë një kategori të re të kërcënime për qeveritë dhe kompanitë e BE-së.¹⁹

Mbrojtja nga kërcënimet e reja të kufijve virtualë dhe rrjeteve e sistemeve është çështje e rëndësishme e sigurisë kombëtare. Për këtë u hartuar dhe u zbatua projekti kërkimor “Krimi dhe kërcënimet kibernetik në Shqipëri. Prognozë analitike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.²⁰ Në funksion të këtij projekti është realizuar trajtimi, skanimi dhe analizimi i dinamikës së krimit dhe kërcënimit kibernetik në Shqipëri, në këndvështrim historik e kriminologjik, juridik, penal e procedural, social e psikosocial, analitik e statistikor, në raport me sigurinë publike e atë kombëtare. Në përfundim të këtij projekti janë dhënë përfundimet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave²¹ si dhe një prognozë²² e përafërt lidhur me zhvillimet e pritshme në këtë fushë.

5. Projekti kërkimor “Siguria rrugore në Shqipëri midis realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.

Duke marrë shkas nga perceptimi i një tendence në rritje e të aksidenteve rrugore me pasojë humbje të jetëve njerëzore, vëmendja e madhe dhe përballja e vazhdueshme e strukturave policore dhe e vetë shoqërisë shqiptare me çështje të sigurisë rrugore, ndikimi i tyre në çështjet e rendit dhe të sigurisë në vendin tonë si dhe nga mungesa e një studimi të mirëfilltë e të thelluar në këtë këndvështrim, Qendra Kërkimore Shkencore e Akademisë së Sigurisë planifikoi dhe realizoi projektin kërkimor shkencor “Siguria rrugore në Shqipëri midis realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.²³ Qëllimi i këtij punimi është skanimi, analizimi, vlerësimi dhe identifikimi i problematikave që lidhen me aksidentet automobilistike e sigurinë rrugore, si dhe të faktorëve ndikues, me synim dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e aksidenteve e përmirësimin e sigurisë rrugore.

Nga studimi i dokumenteve të shumta arkivore, të cilat janë prezantuar në këtë projekt kërkimor, kemi provuar se në Shqipëri për periudhën 1953-1990 janë evidentuar 5622 aksidente me rreth 3236 të vrarë e 5063 të plagosur.²⁴ Ndërsa nga viti 1992 deri në vitin 2018 janë evidentuar 28915 aksidente, me 8180 të vrarë e 16004 të plagosur.²⁵ Aksidentet rrugore me pasojë vdekjen renditen si faktori numër një që u merr jetën shqiptarëve. Kështu për periudhën 2005-2015 nga 7044 vetë që kanë humbur jetën në mënyrë të dhunshme (vrasje, vetëvrasje dhe aksidente rrugore), 3341 ose 47.4% e numrit total e kanë humbur jetën nga aksidentet automobilistike, krahasuar me vetëvrasjet të cilat përbënin 34% të rasteve dhe 17.95% të rasteve që e kanë humbur jetën si pasojë e krimit të vrasjes.

Në kushtet e një mjedisi në ndryshim e zhvillim të shpejtë ekonomik, i cili nuk mund të kuptohet pa rritjen e transportit rrugor, është shtuar shumë presionin pozitiv mbi strukturat e Policisë së Shtetit për më tepër siguri rrugore. Në këto kushte, ishte i domosdoshëm identifikimi i problematikave që lidhen me sigurinë rrugore si dhe i

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

¹⁹ Cybersecurity Strategy of the European Union: An Open, Safe and Secure Cyberspace. Brussels, 7.2.2013.

²⁰ Dr. Xhavit Shala, “Studimi krimi dhe kërcënimet kibernetik në Shqipëri (Prognozë analitike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave. Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet”, Tiranë, Mars 2019.

²¹ Po aty, përfundimet dhe rekomandimet, f. 10-26.

²² Po aty, Prognoza për të ardhmen, f. 97.

²³ Dr. Xhavit Shala, “Siguria rrugore në Shqipëri mes realitetit dhe perceptimit”, Tiranë, Prill 2019.

²⁴ Po aty, f. 49.

faktorëve ndikues, me synimin dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e politikave për parandalimin dhe reduktimin e aksidenteve e forcimin e sigurisë rrugore.

Gjatë këtij projekti kërkimor shkencor dhe në hartimin e studimit në përfundim të tij, janë aplikuar metodat dhe instrumentet bazë kërkimore shkencore.

Në përfundim të projektit janë dhënë gjetjet, përfundimet²⁶ dhe rekomandimet²⁷ përkatëse për përmirësimin e politikave lidhur me mënyrën e trajtimit, menaxhimit, parandalimit dhe reduktimit të aksidenteve dhe përmirësimin e sigurisë rrugore në vendin tonë. Këto përfundime e rekomandime janë vënë në dispozicion Policisë së Shtetit, Ministrisë së Brendshme si të stafit të Kryeministrit të Shqipërisë, më kërkesën e këtyre të fundit.

6. Projekti kërkimor “Ekzaminimi në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, të gjendjes së botimeve profesionale e juridike e të mjediseve ku mbahen dhe ofrohen ato”.

Me qëllim përmirësimin e punës për rritjen e nivelit profesional e juridik të oficerëve të Policisë së Shtetit si dhe njohjen e eksperiencave më të mira në fushën e shërbimit policor, Qendra e Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë hartoi dhe zbatoi një projekt kërkimor shkencor për studimin dhe ekzaminimin e gjendjes së botimeve profesionale e juridike në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, të gjendjes reale të mjediseve ku mbahen dhe ofrohen ato, si dhe për identifikimin e nevojave për botimet më të nevojshme e më të domosdoshme për aktivitetin e përditshëm të punonjësve të policisë e në shërbim të një policimi gjithnjë e më efektiv.²⁸

Ky projekt kërkimor kishte si objektiva kryesore: njohja tërësisht të gjendjes me botimet juridike e profesionale, në mjediset e punës së Policisë së Shtetit, (stacionet, komisaritet e deri në drejtoritë vendore e qendrore të Policisë); thithjen e mendimeve e të sugjerimeve të grupeve të interesit (inspektoreve, menaxhereve dhe drejtuesve të policisë) për nevojat imediate në këtë fushë dhe së treti nxjerrjen e përfundime dhe dhënien e rekomandime për hartimin e politikave për përmirësimin e gjendjes në këtë fushë.

Bazuar në analizën e përgjigjet e dhëna gjatë anketimit të realizuar, analizën e informacionit të bollshëm të siguruar nga kontaktet fizike dhe intervistave me personelin policor si dhe duke marrë në konsideratë edhe koeficientin e gabimit në të kuptuar apo subjektivizmin dhe kufizimet në interpretimin e fakteve, në përfundim të këtij projekti kërkimor shkencor janë dhënë përfundimet²⁹ dhe rekomandimet³⁰ përkatëse për përmirësimin e politikave.

7. Projekti kërkimor “Identifikimi i shkaqeve të mos paraqitjes në testin me shkrim për konkurrimin në gradën “Nënkomisar”, të punonjësve të policisë të cilët kishin aplikuar dhe ishin regjistruar për të marrë pjesë në këtë proces”.

Me porosi të Ministrit të Brendshëm, z. Fatmir Xhafaj, u kërkuar identifikimi i shkaqeve të mos paraqitjes në testin me shkrim për konkurrimin në gradën “Nënkomisar”, të punonjësve të policisë, të cilët kishin aplikuar dhe ishin regjistruar për

²⁵Po aty.

²⁶ Po aty, gjetjet dhe përfundimet, f. 4-67.

²⁷ Po aty, rekomandimet kryesore, f. 67-69

²⁸ Studim “Mbi ekzaminimin në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, të gjendjes së botimeve profesionale e juridike e të mjediseve ku mbahen dhe ofrohen ato”, Tiranë, Maj 2017.

²⁹ Po aty, përfundimet, f. 3-5.

³⁰ Po aty, rekomandime, f. 6-7.

të marrë pjesë në këtë proces.

Në zbatim të kësaj porositë Qendra Kërkimore Shkencore hartoi dhe zbatoi projektin me të njëjtin titull.³¹ Në përfundim të këtij projekti afatshkurtër, u grumbullua një informacion, që i përpunuar dhe i analizuar, ju paraqit porositisë (Ministrit të Brendshëm), së bashku me përfundimet dhe rekomandimet përkatëse.

8. Projekti kërkimor “Për përmirësimin e performancës së punës së strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimeve me rrjetin sekret informative”.

Në kuadrin e domosdoshmërisë për rritjen e treguesve dhe përmirësimin e punës së Policisë së Shtetit në luftën kundër krimit, sidomos krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme, korrupsionit dhe terrorizmit, në përmbushje të prioriteteve të Qeverisë dhe Ministrisë së Brendshme për Rendin dhe Sigurinë, më kërkesë të Ministrit të Brendshëm, z. Sandër Lleshaj, u kërkua hartimi i projektit kërkimor “Mbi vlerësimin e performancës strategjike të punës së strukturave të hetimit dhe parandalimit të krimeve me informatorët dhe rrjetin sekret informativ”.

Në përfundim të këtij projekti, nisur nga gjetjet e tij, u hartua Dokumenti Strategjik “Për rritjen e performancës së punës të strukturave të Policisë së Shtetit, të profilizuar për policinë kriminale, sigurinë publike dhe kufirin e migracionin në punën me informatorët dhe rrjetin sekret informativ”³². Gjithashtu, pjesë e këtij projekti kërkimor, me kërkesë të Ministrit Lleshaj për QKSH-në ishte dhe hartimi e dorëzimi i draft udhëzimit të Ministrit të Brendshëm “Për burimet e informacionit policor dhe bashkëpunimin e fshehtë me individët”.³³

9. Projekti kërkimor “Krimi mjedisor dhe siguria mjedisore në Shqipëri mes realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”

Në dekadat e fundit si objekt referues i sigurisë është parë dhe mjedisi me elementët e tij si ujin, tokën, ajrin, etj. Këto janë pranuar si vlera të shoqërisë që duhen mbrojtur e siguruar pasi ndikojnë në cilësinë e jetës së komuniteteve njerëzore. Në këtë rast, kur objekt referimi i sigurisë është mjedisi në tërësi apo elementët e tij përbërës, kemi të bëjmë me sigurinë mjedisore. Për këtë, ndryshimet mjedisore si dhe rreziqet e kërcënimeve ndaj tij, vlerësohen si rreziqe e kërcënime ndaj sigurisë mjedisore. Siguria mjedisore apo dhe ambientale siç dhe përmendet shpesh, është një koncept relativisht i ri, është një zgjerim i konceptit jotradicional të sigurisë.

Pavarësisht legjislacionit të miratuar për mbrojtjen e mjedisit dhe përcaktimit të ruajtjes së tij si domosdoshmëri strategjike, problematikat në fushën e rendit dhe të sigurisë që shoqëruan zhvillimet pas vitin 1992, krijuan kushte për përfitime abuzive pasurorë nëpërmjet shfrytëzimit pa kriter të pasurive mjedisore. Kjo bëri që degradimi mjedisor të kthehet në një rrezik real për sigurinë kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Për këtë arsye Qendra Kërkimore Shkencore hartoi dhe realizoi projektin kërkimor shkencor “Krimi mjedisor dhe siguria mjedisore në Shqipëri mes realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.³⁴

³¹ Ky projekt u zbatua në muajin Tetor 2017.

³² Dr. Xhavit Shala, Strategji “Për rritjen e performancës së punës të strukturave të Policisë së Shtetit, të profilizuar për policinë kriminale, sigurinë publike dhe kufirin e migracionin, në punën me informatorët dhe rrjetin sekret informativ”, Tiranë, 2019.

³³ Dr. Xhavit Shala, Draft udhëzim i Ministrit të Brendshëm “Për burimet e informacionit policor dhe bashkëpunimin e fshehtë me individët”, Tiranë, 13.2.2019.

³⁴ Dr. Xhavit Shala, Studimi “Krimi mjedisor dhe siguria mjedisore në Shqipëri mes realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”. Tiranë, Janar 2020.

Në përfundim të këtij projekti, duke krahasuar gjetjet dhe përfundimet e analizave dhe vlerësimit të krimeve dhe sigurisë mjedisore janë dhënë përfundimet³⁵ dhe rekomandimet³⁶ përkatëse.

10. Projekti kërkimor “Parandalimi i kultivimit kyçi i suksesit antikanabis”

Thuajse i gjithë territori shqiptar mund të klasifikohet si “zonë e përshtatshme për kultivim” e kanabisit, nisur nga karakteristikat e tij si kushtet klimaterike, elementet përbërës të tokës ku mund të kultivohet, të fluksit të dritës së diellit, e përshtatshme për biosintezën apo reaksionet biokimike që kalon bima e kanabisit deri në fazën e prodhimit të saj si dhe mundësia e sigurimit të burimeve ujore. Përhapja e kësaj dukurie pas vitit 1995 dhe sidomos tolerimi i rrezikshëm dhe “licencimi i heshtur” i aktivitetit të kultivimit të hapur të kanabisit në komunën e Lazaratit të qarkut Gjirokastrë, krijoi kushte të favorshme për grupet kriminale, të cilat, për më shumë se një dekadë, arritën të konsolidojnë financat, rrjetet, tregjet, specialistët dhe lidhjet politike.

Për këto dhe çështje të tjera të rëndësishme që lidhen me kultivimin dhe luftën kundër kanabisit, me kërkesë të Këshilltarit të Kryeministrit për Sigurinë Kombëtare, u hartua projekti kërkimor “Parandalimi i kultivimit kyçi i suksesit antikanabis”, projekt i cili u finalizua me studimin përkatës.

Objekti i këtij projekti ishte trajtimi për periudhën 1992-2016 i dukurisë së kultivimit të kanabisit si një aktivitet kriminal i penalizuar nga legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar, me potencialet e kthimit në një kërcënim për sigurinë kombëtare, i dinamikës dhe trendit të përhapjes së kësaj dukurie në vendin tonë, i faktorëve që kanë ndikuar në lindjen dhe përhapjen e tij, i veçorive të luftës së deritanishme kundër kësaj dukurie, me qëllim identifikimin e metodologjisë më të mirë dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave që garantojnë suksesin e luftës ndaj kultivimit të kanabisit. Në përfundim të këtij projekti, është bërë dhe një prognozë për të ardhmen.

11. Projekti kërkimor “Mbi studimin, analizimin dhe vlerësimin e pritshmërive të Kursit të Parë Profesional Pasuniversitar “Specialist për Hetim Krimi”.

Me qëllim rritjen e nivelit profesional dhe përmirësimin më tej të procesit të rekrutimit për Kursit Profesional Pasuniversitar “Specialist për Hetim Krimi”, në përshtatje me pritshmëritë që ka organizata policore ndaj tyre por dhe pritshmëritë e tyre pas fillimit të angazhimit si punonjës të Policisë së Shtetit, me porosi të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit drejtues madhor Ardi Veliu, Qendra e Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë ka hartuar dhe zbatuar projektin kërkimor shkencor “Mbi studimin, analizimin dhe vlerësimin e pritshmërive të kursit të parë profesional pasuniversitar “Specialist për hetim krimi”.”³⁷

Synimi i këtij projekti është që nëpërmjet përdorimit të metodave të ndryshme shkencore si metoda e analizës dhe sintezës, e studimit të rastit, statistikore etj, si dhe nëpërmjet të përdorimit të mjeteve të kërkimit si anketimi, intervista etj. të arrijmë të studiojmë, analizojmë dhe vlerësojmë pritshmëritë për të diplomuarit e kursit të parë profesional pasuniversitar “Specialist për hetim krimi” si dhe të evidentojmë nevojat për

³⁵ Po aty, përfundimet kryesore, f. 88-95.

³⁶ Po aty, rekomandimet kryesore, f. 95-98.

³⁷ Dr. Xhavit Shala, Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet në përfundim të projektin kërkimor shkencor “Mbi studimin, analizimin dhe vlerësimin e pritshmërive të Kursit të Parë Profesional Pasuniversitar “Specialist për Hetim Krimi”, Tiranë, Korrik 2020.

përmirësimin e mëtejshëm të politikave në këtë fushë.

Për këtë u realizua anketimi i të gjithë ish studentëve të Kursit të Parë Profesional Pasuniversitar “Specialist për Hetim Krimi”, tashmë nënkomisarë në Policinë e Shtetit, lidhur me nivelin e realizimit të pritshmërive të tyre në pozicionin e ri të oficerit të Policisë së Shtetit duke evidentuar dhe nevojat, që sipas tyre, duhen për përmirësim të mëtejshme në këtë fushë etj.

Bazuar në analizën e gjetjeve (përgjigjet e dhëna gjatë anketimit të realizuar), në analizën e informacionit të siguruar për këtë çështje, si dhe duke marrë në konsideratë edhe koeficientin e gabimit në të kuptuar apo subjektivizmin dhe kufizimet në interpretimin e fakteve, në përmbyllje të këtij projekti kërkimor shkencor u dhanë përfundimet³⁸ dhe rekomandimet³⁹ kryesore.

12. Projekti kërkimor “Fenomenet ekstreme të natyrës si kërcënim për sigurinë në Shqipëri. Rekomandime për përmirësimin e politikave që mundësojnë minimizimin e pasojave të tyre”.

Fenomenet ekstreme të natyrës/fatkeqësitë natyrore përbëjnë rrezik dhe kërcënim për sigurinë kombëtare, rajonale e ndërkombëtare. Në analizën që i bëhet mjedisit të brendshëm në dokumentin kryesor strategjik të Shqipërisë, në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare të vitit 2014, vlerësohet se vendi ynë është i ekspozuar edhe ndaj rreziqeve me origjinë natyrore të karakterit gjeologjik, hidrologjik, atmosferik dhe biofizike, si dhe atyre me origjinë njerëzore, teknologjike dhe industriale. Për përmirësimin e menaxhimit të emergjencave, pasojë e fenomeneve ekstreme të natyrës, si dhe rehabilitimin e shpejtë të gjendjes së shkaktuar prej tyre është e domosdoshme një pjesëmarrje më e gjerë e komunitetit në këtë proces. Për këtë Qendra e kërkimeve Shkencore hartoi dhe realizoi projektin kërkimor shkencor “Fenomenet ekstreme të natyrës si kërcënim për sigurinë në Shqipëri. Rekomandime për përmirësimin e politikave që mundësojnë minimizimin e pasojave të tyre”.⁴⁰

Në përfundim të projektit⁴¹, nga analiza e të gjitha gjetjeve dhe përfundimeve, në zbatim dhe të objektivave të përcaktuara në fillim, provohen si e vërteta hipoteza e ngritur në fillim të studimit se fenomenet ekstreme të natyrës perceptohen ndër rreziqet dhe kërcënimet kryesore për sigurinë dhe jetën e qytetarëve. Ky perceptim është në shpërpjesëtim me nivelin e njohurive të tyre për menaxhimin e pasojave të katastrofave natyrore e teknologjike dhe shkallën e përgatitjes materiale për t’u përballuar me këto fatkeqësi”.

Në përmbyllje projektit janë dhënë dhe rekomandimet⁴² përkatëse për përmirësimin e politikave për të parandaluar kur është e mundur, si dhe për të reaguar në kohë për minimizimin e dëmeve e mire menaxhimin e situatave të tilla emergjente si tërmetet, pandemitë, përmblytjet, zjarret, ortehtë, erozionet, katastrofat, etj.

13. Në vitin 2021 kemi aplikuar dhe përfutur financimin nga AKKSHI dhe po zbatojmë projektin “Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile”.

³⁸Po aty, përfundimet kryesore, f. 6.

³⁹Po aty, rekomandimet kryesore, f. 7.

⁴⁰ Dr. Xhavit Shala, Fatkeqësitë natyrore dhe çështjet e sigurisë mes realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave, Tiranë, Maj 2021.

⁴¹ Po aty, përfundimet kryesore f. 19-22.

⁴²Po aty, rekomandimet kryesore, f. 23-24.

AKKSHI me vendimin nr. 1, datë 21.7.2021, të Bordit të tij të administrimit, ka financuar projektin kërkimor “Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përballimin e emergjencave civile”, me drejtues projekti z. Xhavit Shala, projekt i cili është në vazhdim. Fokusi i këtij studimi është ndërtimi i një kornize mbi sigurinë publike në rastet e fenomeneve ekstreme të natyrës dhe emergjencave civile duke sjellë prurje teorike e eksperiencë praktike me informacion të bollshëm mbi përgjegjësinë dhe vetëdijen e institucioneve, agjencive ligjzbatuese dhe Policisë së Shtetit si dhe gjithë shoqërisë në gjeohapësirën shqiptare e më gjerë.

Siç shihet, pothuajse të gjitha projektet e zbatuara nga ana jonë janë në funksion të sigurisë publike, rendit publik por dhe të sigurisë kombëtare.

Dymbëdhjetë nga këto projekte kërkimore janë financime të vetë Akademisë së Sigurisë. Klientët tanë (porositësit) për këto projekte kanë qenë:

- në dy raste Akademia e Sigurisë;
- në tre raste ministrat e brendshëm;
- në dy raste stafi i kryeministrit;
- në dy raste drejtorët e përgjithshëm Policisë së Shtetit.

Pjesa tjetër janë projektuar dhe realizuar në vlerësim të rreziqeve dhe kërcënimeve për sigurinë, të evidentuara nga ana jonë si QKSH, në bashkëpunim me Rektorin e Akademisë.

Studimet e realizuara në përfundim të këtyre projekteve kërkimore shkencore janë vënë në dispozicion të porositësit (klientit) si dhe strukturave të shtetit shqiptar, studentëve e pedagogëve të Akademisë së Sigurisë dhe jo vetëm, ligjvënësve, shoqërisë civile etj.

1.b - Kërkimi shkencor përmes aktiviteteve kërkimore

Përveç projekteve kërkimore shkencore që realizon më stafin e saj, Qendra Kërkimore Shkencore me qëllim mbledhjen, përpunimin dhe zhvillimin e mendimit të kualifikuar shkencor në fusha të caktuara që përbëjnë interes për Akademinë e Sigurisë, Policinë e Shtetit dhe Ministrinë e Brendshme për përballjen me rreziqet dhe kërcënimet për sigurinë nga forma të ndryshme të kriminalitetit bashkëkohor, ka organizuar me sukses nëntë konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare e konkretisht:

1. Në nëntor 2016 u realizua Konferenca e Parë Ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë: “Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit”, (Contribution to publik safety through education).

Kjo, konferencë shkencore⁴³ u zhvillua në kuadër të reformës së ndërmarrë për reformimin rrënjësor të sistemit arsimor për punonjësit e Policisë, si dhe vënien në funksion të plotë të Akademisë së Sigurisë jo vetëm si qendër formimi, por edhe kërkimi shkencor.

Siguria mund të përmirësohet nëpërmjet arsimimit. Një nga dimensionet është rritja e kapaciteteve profesionale të strukturave që marrin pjesë në këtë veprimtari, por sidomos struktura e Policisë, e cila ka punën më të specializuar. Struktura që ka misionin kryesor për respektimin e rendit dhe të zbatimit të ligjit është Policia, pikërisht kjo strukturë duhet të zotërojë nivel shumë të lartë profesional, për të përmbushur kërkesën

⁴³ Konferenca e Parë Ndërkombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë: “Kontributi në sigurinë publike nëpërmjet arsimimit”, (Contribution to publik safety through education.) u zhvillua me 1 Nëntor 2016.

e komunitetit. Qëllimi i kësaj konference është t'i japi kontribut nëpërmjet shkollimit, rritjes së sigurisë publike për qytetarët. Kjo konferencë u organizua në bashkëpunim me Universitetin e Romës "Tor Vergata", Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Akademinë e Forcave të Armatosura në Tiranë dhe Universitetin e Sigurisë në Shkup.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë prezantoi, nëpërmjet referuesve të saj, gjetjet dhe përfundimet kryesorë të projektit kërkimor shkencor "Mbi menaxhimin e karrierës e të sistemit tonë arsimor policor".

2. Në prill 2017, u organizua konferenca e parë kombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë "Depresioni dhe vetëvrasjet në Shqipëri".

Kjo konferencë⁴⁴ u organizua me qëllim mbledhjen, përpunimin dhe zhvillimin e mendimit të kualifikuar shkencor si dhe eksplorimin në thellësi, trajtimin në këndvështrim analitik dhe psikosocial të dukurisë së vetëvrasjeve, i trendit të saj sidomos në dhjetëvjeçarin e fundit, analizës shumëdimensionale e kësaj dukurie për të evidentuar problematikat, faktorët që e nxitin, e mundësojnë e që krijojnë terren për zhvillim e saj, ndikimin e tyre në fushën e sigurisë, dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave për parandalimin e reduktimin e kësaj dukurie, në shërbim të një policimi më efektiv. Ajo u organizua në bashkëpunim me përfaqësinë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Institutin e Shëndetit Publik, Fakultetin e Shkencave Sociale, Institutin e Policisë Shkencore, Institutin e Mjekësisë Ligjore si dhe repartin e Toksikologjisë të QSUT-së.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë prezantoi, nëpërmjet referuesve të saj, gjetjet dhe përfundimet kryesorë të projektit kërkimor shkencor "Vetëvrasja në Shqipëri. Prognozë analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2005-2015".

3. Në nëntor 2017 QKSH organizoi konferencën II shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare⁴⁵, me titull: "Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë" (Forensic sciences and contemporary security challenge).

Në format e tij bashkëkohore, kriminaliteti përbën sot një faktor me ndikim në rritje në mjedisin e sotëm strategjik e të sigurisë, i cili karakterizohet, si kurrë ndonjëherë më parë, nga të panjohura dhe nga mundësitë e zhvillimeve krejtësisht të paparashikueshme. Pamundësia e identifikimit dhe e parashikimit adekuat të rreziqeve të ardhshme, i detyron strukturat e sigurisë që të orientojnë drejt krijimit të kapaciteteve polivalente, të cilat duhet të jenë të afta që, në kohën më të shkurtër të mundshme, të reagojnë me efektivitet dhe sukses ndaj rreziqeve të panjohura.

Në këtë kuadër Qendra Kërkimore Shkencore organizoi konferencën II shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare, me titull: "Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë" (Forensic sciences and contemporary security challenge).

Konferenca kishte për objekt, trajtimin në mënyrë gjithëpërfshirëse nga disiplina të ndryshme të shkencave ligjore, nëpërmjet punimeve të mirëfillta shkencore në nivel të gjerë kombëtar e ndërkombëtar, të rreziqeve dhe kërcënimeve të sigurisë nga kriminaliteti bashkëkohor, përgjithësimin e përvojës më të mirë, zgjerimin e dijeve

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

⁴⁴ Konferenca e Parë Kombëtare e Akademisë së Sigurisë me temë "Depresioni dhe vetëvrasjet në Shqipëri" u zhvillua me datë 28 prill 2017.

⁴⁵ Konferenca e II-të shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare, me titull: "Shkencat ligjore dhe sfidat bashkëkohore të sigurisë" (Forensic sciences and contemporary security challenge) u zhvillua me 15 Nëntor 2017.

aplikative, si dhe dhënien e rekomandimeve për hartimin e politikave, për përmirësimin e punës në shërbim të një policimi më efektiv.

Të pranishëm në këtë konferencë shkencore ndërkombëtare ishin, kryeministri i Republikës së Shqipërisë, sh. t. z. Edi Rama, ministri i Brendshëm, z. Fatmir Xhafaj, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, drejtues madhor Haki Çako si dhe shumë personalitete të tjera nga brenda e jashtë vendit.

Konferenca u organizua në bashkëpunim me Institutin e Policisë Shkencore, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Akademinë e Kosovës për Sigurinë Publike, Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, Universitetin e Romës “Tor Vergata”, Fakultetin e Mjekësisë Monstir - Tunizi, dhe Fakultetin e Sigurisë Shkup, Maqedoni. Kumtuesit e kësaj konference patën mundësinë e prezantimit të punimeve të tyre dhe të shkëmbimit të ideve nëpërmjet diskutimeve të ndryshme.

4. Me 26 prill 2018 QKSH organizoi konferencën II shkencore kombëtare

“Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare”.

Në punimet e paraqitura në konferencë⁴⁶ u vlerësua një vëmendje e shtuar nga mjaft studiues dhe të interesuar për problemet e familjes dhe krimeve brenda saj. Tema e Konferencës rreth një problemi sa interesant kaq edhe të vështirë, siç është vrasja brenda familjes, tërhoqi praninë e një dimension relativisht të gjerë të interesuarish, studiues e pjesëmarrësish me punime e kumtesa, të cilët përfaqësonin Institucione të Arsimit të Lartë dhe struktura ligjzbatuese, pedagogë e lektorë me grada shkencore, punonjës të Institucioneve të Sigurisë, drejtues të lartë të Policisë së Shtetit, si edhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë prezantoi, nëpërmjet referuesve të saj, gjetjet dhe përfundimet kryesorë të projektit kërkimor shkencor “Vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri” të realizuar së fundmi prej saj.

Në mbyllje të konferencës u dhanë përfundimet dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e politikave në këtë fushë.

5. Në nëntor 2018 u organizua konferenca III shkencore ndërkombëtare “Computer Crime, Cyber Crime and National Secyurity”.

Objekti kryesor i kësaj konference, ishte paraqitja e analizave e prognozave, nga aspekti i hetimit të krimeve kompjuterike dhe kërcënimeve kibernetike të sigurisë kombëtare e ndërkombëtare. Këto u konkretizuan me punime të mirëfillta shkencore për të nxitur debate dhe për të trajtuar në nivel të gjerë, kombëtar e ndërkombëtar, rëndësinë dhe nevojën e zgjerimit të dijeve dhe aplikimit të tyre përballë sfidës së hetimit, kërcënimeve të reja të kufijve virtualë dhe parandalimit të krimeve kibernetike në Shqipëri, si dhe hartimin e politikave, masave, kurrikulave e trajnimeve për këtë çështje.

Qendra e Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë e organizoi këtë konferencë, në bashkëpunim me Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) dhe Universitetin Aleksandër Moisiu Durrës (UAMD), si dhe me mbështetjen e

⁴⁶ Konferenca II Shkencore Kombëtare “Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin e reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare” u zhvillua me 26 prill 2018.

Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, Prezenca në Shqipëri (OSCE), me Misionin PAMECA V dhe me Projektin IPA/2017 “Countering Serious Crime In The Western Balkans”, organizoi Konferencën e III-të Shkencore Ndërkombëtare me temë: “Krimi kompjuterik, kërcënimi kibernetik dhe siguria kombëtare” (Computer crime, cyber crime and national security). Punimet e konferencës e përshëndetën dhe zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, prof. dr. Vasilika Hysi dhe ministri i Brendshëm, dr. Sandër Lleshaj.

6. Në maj 2019 u organizua konferenca iv ndërkombëtare me temë “Siguria rrugore dhe përdoruesit e rrugës në Shqipëri”.

Qendra Kërkimore Shkencore⁴⁷, në bashkëpunim me Universitetin Politeknik të Tiranës, Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, Kolegjin Universitar “Luarasi”, Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, si dhe me mbështetjen e SHELL Albania, TAP Albania, Drejtorisë së Policisë Rrugore, Kryqit të Kuq Shqiptar, Institutit të Transportit Rrugor dhe DPSHTRR, organizoi konferencën e IV-të shkencore ndërkombëtare me titull “Siguria rrugore dhe përdoruesit e rrugës në Shqipëri”.

Akademikë, profesionistë, ekspertë, nga brenda e jashtë vendit, studentë e punonjës të Policisë së Shtetit dhe të institucioneve publike e private që shprehën interes morën pjesë në punimet tyre në këtë konferencë.

Objekti kryesor i arritur i kësaj konference ishte paraqitja e analizave e prognozave gjithëpërfshirëse për sigurinë rrugore në Shqipëri, nëpërmjet punimeve profesionale me karakter shkencor dhe zhvillimi i debateve konstruktive rreth kushteve nxitëse, perceptimeve e veçorive të aksidenteve rrugore në shkallë vendi, si dhe rekomandimeve për politika, strategji, plane veprimi, praktika e bashkëpunime, në shërbim të institucioneve përgjegjëse dhe të një policimi efektiv.

Në këtë konferencë Qendra e Kërkimeve Shkencore prezantoi gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e projektit të saj kërkimor shkencor “Siguria rrugore në Shqipëri midis realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.

7. Në Shkurt 2020 u organizua konferenca v shkencore ndërkombëtare “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”.

QKSH e Akademisë së Sigurisë, organizoi konferencën e 5-të shkencore ndërkombëtare, me titull: “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare”.

Akademikë, studiues, profesionistë nga vendi e bota, studentë e punonjës të Policisë së Shtetit dhe të gjithë institucioneve ligjzbatuese e më gjerë, morën pjesë me punime, projekte, propozime dhe prezantime për konferencën.

Konferenca u organizua⁴⁸ në bashkëpunim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, Universitetin e Romës “Tor Vergata”, Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, Departamentin e Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Sociale të UT-së, Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin “Luarasi”, Tiranë; dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, si dhe të Bashkisë së Tiranës.

Objekti kryesor i kësaj konference ishte paraqitja e analizave dhe prognozave, si

⁴⁷ Konferenca IV Ndërkombëtare me temë “Siguria rrugore dhe përdoruesit e rrugës në Shqipëri” u organizua nga QKSH me 23 maj 2019.

⁴⁸ Konferenca e 5-të Shkencore ndërkombëtare, me titull: “Krimi mjedisor, siguria mjedisore dhe siguria kombëtare” u organizua me 11 shkurt 2020.

nga aspekti i hetimit të krimeve mjedisore, edhe në aspektin e trajtimit të sigurisë mjedisore në tërë rrafshin e saj të gjerë, ku ndikimet dhe gërshetimet gjenden te siguria kombëtare e ajo ndërkombëtare. Konferenca pati si objekt përmirësimin e dijes akademike lidhur me sigurinë mjedisore duke kontribuar përmes punimeve shkencore. Kjo dije synohet që t'i shërbejë përmirësimit të nivelit akademik e profesional policor që ka lidhje me krimin mjedisor dhe përballjen me veprat penale që kanë natyrë të tillë apo që gërshetohen me elementin mjedisor.

Të pranishëm në këtë konferencë ishin edhe Ministri i Mjedisit e Turizmit, Blendi Klosi; zëvendësministria e Brendshme, Romina Kuko, si dhe zëvendëskryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Robert Wilton.

Në këtë konferencë u prezantuar dhe gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet e projektit kërkimor të Qendrës Kërkimore Shkencore “Krimi mjedisor krimi dhe siguria mjedisore në Shqipëri mes realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave”.

8. Në maj 2021 u organizua konferenca vi shkencore ndërkombëtare “Fenomenet ekstreme të natyrës dhe çështjet e sigurisë”.

Akademikë, studiues, profesionistë nga vendi e bota, studentë e punonjës të Policisë së Shtetit dhe të gjithë institucioneve ligjzbatuese e më gjerë, morën pjesë me punime, projekte, propozime dhe prezantime për konferencën.

Fokusi i kësaj konference⁴⁹ ishte ndërtimi i një kornize mbi sigurinë publike në rastet e emergjencave civile duke sjellë prurje teorike e eksperiencë praktike me informacion të bollshëm mbi përgjegjësinë dhe vetëdijen e institucioneve, agjencive ligjzbatuese dhe Policisë së Shtetit si dhe gjithë shoqërisë në gjeohapsirën shqiptare e më gjerë. Fokusi i gjerë i kësaj konference lidhet pikërisht me specifikat e saj, që mund të ndodhin në hapësirë tokësore, detare e ajrore, te evidentimi i politikave, strategjive, legjislacionit, praktikave konkrete të trajtimit të sigurisë njerëzore në këndvështrimin e përgjegjësiave dhe detyrimeve. Në këtë aspekt dalin edhe vendi, roli dhe përgjegjësia që duhet të kenë strukturat shtetërore e civile nga situatat e thjeshta deri tek ato më komplekset.

Në këtë konferencë morën pjesë studiues dhe ekspertë vendas e të huaj, të çështjeve të sigurisë; drejtues dhe specialistë nga strukturat e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, nga strukturat e pushtetit vendor e qendror, organet e specializuara të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm; nga agjencitë ligjzbatuese; përfaqësues të misionëve të huaja policore që asistojnë Policinë e Shtetit; Instituti i Gjeoshkencës, Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), Shërbimet Meteorologjike, instituteve të ndërtimit, Akademisë së Shkencave, instituteve të kriminologjisë, të universiteteve që mbulojnë shkencat ekzakte, të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe të akademive që përafrojnë me fokus studimet për emergjencat civile; Universiteti i Durrësit, Universiteti i Tiranës, Akademia e Forcave të Armatosura, Unversiteti Tor Vergata; nga stafi i ushtarakëve të ushtrisë së Izraelit (ish-pjesëtarë të ekipit që erdhi në Shqipëri për tërmetin e 26.11.2019), përfaqësues të institucioneve akademike partnere në vend dhe të akademive, kolegjeve e universiteteve policore etj.

Punimet e prezantuara në këtë konferencë u botuan në numrat 21, 22 dhe 23 të revistës shkencore “Policimi dhe siguria”, ndërsa përfundimet dhe rekomandimet e kësaj konference u botuan në numrin 24 të kësaj reviste.

⁴⁹ Konferenca VI Shkencore Ndërkombëtare “Fenomenet ekstreme te natyres dhe ceshtjet e sigurise” u zhvillua me 31 Maj 2021.

9. Në prill 2022 QKSH organizoi konferencën e VII shkencore ndërkombëtare “Kërkimi shkencor dhe siguria publike”.

Kjo konferencë shkencore u organizua nga QKSH⁵⁰, në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit të financuar nga BE, ‘Për forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë’, me pjesëmarrje ekspertësh nga Shqipëria, Kosova, Finlanda dhe Estonia (fizike dhe virtuale). Konferenca kishte në qendër diskutime që lidhen me raportin e kërkimit shkencor me sigurinë publike. Aty u soll përvoja shqiptare dhe ajo finlandeze-estoneze, duke synuar një diskutim frytdhënës për të ardhmen.

Në konferencë morën pjesë përfaqësues nga institucione të ndryshme, si Akademia e Shkencave, Akademia e Forcave të Armatosura, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Akademia e Kosovës për Siguri Publike etj., si dhe staf pedagogjik e kërkimor i Akademisë së Sigurisë. Konferenca u mbyll me disa konkluzione dhe diskutime rreth tematikës kryesore.

Aktivitetet dhe shërbimet për realizimin me sukses të këtyre konferencave në pjesën më të madhe janë mbështetur financiarisht drejtpërsëdrejti nga aktor privat, publik dhe organizata ndërkombëtare të interesuara për sigurinë publike dhe kërkimin shkencor në këtë fushë.

II.c - Realizimi i botimeve shkencore

Këto botime janë të karakterit shkencor, të regjistruara sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Vetë revista shkencore “Policimi dhe siguria” është organ periodik, teoriko-shkencor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore të Akademisë së Sigurisë, e cila shërben për publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore të kësaj akademie në fushën e policimit dhe sigurisë, në përputhje me nevojat e zhvillimit të Policisë së Shtetit dhe jo vetëm. Qëllimi i botimit të revistës “Policimi dhe siguria”, është ofrimi i një platforme studimore, debati shkencor e profesional për studiues të ndryshëm, brenda organizatës së Policisë së Shtetit, por dhe më gjerë, ku të shkëmbehen mendime në lidhje me policimin, rendin e sigurinë publike dhe jo vetëm si dhe luftën ndaj krimit e çështje të tjera të lidhura me to. Realizimi i botimit të revistës menaxhohet nga sektori i botimeve të QKSH-së.

Revista “Policimi dhe siguria” është regjistruar në qendrën ndërkombëtare të ISSN-ve dhe është arritur marrja e numrit standard ISSN⁵¹. Veprimtaria për botimin e revistës “Policimi dhe siguria” është përgjegjësi e bordit editorial të saj, i cili përgjigjet për realizimin nga revista të standardeve shkencore e akademike dhe për orientimin e botimeve në përmbushje të nevojave të zhvillimit të Policisë së Shtetit.

Gjatë kësaj periudhë janë përgatitur dhe botuar 24 numra të revistës “Policimi dhe siguria”, revistë periodike shkencore e Akademisë së Sigurisë. Numri 25 është në përgatitje e sipër. Këto botime kanë pasur impakt dhe kanë ngjallur interes jo vetëm në qarqet akademike dhe intelektuale në vend e rajon, por edhe në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit. Në këto botime, gjithnjë e më tepër, po publikojnë shkrimet e tyre studiues e kërkues shkencorë nga sektorë të ndryshëm të Policisë së Shtetit dhe jo vetëm. Përveç botimeve *hard copy* të revistës “Policimi dhe siguria”, ka vazhduar publikimi i tyre edhe *online*. Për këtë janë njoftuar të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit për të pasur

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

⁵⁰ Konferenca e VII Shkencore Ndërkombëtare “Kërkimi shkencor dhe siguria publike” u zhvillua me datën 26 prill 2022.

⁵¹ Revista “Policimi dhe siguria” është regjistruar në qendrën ndërkombëtare të ISSN-ve me numrin ISSN 2413-1334

akses në to.

Është për t'u theksuar se nga viti në vit, pavarësisht planifikimit paraprak buxhetor të Qendrës së Kërkimeve Shkencore, financimi i botimit të kësaj reviste nga buxheti i Akademisë ka ardhur duke u shkurtuar, duke rrezikuar shumë seriozisht mundësinë e vazhdimit të botimit të saj.

Përvec revistës shkencore periodike janë përgatitur, miratuar dhe botuar:

- Fjalori shqip anglisht, me terminologjinë policore, në shërbim të punonjësve të policisë që janë në vijën e parë të kontaktit me të huaj që vijnë në vendin tonë.

- U përgatit dhe u botua numri special revistës “50 vite arsim i lartë policor” si dhe fletë palosje të ndryshme.

- QKSH ka qenë e angazhuar dhe në drejtim të trajnimit të kërkuesve të rinj shkencore. Për këtë janë zhvilluar tre kurse trajnimi me temë “Standardet evropiane të kërkimit shkencor dhe publikimeve të tyre” ku janë trajnuar të gjithë pedagogët e Fakultetit të Hetimit dhe Sigurisë si dhe ata të Kolegjit të Lartë Policor.

- Gjithashtu QKSH, në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Skënderbeut, si me rastin e përvjetorëve të Policisë së Shtetit ka organizuar dhe menaxhuar shumë aktivitete me studentet të Fakultetit të Hetimit, Kolegjit Policor si dhe personelin akademik të Akademisë së Sigurisë. Sipas rastin janë organizuar vizita dhe aktivitete me shkollat duke organizuar vizita të ndryshme në Akademinë e Sigurisë në ditët e dyerve të hapura të Policisë.

- Qendra Kërkimore Shkencore vazhdon të menaxhojë ueb-faqen e Akademisë së Sigurisë, duke pasqyruar në të gjithë dinamikën ditore të aktiviteteve që zhvillon Akademia e Sigurisë.

Më sipër paraqitem në mënyrë të përmbledhur dhe analizuar veprimtarinë kërkimore shkencore të Qendrës së Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë, në fushën e sigurisë dhe të rendit publik, për periudhën korrik 2015-maj 2022.

Në planin afatshkurtër të QKSH-së mbetet përfundimi me sukses i projektit kërkimor në proces “Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përbalimin e emergjencave civile” dhe në përmbyllje të tij:

- Realizimi i studimit të thelluar shkencor lidhur me sigurinë në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përbalimin e emergjencave civile.

- Organizimi i një konferencë shkencore ndërkombëtare me qëllim për të përthithur mendimin shkencor me të kualifikuar të kohës për këtë çështje si dhe prezantimin, nëpërmjet referuesve të QKSH-së, të gjetjeve dhe përfundimeve kryesorë të projektit kërkimor shkencor që do po realizohet nga ana jonë.

- Publikimi dhe shpërndarja e rezultateve të kësaj veprimtarie kërkimore shkencore nëpërmjet botimit të revistës “Policimi dhe siguria”, të materialeve të tjera të konferencës si dhe vënia e tyre në funksion të studenteve, pedagogëve të Akademisë, të strukturave qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit si dhe të institucioneve të tjera të interesuara për këtë fushë.

III. Pavarësia në punën kërkimore shkencore në Akademinë e Sigurisë

Në veprimtarinë e deritanishme, nuk ka pasur raste që në mënyrë të drejtpërdrejtë të jetë cenuar pavarësia akademike në veprimtarinë kërkimore shkencore të Qendrës Kërkimore Shkencore. Por ka pasur një “rrudhje” në mbështetjen financiare në veprimtarinë kërkimore shkencore të QKSH-së. Kështu është për t'u theksuar se nga

viti në vit, pavarësisht planifikimit paraprak buxhetor të kësaj qendre, financimi i botimit të revistës shkencore periodike “Policimi dhe siguria” nga buxheti i Akademisë ka ardhur duke u shkurtuar, duke rrezikuar shumë seriozisht mundësinë e vazhdimit të botimit të saj.

Gjithashtu kanë ardhur në vazhdimësi duke u shkurtuar fondet për organizimin e konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare. Deri tani, për realizimin me sukses të këtyre konferencave, kemi mbijetuar fale mbështetjes financiare të drejtpërdrejtë të aktiviteteve dhe shërbimeve për këto konferenca nga aktor privat, publik dhe organizata ndërkombëtare të interesuara për sigurinë publike dhe kërkimin shkencor në këtë fushë.

IV. Përfshirja e pedagogëve, studentëve dhe të kursantëve në projektet dhe veprimtaritë kërkimore shkencore të QKSH-së.

Objekti i parë në strategjinë për veprimtari kërkimore dhe zhvillimore të Qendrës Kërkimore Shkencore është përcaktuar “Zhvillimi dhe integrimi i kapaciteteve njerëzore studimore për veprimtarinë kërkimore-shkencore në Akademinë e Sigurisë”.

Si nënobjektiva në këtë Strategji është përcaktuar dhe:

a) Përfshirjen e kapaciteteve nga radhët e stafit akademik mësimdhënës, studentëve, kursantëve të Akademisë së Sigurisë në veprimtarinë kërkimore-shkencore;

Qendra Kërkimore Shkencore, në zbatim të objektivit dhe nënobjektivave të mësipërm është përpjekur në vazhdimësi dhe ka mundur:

- Përfshirjen e pedagogëve, studentëve dhe të kursantëve në projektet e saj kërkimore shkencore.

- Duke ju dhënë mundësinë pedagogëve, studentëve dhe të kursantëve të jenë pjesëmarrës aktiv në të gjithë konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare që ka organizuar Qendra Kërkimore Shkencore.

- Duke ju mundur më të spikaturve mundësinë e publikimit të punimeve të tyre në Revistën Shkencore të Akademisë së Sigurisë “Policimi dhe Siguria”.

Mendojmë se në këtë fushë ka akoma shumë për të bërë.

V. Partnerët tanë më të rëndësishëm në fushën e kërkimit shkencor

Për realizimin e veprimtarisë të mësipërme në fushën e kërkimit Qendra Kërkimore Shkencore ka bashkëpunuar me:

- Institucionet e Larta Arsimore brenda vendit si Universiteti i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Universiteti “Luarasi”, Universiteti “Zonja e Këshillit”, Akademia e Forcave të Armatosura etj.

- Institute të ndryshme studimore brenda vendit si Instituti i Policisë Shkencore, Instituti i Studimeve të Transportit, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Instituti Shëndetit Publik, Shkolla e Magjistraturës etj.

- Institucione të ndryshme brenda si Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, etj.

- Projekte dhe Misionet Policore që asistojnë Policinë e Shtetit dhe Akademinë e Sigurisë si PAMECA, ICITAP etj.

- Institucionet e Larta Arsimore jashtë vendit si Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Akademia e Sigurisë Shkup-Maqedoni, Universiteti i Romës “Tor Vergata”, Universiteti i Barit “Aldo Moro” etj.

- Institucione ndërkombëtare të sigurisë dhe jo vetëm, si OSBE- Organizata e Sigurisë

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

dhe Bashkëpunimit në Evropë, OBSH- Organizata Botërore e Shëndetësisë, NATO- Aleanca e Atlantikut të Veriut (Divizionin e Sigurisë Kibernetike të NATO-s)

II.d- Përfundime

Në përfundim të këtij punimi mund të konkludojmë se:

Qendra Kërkimore Shkencore⁵²:

- Ka krijuar një eksperience pozitive 7-vjeçare:
- në drejtim të kërkimit shkencor,
- projekteve të suksesshme,
- botimeve cilësore kërkimore,
- konferencave shkencore kombëtare e ndërkombëtare si forume të mendimit

kritik.

- Ka pasur në vazhdimësi një vlerësim pozitiv të klientëve (porositësve) për rezultatet e kërkimit shkencor që kemi realizuar në përputhje me kërkesat e tyre.

- Ka dhënë kontributin e saj në përmirësimin e politikave të sigurisë e më gjerë, përmes rezultateve që ka prodhuar puna kërkimore e reflektuar në konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare.

- Është e vetmja qendër që ofron trajnime lidhur me kërkimin shkencor, brenda institucionit të Policisë së Shtetit, duke e ofruar këtë gjë për të gjithë kategoritë e punonjësve, me lidhje akademike ose jo.

- Ka një vizion dhe një strategji për të ardhmen dhe punon e bazuar në një koncept të tillë, pra nuk vepron e pa orientuar.

- Ka një bashkëpunim në fushën e kërkimit shkencor me institucionet e tjera të arsimit të lartë në vend.

- Ka një bashkëpunim me institucione ndërkombëtare arsimore, gjë që shënon një pikë të lartë bashkëpunimi institucional në planin e kërkimit shkencor.

- Ka një bashkëpunim në fushën kërkimore shkencore edhe me institucione jo arsimore, por me rëndësi në fushën e sigurisë si p.sh. NATO, OSBE, UNDP, OBSH, etj.

- Ka një staf me një formim akademik në nivel të lartë, vlerësuar kjo dhe nga ekspertë të institucioneve kërkimore shkencore nga vende anëtare të Bashkimit Evropian.

- Veprimtaria e saj ka gëzuar mbështetjen dhe vlerësimin të autoriteteve më të larta ekzekutive dhe legislative në vend, si Kryeministri, Zëvendëskryetare e Parlamentit ministrat e brendshëm si dhe të drejtorëve të përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

- Qendra Kërkimore Shkencore në Akademinë e Sigurisë, ka fuqinë, mundësinë dhe kapacitetet për rritjen dhe me tej e nivelit të kërkimit shkencor me përmirësimin strukturor nëpërmjet kalimit në institut të kërkimeve shkencore

Rekomandime

Në përfundim të këtij punimi, pasi bëmë skanimin, analizimin, vlerësimin dhe identifikimin e problematikave që lidhen me raportet mes kërkimit shkencor dhe sigurisë publike, duke u përqendruar kryesisht në veprimtarinë e deritanishme të Qendrës së Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë, bazuar në gjetjet dhe përfundimet e mësipërme, mund të rekomandojmë:

- Përfshirja në një nivel më të lartë të pedagogëve, studentëve dhe të kursantëve në

⁵² Afërsisht në të njëjtat përfundime gjejmë dhe në analizën SWOT, të veprimtarisë së kësaj qendre, realizuar nga projekti i BE-së "Forcimi i Kapaciteteve dhe Efikasitetit të Akademisë së Sigurisë - Shqipëri, AL 18 IPA JH 01 19".

projektet kërkimore shkencore e në konferencat shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare që organizon Qendra Kërkimore Shkencore, duke ju dhënë gjithashtu më të spikaturve mundësinë publikimit të punimeve të tyre edhe në revistën shkencore të Akademisë së Sigurisë “Policimi dhe siguria.

- Rritja e mbështetjes financiare për veprimtarinë kërkimore shkencore të Qendrës së Kërkimeve Shkencore në Akademinë e Sigurisë.

- Përmirësimi strukturor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore si dhe shtimi i një njësie për projektet kërkimore shkencore, me qëllim rritjen e kapaciteteve konkurruese të QKSH-së në këtë fushë.

- Mbështetja e politikave që mundësojnë kalimin e QKSH-së në një institut të kërkimeve shkencore, duke vlerësuar këtë projekt si një investim serioz jo vetëm në fushën e rendit e të sigurisë publike, por dhe atë të sigurisë kombëtare.

Referencat

1. Ligji nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH”
2. Dokumenti i Politikave për Sigurinë Kibernetike 2015-2017, miratuar me VKM Nr. Nr. 973, datë 02.12.2015.
3. Cybersecurity Strategy of the European Union: An Open, Safe and Secure Cyberspace. Brussels, 7.2.2013.
4. Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 185 datë 22.5.2015.
5. Informacion përmbljedhës i analizave të Sektorit për Hetimin e Krimeve Kompjuterike, për vitet 2016 - 2018, dinamika e punës, prioritetet, kërkesat.
6. Rregullore e QKSH, miratuar nga Senati Akademik i Akademisë së Sigurisë, në mbledhjen e datës 29.01.2016.
7. Strategjia Zhvillimore e Akademisë së Sigurisë.
8. Strategjia e Qendrës së Kërkimeve Shkencore për Kërkim dhe Zhvillim 2016-2021.
9. Dr. Xhavit Shala, Studim “Mbi menaxhimin e karrierës dhe sistemi arsimor policor” fokusuar në Nivelin Bazë dhe Nivelin e Parë të Drejtimit në Policinë e Shtetit. Gjetje dhe rekomandime për politika që përmirësojnë punën për menaxhimin e procesit të ecurisë në karrierë të punonjësve të policisë që kanë mbaruar shkollën bazë të policisë”, Tiranë, Nëntor 2015.
10. Dr. Xhavit Shala, Msc Anisa Agastra, “Studimi vetëvrasja në Shqipëri. Prognozë analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2005-2015”, Tiranë, Korrik 2016.
11. Studim “Mbi ekzaminimin në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, të gjendjes së botimeve profesionale e juridike e të mjediseve ku mbahen dhe ofrohen ato”, Tiranë, Maj 2017.
12. Dr. Xhavit Shala, Msc Anisa Agastra, Kryekomisar Msc Bilbil Dervishi, “Studimi vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare në Shqipëri: prognozë juridike, historike, analitike e psikosociale dhe rekomandimet për hartimin e politikave. Fokusi në vitet 2007-2016. Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet”, Tiranë Mars 2018.
13. Dr. Xhavit Shala, “Siguria rrugore në Shqipëri mes realitetit dhe perceptimit”, Tiranë, Prill 2019.
14. Dr. Xhavit Shala, Strategji “Për rritjen e performancës së punës të strukturave të Policisë së Shtetit, të profilizuar për policinë kriminale, sigurinë publike dhe kufirin e migracionin, në punën me informatorët dhe rrjetin sekret informativ”, Tiranë, 2019.
15. Dr. Xhavit Shala, Draft udhëzimi i Ministrit të Brendshëm “Për burimet e informacionit policor dhe bashkëpunimin e fshehtë me individët”, Tiranë, 13.2.2019.
16. Dr. Xhavit Shala, “Studimi krimi dhe kërcënimet kibernetik në Shqipëri (Prognozë analitike dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave. Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet”, Tiranë, Janar 2020.
17. Dr. Xhavit Shala, Gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet në përfundim të projektit kërkimor shkencor “Mbi studimin, analizimin dhe vlerësimin e pritshmërive të Kursit të Parë Profesional Pasuniversitar “Specialist për Hetim Krimi”, Tiranë, Korrik 2020.
18. Dr. Xhavit Shala, Fatkeqësitë natyrore dhe çështjet e sigurisë mes realitetit dhe perceptimit. Gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e politikave, Tiranë, Maj 2021.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

Modeli i kërkimit shkencor në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike



Prof. asoc. dr. Bejtush GASHI
Dekan i Fakultetit të Sigurisë Publike, AKSP

Hyrje

Kërkimet shkencore në fushën e sigurisë publike, kanë funksione e tipare të përbashkëta me kërkimet shkencore të fushave të tjera të shkencës. Në Fakultetin e Sigurisë Publike / Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), puna kërkimore shkencore organizohet për zhvillimin e vazhdueshëm të procesit arsimor dhe trajnues në Akademi. Kërkimi shkencor konsiston në një proces reflektimi dhe kritike, qëllimi i të cilit është të sigurojë të dhëna të reja, fakte ose marrëdhënie në çdo fushë të dijes. Ai është i domosdoshëm për mësimdhënësit, studentët, si dhe për të gjitha profesionet, por veçanërisht ndihmon studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre kritike.

Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim në Fakultetin e Sigurisë Publike / AKSP merret me kërkime shkencore nga lëmi i drejtësisë, çështjeve sociale dhe shkencave të sjelljes (shkencave edukative, psikologji, etj.), ndërsa hulumtimet e aplikuara përqendrohen në projekte të cilat prodhojnë inovacione shoqërore të zbatueshme në lëmin e sigurisë publike.

Po ashtu, përqendrimi i kërkimeve që do të zhvillohen në të ardhmen në institut, parashihen të jetë në ato fusha ku kontributi shkencor është më domethënës dhe që

janë në funksion të avancimit të sigurisë publike.


Fakulteti i Sigurisë Publike, si pjesë e strukturës organizative të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, zhvillon programe të arsimit të lartë, hulumtimit dhe zhvillimit në fushën e sigurisë publike¹. Në misionin e tij ka përcaktuar qartë se Fakulteti do të ofrojë shërbime të cilësisë së lartë në fushën e arsimit, hulumtimit dhe zhvillimit për agjencionet e sigurisë publike në Republikën e Kosovës.

Veprimtaria kërkimore-shkencore përcaktohet përmes ligjit nr. 2004/42 “Për veprimtarinë kërkimore-shkencore”, përkatësisht nenit 2.2, “veprimtaria kërkimore-shkencore paraqet punën krijuese sistematike që ndërmerret me qëllim të kërkimit dhe zhvillimit të njohurive të reja, të shfrytëzimit dhe zbatimit të tyre në praktikë”². Puna kërkimore-shkencore realizohet përmes Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim, si njësi e strukturës organizative të fakultetit.

Në esencë veprimtaria kërkimore-shkencore është aktivitet për zgjidhjen e problemeve teorike dhe praktike, si dhe arritjen deri te njohuritë e reja në lëmin përkatës. Pra, kërkimi shkencor është proces për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave për disa qëllime³, apo një shqyrtim sistematik, kontrollues, empirik dhe kritik i dukurive të natyrës, udhëhequr nga teoria dhe hipotezat për studimin e lidhjeve të supozuara midis dukurive. Hulumtimi në terma më të thjeshtë është kërkimi i njohurive dhe kërkimi i së vërtetës. Në kuptimin formal është një studim sistematik i një problemi të caktuar sipas një strategjie të zgjedhur qëllimisht, e cila fillon me zgjedhjen e një qasjeje në drejtim të hartimit të hipotezave kërkimore, zgjedhjes së metodave dhe teknikave, përzgjedhjes ose zhvillimit të mbledhjes së të dhënave, mjeteve, përpunimit të të dhënave, interpretimi dhe përfundimit me paraqitjen e zgjidhjeve të problemit.⁴ Ndërsa studiuesi John W. Creswell, thotë se: kërkimi është një proces hapash që përdoren për të mbledhur dhe analizuar informacionin për të rritur të kuptuarit tonë për një temë ose çështje të caktuar. Ai përbëhet nga tre hapa: parashtrimi i një pyetjeje, mbledhja e të dhënave për t’u përgjigjur pyetjes dhe paraqitja e një përgjigjeje për pyetjen e bërë.⁵

Meqenëse objekt studimi i këtij punimi, është të kuptuarit e modelit të kërkimit shkencor në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, atëherë po paraqesim një pasqyrë të hierarkisë organizative të AKSP-së.

Organogrami i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike



AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

«Kërkimi shkencor dhe siguria publike»

Praktika e kërkimeve në lëmin e sigurisë i ka tejkaluar ndarjet strikte metodologjike të kërkimit shkencor, për shkak se, edhe pse mund të përcaktohem për qasjen metodologjike kualitative, apo qasjen metodologjike kuantitative, dukuritë në siguri i përfshijnë të dyja. Pra, komponentët kualitativë dhe kuantitativë, nga fakti se jo të gjitha dukuritë mund të maten saktë dhe në mënyrë precize.

Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim

Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim, merret me fushën ekërkimeve themelore dhe kërkimeve të aplikuara, që janë në lidhje të ngushtë me nevojat e “avancimit të fushës së arsimit si dhe të hulumtimit dhe zhvillimit”⁶ në lëmin e sigurisë publike. Fokusi i hulumtimeve është sistemi i drejtësisë, çështjet sociale dhe shkencave të sjelljes (shkencave edukative, psikologjikë, etj.), ndërsa hulumtimet e aplikuara përqendrohen në projekte të cilat prodhojnë inovacione shoqërore të zbatueshme në lëmin e sigurisë publike. Hulumtimi dhe zhvillimi shihen si një proces ku theksi bie në hulumtimin e aplikuar që mbështet arsimimin në Fakultetin e Sigurisë Publike/AKSP, pra zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në Fakultetin e Sigurisë Publike dhe proceset e trajnimit në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Në të ardhmen planifikohet që në institut përqendrimi i kërkimeve që do të zhvillohen, të jetë i fokusuar në ato fusha ku kontributi shkencor është më domethënës dhe që janë në funksion të avancimit të sigurisë publike.

Instituti kryen hulumtime në fushën e sigurisë publike dhe ofron asistencë shkencore dhe teknike për agjencitë e sigurisë publike, organet e pushtetit dhe subjektet e tjera të sigurisë. Si institucion i fokusuar në hulumtime, instituti synon të njihet në vend për hulumtime cilësore në fushën e sigurisë dhe vendosje të agjendave përmes kontributit që japin hulumtuesit tanë për shoqërinë. Këtë objektiv synon ta përmbushë përmes stafit hulumtues-akademik të fakultetit, bashkëpunëtorëve kërkimorë dhe stafit tjetër profesional dhe shkencor nga fakultetet dhe institucionet shkencore vendase dhe të huaja, si dhe duke angazhuar studentët e Fakultetit të Sigurisë Publike, vijuesit e trajnimeve dhe të arsimit të akademisë dhe zyrtarët e institucioneve të sigurisë.

Në aktivitetet e tyre kërkimore, instituti harton projekt propozime, organizon dhe kryen projekte kërkimore të niveleve lokale, kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me institucionet e tjera të hulumtimit dhe zhvillimit të arsimit të lartë dhe agjencioneve të sigurisë publike.

Personeli akademik është i obliguar të bëjë hulumtime shkencore në përputhje me aftësitë e tyre profesionale me qëllim të avancimit të mësimdhënies, organizimit të kërkimeve të ndryshme, anketimit të studentëve dhe analizimit të të dhënave në interes të forcimit të planit akademik dhe zhvillimit të AKSP-së.

Në këtë institut angazhohet stafi dhe studentët e Fakultetit të Sigurisë Publike, duke

¹ Rregullore (QRK) Nr. 05/2019 për Arsimin e lartë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, neni 4.

² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës (2011) *Ligji Nr. 2004/42 Për veprimtarinë kërkimore – shkencore*. E disponueshme:

<http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php>

?option=com_content&task=view&id=35&Itemid=28 (vizituar më 10. 06. 2022).

³ Murati, Xheladin. (2004). Metodologjia e kërkimit pedagogjik, (botim i tretë), “Çabej”, Tetovë, f. 38.

⁴ Grover, Vijay. (2015). Research Approach: An Overview. Golden Research Thoughts. International Multidisciplinary Research Journal, Vol 4 Issue 8 Feb 2015, ISSN No :2231-5063.

⁵ Creswell, J.W. (2008). Educational Research: Planning, conducting, and evaluating quantitative and qualitative research (3rd ed.). Upper Saddle River: Pearson.

⁶ Rregullore (AKSP)- Nr. 02/2021 për funksionimin e Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim në Fakultetin e Sigurisë Publike.

synuar të përfshijë edhe vijuesit e trajnimeve dhe arsimimit të Akademisë dhe zyrtarët e institucioneve të sigurisë. Instituti për hulumtim dhe zhvillim i FSP/AKSP, është i hapur dhe mirëpret bashkëpunimin e studiuesve dhe kërkuesve shkencorë nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat, brenda e jashtë Republikës së Kosovës.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim

Instituti është në shërbim të agjencive të sigurisë publike duke zhvilluar aktivitetet e tyre, si dhe duke krijuar inovacione të bazuara në nevojat që ato kanë. Projektet kërkimore i plotësojnë kërkesat më të larta shkencore. Aktualisht kërkimi shkencor është i fokusuar në këto fusha:

- fushën e edukimit, kërkimit dhe të zhvillimit në sigurinë publike;
- iniciimi i projekteve kërkimore me ekipe në tema të caktuara interdisiplinare të kërkimeve shkencore, të cilat do të ndiqen përmes ngjarjeve publike;
- inkurajimi dhe mbështetja e stafit akademik të FSP-së, për të aplikuar për kërkime shkencore grupe;
- inkurajimi dhe motivimi i stafit mësimor të FSP-së, përmes mundësive të kërkimeve grupe.
- zhvillimi i një sistemi për vlerësimin e punës kërkimore;
- integrimi i punës kërkimore shkencore si pjesë përbërëse e punës së stafit akademik, duke filluar nga pozita e asistentit mësimdhënës; të plotësohen kontratat e punës së stafit akademik, për të theksuar shprehimisht realizimin e punës kërkimore dhe raportimin, së paku dy herë në vit;
- krijimi i platformave/qendrave kërkimore ku stafi akademik prezanton dhe diskuton punën kërkimore-shkencore;
- seria e punëtorive: bërja e kërkimit përmes institutit (seancat e trajnimit semestral me stafin e fakultetit për të rritur aktivitetin kërkimor);
- funksioni lehtësues për stafin akademik dhe karakteri mbështetës hulumtues;
- organizimi i tryezave shkencore/forume për disa tema në kuadër të programit të institutit, si dhe takimet për platforma kërkimore që duhet të mbahen të paktën një herë në muaj, ku diskutimet duhet të shërbejnë për kërkimin e aplikuar;
- stafi akademik duhet të përfshijë studentët në projektet e tyre kërkimore-shkencore.

Objektivat për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore

Kërkimi shkencor realizohet në përputhje me misionin dhe në fusha të ndryshme brenda programeve të Fakultetit të Sigurisë Publike. Instituti ka përcaktuar objektivat për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, të cilat janë të lidhura ngushtë me ngritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në FSP/AKSP. Për secilin objektiv janë përcaktuar masat e nevojshme për arritjen e tij, ndërsa për çdo masë janë përcaktuar rezultatet e pritshme në formë të treguesve të suksesit që shërbejnë për përcjelljen e progresit. Objektivat zhvillimore bashkë me masat e ndërlydhura, janë:

- I. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore-shkencore:*
- krijohet fondi për bursa për qëndrime afatshkurtra hulumtuese të personelit akademik jashtë vendit;
 - nxitet qasja ndërdisiplinore në veprimtarinë kërkimore-shkencore;
 - zhvillohen kriteret për stimulim material të personelit të përfshirë në punën kërkimore-shkencore;
 - përmirësimi i mundësive për të bërë një karrierë progresive si hulumtues për

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

studiues të rinj; rritjen e numrit të pozitive me mandate shtesë;

- përcaktohen obligimet kontraktuale për kontribut në veprimtarinë kërkimore-shkencore.

II. Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore:

- themelimi dhe ngritja e bashkëpunimit në vazhdimësi, me partnerët strategjikë vendorë dhe ndërkombëtarë;

- organizimi dhe pjesëmarrja në aktiviteteve të ndryshme në nivel dhe në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

III. Rritja e mbështetjes financiare për kërkimin shkencor.

IV. Publikimet/krijimi i revistës shkencore në fushën e sigurisë publike.

Fakulteti i Sigurisë Publike ka një politikë për inkurajim dhe përkrahje të punës hulumtuese të studentëve dhe të mësimeve të reja, studentët vazhdimisht përfshihen në kurseve të veçanta që mundësojnë rrënjosjen e parimeve të metodës shkencore, fakulteti në programe studimore të veta ofron mundësinë e kryerjes së projekteve shkencore, nën udhëheqje të mentorëve për temat e diplomës që ofrohen nga Këshilli i Fakultetit.

Me qëllim të ngritjes së brezit të ri kërkimor-shkencor dhe rrënjosjes së parimeve të metodës shkencore dhe zhvillimin e njohurive të reja, studentët vazhdimisht përfshihen në aktivitetet kërkimore-shkencore të destinuara për studentët, si dhe në projektet kërkimore-shkencore të stafit akademik. Fakulteti ka ndërmarrë një sërë veprimesh për të siguruar infrastrukturën e domosdoshme për veprimtari të mirëfilltë kërkimore-shkencore, në kuptim të zhvillimit të bibliotekës shkencore, funksionalizimin e shërbimit informativ shkencor, mbështetjen e veprimtarisë botuese shkencore dhe aktivitetet për zhvillimin e laboratorëve hulumtues. Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim, merret me këto veprimtari:

- nxit veprimtarinë kërkimore-shkencore me qëllim të integritimit në hapësirën shkencore ndërkombëtare, rrënjosjen e parimeve të metodës shkencore dhe zhvillimin e njohurive të reja ndër brezat e rinj të shoqërisë në përgjithësi;

- zhvillon aktivitetet për intensifikimin e bashkëpunimit në sferën e veprimtarisë kërkimore-shkencore me institucionet e tjera vendore dhe nërkombëtare, në kuptim të zhvillimit të programeve hulumtuese të përbashkëta, kryerjen e studimeve dhe kërkimeve me karakter teorik e praktik, nga fusha të ndryshme me interes të veçantë;

- motivon dhe përkrah tërë stafin e vet akademik për punë krijuese sistematike, me qëllim të kërkimit dhe zhvillimit të njohurive të reja, si dhe shfrytëzimit dhe zbatimit të këtyre rezultateve në praktikë;

- planifikon infrastrukturën e domosdoshme për veprimtari të mirëfilltë kërkimore-shkencore dhe ndërmerr aktivitetet për zhvillimin e laboratorëve hulumtues;

- kujdeset për pajisjen dhe funksionimin e mirëfilltë të bibliotekës shkencore;

- funksionalizimin e shërbimit informativ shkencor;

- mbështet veprimtarinë botuese shkencore.

Si institucion, po ashtu, janë zhvilluar aktivitetet për intensifikimin e bashkëpunimit në sferën e veprimtarisë kërkimore-shkencore me institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare, në kuptim të zhvillimit të programeve hulumtuese të përbashkëta, kryerjen e studimeve dhe kërkimeve me karakter teorik e praktik nga fusha të ndryshme me interes të veçantë, mbështetjen për zbatimin e rezultateve të kërkimeve shkencore në praktikë, rritjen në vëllim dhe rritjen në cilësi të veprimtarisë kërkimore-shkencore, mbështetjen, përkrahjen dhe motivimin e punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve për t'u marrë me punë kërkimore-shkencore, mbështetjen e veprimtarisë botuese

shkencore, mbështetjen dhe nxitjen e krijimit të lidhjeve ndërmjet institucionale për realizimin e veprimtarisë së përbashkët kërkimore-shkencore.

Shërbimet informative shkencore, në mënyrë sistematike, gjatë tërë viti kalendarik, bëjnë njoftimin e stafit akademik me agjendën e takimeve, konferencave dhe kongreseve nacionale dhe ndërkombëtare në lëmitë përkatëse, në mënyrë që të përparojë veprimtaria në fushën e publikimeve, si dhe të informimit adekuat kërkimor-shkencor.

Përfundime

Fakulteti i Sigurisë Publike/AKSP-ja, ka krijuar kornizë themelore ligjore dhe strukturat institucionale që kanë potencial për të zhvilluar kërkime shkencore, mirëpo zbatimi dhe funksionalizmi i kësaj strukture në rrafshin praktik, mbetet një problematikë e përgjithshme. Korniza ligjore dhe e politikave, siç është *Strategjia zhvillimore 2019-2022 e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike*, e nxisin veprimtarinë kërkimore e shkencore, por kufizimet strukturore dhe financiare/buxhetore në njërin anë, si dhe pjesëmarrja e kufizuar e Fakultetit të Sigurisë Publike në projektet dhe iniciativat e kërkimit shkencor në anën tjetër, janë ndër sfidat e Institutit për Hulumtime dhe Zhvillim. Mirëpo, fakulteti synon të mbështesë, promovojë dhe të avancojë kapacitetet dhe potencialet kërkimore, veçanërisht projektet e kërkime shkencore prej të cilave do të përfitojnë studentët, mësimdhënësit, agjencionet e sigurisë publike, si dhe ato që janë në funksion të avancimit të sigurisë publike në përgjithësi.

Politikat e financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore në fushën e sigurisë, duhet të ndryshohet në përgjithësi dhe shkencat e sigurisë në veçanti, për të siguruar fonde për iniciativat kërkimore që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen në Kosovë. Aktualisht, Kosova ka shkallën më të ulët të investimeve për veprimtarinë shkencore në rajon, arrin në vetëm 0.1% të BPV, e cila është larg nga mesatarja evropiane.

Agjenda e kërkimeve shkencore në Fakultetin e Sigurisë Publike/AKSP, shihen si një proces ku theksi bie në hulumtimin e aplikuar që mbështet arsimimin në fakultet, pra, zhvillimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe proceset e trajnimit në akademi.

Në të ardhmen planifikohet që në institut përqendrimi i kërkimeve që do të zhvillohen, duhet të jetë në ato fusha ku kontributi shkencor është më domethënës dhe që janë në funksion të avancimit të sigurisë publike.

Literatura

1. Blystone, R., Blodgett, K. (2006). *Metoda shkencore*. Marrë më 21 dhjetor nga: ncbi.nlm.nih.gov.
2. Creswell, J.W. (2008). *Educational Research: Planning, conducting, and evaluating quantitative and qualitative research* (3rd ed.). Upper Saddle River: Pearson.
3. Grover, Vijey. (2015). Research Approach: An Overview. *Golden Research Thoughts. International Multidisciplinary, Research Journal*, Vol 4 Issue 8 Feb 2015, ISSN No :2231-5063.
4. Murati, Xheladin. (2004). Metodologjia e kërkimit pedagogjik, (botimi i tretë), "Çabej", Tetovë.
5. Voit E. (2019) *Perspektiva: Dimensionet e metodës shkencore*.
6. Wilson, K., Rigakos, B. (2016) *Vlerësimi i rrjedhës së procesit shkencor (SPFA) Baza ligjore*
7. Ligji për Veprimtari kërkimore shkencore 04/ L-135;
8. Plani Kombëtar i Shkencës- Udhëzimi administrativ: <https://masht.rks-gov.net/uploads/2017/08/1-2017-ua-per-publikime-dhe-botime-shkencore-rotated.pdf>
9. Rregullore (AKSP) - Nr. 02/2021 për funksionimin e Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim në Fakultetin e Sigurisë Publike
10. Strategjia zhvillimore dhe plani i veprimit të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për vitet 2019 – 2022
11. ALLEA-Kodi Europian i sjelljes për kërkimin shkencor-for-Research-Integrity.
12. Raporti: Gjendja e Kërkimeve në Kosovë, RIDEA, Austrian Development Cooperation, Prishtinë, nëntor 2012

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

Mbështetja e AKKSHI për projektet e kërkimit shkencor në fushën e sigurisë publike



Znj. Mirela MUÇA
Drejtoresha e Përgjithshme
e Agjencisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin

Siguria publike është një faktor i rëndësishëm si në jetën publike ashtu edhe në atë private. Gjithashtu, siguria publike është një nga sektorët më të rëndësishëm e të vështirë, për shkak të disa specifikave historike, kulturore, sociale, ligjore dhe financiare të cilat ndikojnë jetën e njerëzve në përgjithësi dhe sigurinë e tyre në veçanti.

Është shumë e vështirë të krahasosh politikat e sigurisë publike, nëse nuk ke instrumentet e nevojshëm të vlerësimit të këtyre politikave, kërkimit dhe studimit të fenomeneve. Politikat me efikase dhe praktikatat më të mira në ruajtjen e sigurisë publike, janë pikërisht ato që vijnë si rezultat i kërkimeve shkencore serioze, të cilat janë të rëndësishme si në procesin e zhvillimit të politikave lokale ashtu edhe në ato rajonale e globale.

Për fat të mirë Akademia e Sigurisë (AS) sot prezanton një institucion të arsimit të lartë (IAL) me një vizion që orientohet tek kërkimi shkencor po aq sa orientohet tek edukimi cilësor, profesional e bashkëkohor. Qendra shkencore e ngritur brenda Akademisë si njësi më e mirë e kërkimit shkencor në fushën e sigurisë në Shqipëri, mundëson projekte kërkimore e shkencore që ndihmojnë si në vlerësimin e politikave në fushën e sigurisë ashtu edhe analizën lokale, rajonale të efektivitetit teknik të sistemeve të sigurisë publike, duke përdorur metoda bashkëkohore të kërkimit shkencor për të identifikuar praktikatat më të mira të cilat duhet të shërbejnë si pikë referimi për politikëbërësit.

Nisur nga ky këndvështrim, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe

Inovacionit (AKKSHI) ka vlerësuar dhe inkurajon projektet kërkimore shkencore në këtë fushë. Nëpërmjet financimit të projekteve kërkimore AS-ja mund të bëhet qendra e cila analizon cilësinë e politikave të sigurisë ose faktorët që mund të ulin efektivitetin e këtyre politikave siç janë: emigracioni, pabarazitë socio-ekonomike, korrupsioni, situatat gjeopolitike etj. Nga ana tjetër nëpërmjet gjetjeve dhe rekomandime që dalin nga kërkimet shkencore, AS-ja mund të bëhet, qendra burimore kryesore e cila propozon politika efektive dhe të përshtatura me situatën në vend.

Në vitet e fundit, ngjarje masive, fatkeqësi natyrore, ngjarje të shëndetit publik, ngjarje të sigurisë publike dhe emergjenca të tjera po ndodhin për vendin, rajonin e mbarë planetin. Për shkak të emergjencës që paraqesin këto situata, ashpërsisë së rrezikut dhe natyrës publike dhe gjithëpërfshirjes, shpesh kemi menduar se si t'i kapërcejmë ato, dhe jo ti analizojmë e ti parandalojmë. Si një pjesë e rëndësishme e të gjithë sistemit publik të menaxhimit të krizave, siguria e vlerësimit të rrezikut publik është bërë një pjesë e rëndësishme e qeverisjes publike moderne. Për këtë arsye iniciativa kërkimore e AS-së, "Siguria në komunitet në kontekstin e kërcënimeve nga fenomenet ekstreme natyrore dhe nevojave për përbalimin e emergjencave civile", është vlerësuar nga ana e AKKSHI-së, si një projekt shumë i rëndësishëm, i cili mund të mbështesë veprimet, programet e politikat e qeverisë në këtë fushë.

Projekti është i financuar nga Programi Kombëtar i Kërkimit dhe Zhvillimit (PKKZH), i cili mbështet kërkime të rëndësishme që konvergojnë me prioritetet sociale e ekonomike të vendit. Programi i PKKZH-ve krahas mbështetjes së prioritetëve, është fokusuar edhe në cilësinë e kërkimit shkencor, relevancën me strategjitë sektoriale si edhe me fuqizimin e kapaciteteve të brendshme të institucioneve të arsimit të lartë për kërkim shkencor dhe nxitjen e studimeve doktorale në fushën e sigurisë publike.

Ky ishte bashkëpunimi i parë ndërmjet AS-së dhe AKKSHI-së, të cilin jemi duke e ndjekur me vëmendje për cilësinë dhe rezultatet që do na japë. Nga ana tjetër jemi të bindur që rezultatet e marra nga kërkime shkencore aplikative të kësaj natyre, do të shërbejnë për të ndërtuar politika për një të ardhme të qëndrueshme në të mirë të njerëzve.

Ne jemi një vend i vogël, me mundësi ekonomike modeste të investimit në shkencë, megjithatë ne kemi shkencëtarë dhe talente të cilët falë programeve kombëtare dhe ndërkombëtare kanë kontribuar me dinjitet në njohjen ndërkombëtarisht të shkencës shqiptare, duke prezantuar aty vlerat tona të kërkimit, etikën dhe reciprocitetin. AKKSHI është i angazhuar që nëpërmjet mekanizmave financiar që ka në dispozicion, të vazhdojë mbështetjen e kërkimit shkencor në fushën e sigurisë publike, veçanërisht në fuqizimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor në Akademinë e Sigurisë.

Tre parime thelbësore drejtojnë politikat e qeverisë shqiptare për mbështetjen e kërkimit shkencor: cilësia, pavarësia dhe njohja ndërkombëtare. Për këtë kërkohet që përveç seriozitetit në punë kërkimore, shkencëtarët tanë të prezantohen me dinjitet edhe në arenën ndërkombëtare. Në këtë aspekt AKKSHI ka një rrol për të luajtur edhe në fuqizimin e kapaciteteve të kërkimit shkencor në funksion të pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, dy-paleshe dhe shumëpalëshe. Ne inkurajojmë AS-në, të marrë pjesë në projekte të përbashkëta që mund të realizohen me vendet si Italia, Austria Kosova e Turqia, me të cilët kemi marrëveshje dypalëshe. Por AKKSHI angazhohet të mbështesë AS-në të marrë pjesë në konsorciume dhe partneritete edhe më të gjera në kuadrin e programeve ndërkombëtare siç janë *Horizon Europa*, *Erasmus+* etj. Kjo përfshin edhe veprime që informojnë mbi thirrjet ndërkombëtare për projekte, konceptimin dhe shkrimin e tyre si dhe gjetjen e partnerëve institucionalë.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

Bashkëpunimi me institucionet simotra të kërkimit shkencor, një kërkesë dhe nevojë për të garantuar më tej sigurinë publike



Prof. Dr. Irakli KOÇOLLARI
Drejtori i Projekteve, Akademia e Shkencave

Më duhet të them që në fillim të fjalës time se tanimë është një fakt që konstatohet qartë se Akademia e Sigurisë, vitet e fundit, përherë e më tepër ka marrë profilin e një institucioni të vërtetë kërkimor-shkencor me pretendime në radhën e IAL-ve, që jo vetëm përcjell dije, por edhe prodhon ide, mendim të kualifikuar shkencor, ofron alternativa konkurruese dhe shtohet në tryezat e debatit shkencor me partnerë evropianë e më gjerë, në mënyrë të denjë.

Vetë kjo konferencë dhe të tjera si kjo, të organizuara edhe më herët nga Akademia e Sigurisë, janë tregues i qartë i asaj pune serioze që bëhet jo vetëm nga Qendra e Kërkimeve Shkencore, por edhe nga i gjithë stafi i atij institucioni.

Duke qenë një institucion i tillë, në mënyrë të natyrshme Akademia e Sigurisë, përherë e më tepër, është renditur me dinjitet përkrah institucioneve të tjera të arsimit të lartë, me personalitetin dhe individualitetin e saj. Krahas të tjerave kjo akademi ka nisur prej më shumë se një viti bashkëpunimin edhe me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Në këtë kuadër Akademia e Shkencave, nga ana e saj, në kuadrin e vlerësimit të çështjeve të sigurisë kombëtare dhe të detyrimeve, - si një vend që merr përsipër barrën dhe misionin e sigurisë shtetërore dhe rajonale, - përmes Asamblesë së kësaj Akademie, si organ vendimmarrës, ka paravendosur në planet e saj të dy viteve të fundit, që të nxisë bashkëpunimin edhe me institucionet e rëndësishme të përgatitjes dhe kualifikimit të gjeneratave që do të marrin përsipër detyrat delikate të ligjzbatuesve

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

të garantimit të rendit kushtetues: për të garantuar rendin dhe qetësinë publike, për t'u përballur me shkelësit e ligjit, për të sakrifikuar dhe parandaluar pasojat e rënda që sjellin për shoqërinë krimi dhe kriminaliteti në tërësi.

Në këtë kuadër, qysh përpara gati një viti, Akademia e Shkencave të Shqipërisë ka nënshkruar me Akademinë e Sigurisë një marrëveshje bashkëpunimi ku mes të tjerave parashikohen:

- organizimi i veprimtarive shkencore të përbashkëta për këto subjekte, me interes për fushat e sigurisë, rendit dhe në tërësi luftën kundër kriminalitetit;

- takime periodike për të këmbyer mendime për çështje me interes shkencor sikundër mbështetja për tituj dhe grada shkencore, drejtimi dhe udhëheqja e doktorantëve të rinj, etj.;

- dhurimi në mënyrë periodike për Akademinë e Sigurisë, i literaturës shkencore që prodhon Akademia e Shkencave të Shqipërisë: monografi, studime, buletine shkencorë, referate me interes, etj., të cilat do t'i shërbenin Akademisë së Sigurisë jo vetëm për nevojat e formimit profesional, por edhe për të pajisur punonjësit e rinj të këtyre sektorëve me një kulturë të përgjithshme, nga lëmijt e albanologjisë, kulturës, traditave kombëtare etj.;

- duke thelluar edhe më tej këto përpjekje për bashkëpunim reciprok mes dy institucioneve, Akademia e Shkencave të Shqipërisë po punon dhe bashkëpunon me drejtuesit e Akademisë së Sigurisë për ngritjen dhe vënien në funksionim të Komisionit të Përhershëm të Sigurisë. Bëjmë me dije se në komisionet e përhershme pranë Akademisë janë struktura që programojnë dhe hartojnë studime, analiza dhe prognoza për lëmij dhe fusha të ndryshme me interes politik, ekonomik, diplomatik dhe shkencor, etj., dhe produkt ky që ofrohet për strukturat qeverisëse dhe vendimmarrëse.

Ngritja e një komisioni të tillë do t'i shërbejë interesave për hartimin e studimeve dhe platformave të sigurisë kombëtare, strategjisë dhe gjeostrategjisë, misionit për të garantuar qetësinë dhe rendin kushtetues, luftën dhe përpjekjet për parandalimin dhe zbulimin e kriminalitetit, etj.

Në këtë kuadër Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë po punon për:

- hartimin e platformës së këtij komisioni;
- përzgjedhjen e një stafi profesionistësh të dalluar në fushat e kërkimit shkencor për çështjet e sigurisë;

- vlerësimin e objektivave prioritare, për të parandaluar kërcënimet dhe rreziqet që cenojnë sigurinë kombëtare;

- bashkëpunimin me specialistë të fushës së mbrojtjes, sikundër profesionistë të spikatur të Akademisë së Forcave të Armatosura;

- organizimin e takimeve permanente me përfaqësues të Ministrisë së Rendit dhe të asaj së Mbrojtjes;

- tërheqjen e mendimit të profesionistëve, studiuesve të dalluar në fusha të tjera që lidhen me sigurinë, sikundër siguria kibernetike, siguria ushqimore, strukturat që ndjekin krimin e organizuar, trafiket e lëndëve narkotike dhe të qenieve njerëzore, etj.

Synimi i ngritjes dhe funksionimit të këtij komisioni do të jetë, puna permanente për:

- përcaktimin e fushave dhe objektivave të rëndësishme të sigurisë kombëtare;

- ndjekjen dhe vlerësimin e zhvillimeve politike në rajon dhe më gjerë në interes të sigurisë kombëtare;

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

Të nderuar të pranishëm ju përshëndes në emër të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe i uroj kësaj konference punime të mbara!

Më duhet të them që në fillim të fjalës time se tanimë është një fakt që konstatohet qartë se Akademia e Sigurisë, vitet e fundit, përherë e më tepër ka marrë profilin e një institucioni të vërtetë kërkimor-shkencor me pretendime në radhën e IAL-ve, që jo vetëm përcjell dije, por edhe prodhon ide, mendim të kualifikuar shkencor, ofron alternativa konkurruese dhe shtohet në tryezat e debatit shkencor me partnerë evropianë e më gjerë, në mënyrë të denjë.

Vetë kjo konferencë dhe të tjera si kjo, të organizuara edhe më herët nga Akademia e Sigurisë, janë tregues i qartë i asaj pune serioze që bëhet jo vetëm nga Qendra e Kërkimeve Shkencore, por edhe nga i gjithë stafi i atij institucioni.

Duke qenë një institucion i tillë, në mënyrë të natyrshme Akademia e Sigurisë, përherë e më tepër, është renditur me dinjitet përkrah institucioneve të tjera të arsimit të lartë, me personalitetin dhe individualitetin e saj. Krahës të tjerave kjo akademi ka nisur prej më shumë se një viti bashkëpunimin edhe me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Në këtë kuadër Akademia e Shkencave, nga ana e saj, në kuadrin e vlerësimit të çështjeve të sigurisë kombëtare dhe të detyrimeve, - si një vend që merr përsipër barrën dhe misionin e sigurisë shtetërore dhe rajonale, - përmes Asamblesë së kësaj Akademie, si organ vendimmarrës, ka paravendosur në planet e saj të dy viteve të fundit, që të nxisë bashkëpunimin edhe me institucionet e rëndësishme të përgatitjes dhe kualifikimit të gjeneratave që do të marrin përsipër detyrat delikate të ligjzbatuesve të garantimit të rendit kushtetues: për të garantuar rendin dhe qetësinë publike, për t'u përballur me shkelësit e ligjit, për të sakrifikuar dhe parandaluar pasojat e rënda që sjellin për shoqërinë krimi dhe kriminaliteti në tërësi.

Në këtë kuadër, qysh përpara gati një viti, Akademia e Shkencave të Shqipërisë ka nënshkruar me Akademinë e Sigurisë një marrëveshje bashkëpunimi ku mes të tjerave parashikohen:

- organizimi i veprimtarive shkencore të përbashkëta për këto subjekte, me interes për fushat e sigurisë, rendit dhe në tërësi luftën kundër kriminalitetit;

- takime periodike për të këmbyer mendime për çështje me interes shkencor sikundër mbështetja për tituj dhe grada shkencore, drejtimi dhe udhëheqja e doktorantëve të rinj, etj.;

- dhurimi në mënyrë periodike për Akademinë e Sigurisë, i literaturës shkencore që prodhon Akademia e Shkencave të Shqipërisë: monografi, studime, buletine shkencorë, referate me interes, etj., të cilat do t'i shërbenin Akademisë së Sigurisë jo vetëm për nevojat e formimit profesional, por edhe për të pajisur punonjësit e rinj të këtyre sektorëve me një kulturë të përgjithshme, nga lëmijt e albanologjisë, kulturës, traditave kombëtare etj.;

- duke thelluar edhe më tej këto përpjekje për bashkëpunim reciprok mes dy institucioneve, Akademia e Shkencave të Shqipërisë po punon dhe bashkëpunon me drejtuesit e Akademisë së Sigurisë për ngritjen dhe vënien në funksionim të Komisionit të Përhershëm të Sigurisë. Bëjmë me dije se në komisionet e përhershme pranë Akademisë janë struktura që programojnë dhe hartojnë studime, analiza dhe prognoza për lëmi dhe fusha të ndryshme me interes politik, ekonomik, diplomatik dhe shkencor, etj., dhe produkt ky që ofrohet për strukturat qeverisëse dhe vendimmarrëse.

Ngritja e një komisioni të tillë do t'i shërbejë interesave për hartimin e studimeve dhe platformave të sigurisë kombëtare, strategjisë dhe gjeostrategjisë, misionit për të

garantuar qetësinë dhe rendin kushtetues, luftën dhe përpjekjet për parandalimin dhe zbulimin e kriminalitetit, etj.

Në këtë kuadër Akademia e Shkencave në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë po punon për:

- hartimin e platformës së këtij komisioni;
- përzgjedhjen e një stafi profesionistësh të dalluar në fushat e kërkimit shkencor për çështjet e sigurisë;
- vlerësimin e objektivave prioritare, për të parandaluar kërcënimet dhe rreziqet që cenojnë sigurinë kombëtare;
- bashkëpunimin me specialistë të fushës së mbrojtjes, sikundër profesionistë të spikatur të Akademisë së Forcave të Armatosura;
- organizimin e takimeve permanente me përfaqësues të Ministrisë së Rendit dhe të asaj së Mbrojtjes;
- tërheqjen e mendimit të profesionistëve, studiuesve të dalluar në fusha të tjera që lidhen me sigurinë, sikundër siguria kibernetike, siguria ushqimore, strukturat që ndjekin krimin e organizuar, trafiqet e lëndëve narkotike dhe të qenieve njerëzore, etj.

Synimi i ngritjes dhe funksionimit të këtij komisioni do të jetë, puna permanente për:

- përcaktimin e fushave dhe objektivave të rëndësishme të sigurisë kombëtare;
- ndjekjen dhe vlerësimin e zhvillimeve politike në rajon dhe më gjerë në interes të sigurisë kombëtare;
- hartimin e raporteve dinamike për strategjinë e sigurisë kombëtare;
- hartimin e raporteve periodike për politikëbërësit etj.

Duke mos dashur të zgjatem do të doja të nënvizoja se bashkëpunimi mes institucioneve tona do të rritet në një shkallë më të madhe për t'i shërbyer kështu qëllimit që institucione kaq të rëndësishme që garantojnë, sigurisë dhe rendin kushtetues të marrin edhe më tej një profil dhe përmbajtje sa më shkencore, sa më ligjore dhe atdhetare.

Domosdoshmëria e botimeve shkencore në fushën e sigurisë publike



Dr. Albert HITOALIAJ

Shefi i sektorit të botimeve, QKSH, Akademia e Sigurisë

1. Hyrje

Një prej treguesve më të saktë të kërimit shkencor janë botimet shkencore. Në të gjitha ato institucione ku zhvillohet veprimtari e kërimit shkencor ka botime shkencore. Botimet janë pjesë e pandashme e kërimit pasi ato formalizojnë dhe finalizojnë procesin e kërimit. I gjithë sistemi i transmetimit të dijes dhe i risive apo debatit shkencor pasqyrohet nëpër botime të ndryshme. Në këtë material të shkurtër jepet një përshkrim i botimeve në Akademinë e Sigurisë dhe një argumentim se përse këto botime shkencore duhet jo vetëm që të vijojnë, por edhe të shtohen e të krijojnë një traditë të mirëfilltë të botimeve shkencore në fushën e sigurisë publike. Misioni i Qendrës së Kërkimeve Shkencore dhe karakteri i botimeve shkencore, si pjesë e aktivitetit të AS-së jepet që në “Hyrjen” e statutit: Akademia e Sigurisë, është një institucion publik që synon arsimimin e punonjësve të Policisë së Shtetit e të institucioneve të tjera ligjzbatuese. Kjo akademi do të merret me studime, kërkime shkencore dhe botime në fushat e policimit dhe të sigurisë.

Ashtu si përcaktohet në “Statutin e Akademisë së Sigurisë”, dy nga detyrat kryesore të QKSH-së janë: kryerja e kërkimeve shkencore dhe studimeve në fushën e policimit dhe të sigurisë, në përputhje me prioritetet strategjike të zhvillimit të Policisë së Shtetit; dhe, realizimi i botimeve në fushën e policimit e të sigurisë.

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

1. Kërkimi shkencor dhe bashkëpunimi me institucione të tjera arsimore e kërkimore, reflektohen detyrimisht te botimet

Revista shkencore “Policimi dhe siguria”, botohet nga Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë, që nga viti 2015. Kjo revistë publikon studime, kërkime shkencore dhe botime në fushat e policimit dhe të sigurisë. Krahas saj botohen edhe punimet përmbledhëse të konferencave shkencore, në trajtë librash të pajisur me kodet përkatëse. Qysh në momentet e para të fillimit të punës, sektori i botimeve të QKSH-së, u kujdes që botimet të cilat do të realizoheshin nga Akademia e Sigurisë, të ishin në përputhje me standardet më serioze dhe ato të kërkuara. Pajisja e botimeve me numra serialë, ishte jo vetëm risi për AS-në, por edhe një standard i plotësuar. Përmes sektorit të botimeve, tashmë AS-ja ka atributet e një shtëpie botuese. Botimet e akademisë janë të pajisura me dy lloje numrash serialë: ISSN dhe ISBN.

Në të njëzetë numrat e revistës “Policimi dhe siguria” janë publikuar e shpërndarë edhe rezultatet e veprimtarisë kërkimore shkencore të Qendrës së Kërkimeve Shkencore, në fushën e policimit dhe sigurisë, në përputhje me nevojat e zhvillimit të Policisë së Shtetit dhe jo vetëm. Kjo veprimtari kërkimore shkencore e QKSH-së gjatë këtyre pesë viteve, e publikuar dhe shpërndarë nëpërmjet revistës “Policimi dhe siguria”, është mbështetur në tre shtylla kryesore dhe konkretisht te:

- kërkimi shkencor përmes projekteve;
- kërkimi shkencor përmes aktiviteteve;
- realizimi i botimeve shkencore për finalizimin e punës e kërkimore-shkencore si

dhe shpërndarja e njohurive shkencore.

(a) *Kërkimi shkencor përmes projekteve*, përfshin projekte kërkimore të realizuara për qëllime apo kërkesa të Akademisë së Sigurisë, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme. QKSH-ja ka krijuar një eksperiencë të mirë dhe me kërkuesit e saj ka realizuar gjatë kësaj periudhe dhjetë projekte kërkimore shkencore. Këto projekte janë realizuar sipas kërkesave të Akademisë së Sigurisë, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, e në funksion të politikëbërjes të organizatës sonë policore.

(b) *Kërkimi shkencor përmes aktiviteteve*, përfshin organizimin, koordinimin e bashkëpunimin me institucione të tjera, për organizimin e konferencave shkencore me qëllim të mbledhjes dhe përpunimit të mendimit më të kualifikuar shkencor në nivel kombëtar e më gjerë, në funksion të luftës kundër krimit dhe kërcënimeve më të reja të sigurisë. Këto konferenca shkencore janë të natyrës kombëtare dhe ndërkombëtare. Gjatë këtyre pesë viteve, QKSH-ja, në bashkëpunim me universitetet e institucione të tjera kërkimore-shkencore, brenda e jashtë vendit, ka realizuar pesë konferenca shkencore ndërkombëtare, me tematikë të fushës së rendit e të sigurisë, si dhe dy konferenca shkencore.

(c) *Realizimi i botimeve shkencore*. Këto botime janë të karakterit shkencor e të regjistruara sipas standardeve kombëtare e ndërkombëtare. Nëpërmjet publikimit të arritjeve shkencore në këto botime, finalizohet jo vetëm puna e kërkimit shkencor, por mundësohet edhe shpërndarja e njohurive shkencore për gjithë punonjësit e organizatës policore, e jo vetëm. Gjithashtu, publikimi i thirrjeve për botim të artikujve në revistën shkencore na mundëson në vazhdimësi thithjen e mendimit të kualifikuar të punonjësve të policisë dhe të strukturave të tjera të sigurisë, në funksion të një policimi nxitës (proaktiv).

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

Gjatë kësaj periudhë janë përgatitur dhe botuar 20 numra të revistës “Policimi dhe siguria”, revistë periodike shkencore e Akademisë së Sigurisë. Këto botime kanë pasur ndikim dhe kanë ngjallur interes jo vetëm në qarqet akademike dhe intelektuale, në vend e rajon, por edhe në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit. Në këto botime, gjithnjë e më tepër, po publikojnë shkrimet e tyre studiues e kërkues shkencorë nga sektorë të ndryshëm të Policisë së Shtetit dhe jo vetëm. Përveç botimeve *hard copy* të revistës “Policimi dhe siguria”, ka vazhduar publikimi i tyre edhe *online*. Për këtë janë njoftuar të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit për të pasur qasje te to.

Gjithashtu, është përgatitur, miratuar dhe botuar fjalori shqip-anglisht, me terminologji policore, në shërbim të punonjësve të policisë që janë në vijën e parë të kontaktit me të huajt që vijnë në vendin tonë, si dhe një album i Akademisë së Sigurisë.

Për realizimin e veprimtarisë të mësipërme në fushën e kërkimit Qendra e Kërkimeve Shkencore ka bashkëpunuar me:

- institucione të arsimit të lartë brenda vendit si, Universiteti i Tiranës, universiteti “Aleksandër Moisiu” i Durrësit, universiteti “Luarasi”, universiteti “Zonja e Këshillit”, Akademinë e Forcave të Armatosura etj.;
- institute të ndryshme studimore brenda vendit si, Instituti i Policisë Shkencore, Instituti i Studimeve të Transportit, Instituti i Mjekësisë Ligjore, Instituti Shëndetit Publik etj.;
- institucione të ndryshme brenda vendit si, Policia e Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, Shkolla e Magjistraturës etj.;
- projekte dhe misione policore që asistojnë Policinë e Shtetit dhe Akademinë e Sigurisë si, PAMECA, ICITAP etj.;
- institucione të larta arsimore jashtë vendit si, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Akademia e Sigurisë Shkup, Maqedoni, universiteti i Romës “Tor Vergata”, universiteti i Barit “Aldo Moro” etj.;
- institucione ndërkombëtare sigurie dhe jo vetëm, si, Organizata e Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Evropë, Organizata Botërore e Shëndetësisë, NATO (Divizioni i Sigurisë Kibernetike).

2. Shembuj nga puna kërkimore e Akademisë së Sigurisë dhe publikimi i saj

Revista shkencore “Policimi dhe siguria”, botohet nga Qendra e Kërkimeve Shkencore e Akademisë së Sigurisë, bazuar në urdhrin nr. 639, datë 23.7.2015, të drejtorit të përgjithshëm të Akademisë së Sigurisë, drejtues i lartë dr. Bilbil Memaj, “Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”. Revista shkencore “Policimi dhe siguria” me ISSN 2413-1334, është botim periodik i Akademisë së Sigurisë e cila shërben për publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të veprimtarisë kërkimore shkencore të Akademisë së Sigurisë në fushën e policimit dhe sigurisë, me qëllim përmbushjen e standardeve më të larta në veprimtarinë kërkimore-shkencore në Akademinë e Sigurisë dhe më gjerë.

Kjo revistë publikon studime, kërkime shkencore dhe botime në fushat e policimit dhe të sigurisë, të personelit të AS-së e më gjerë. Të gjitha të drejtat e botimit dhe ribotimit janë të Akademisë së Sigurisë. Asnjë material i saj nuk mund të riprodhohet, kopjohet, ribotohet, modifikohet, shpërndahet apo shitet në asnjë mënyrë, i plotë apo pjesë të tij, në formë elektronike apo në letër, pa autorizimin e shkruar të Akademisë së Sigurisë. Përdorimi i materialeve të kësaj reviste, pa autorizim, përbën shkelje të së

drejtave të autorit. Akademia e Sigurisë zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin “Për Policinë e Shtetit” dhe ligjin “Për arsimin e lartë” si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike. Pikëpamjet e shprehura në revistën “Policimi dhe siguria”, janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Akademisë së Sigurisë. Autorët e publikimeve në revistën “Policimi dhe siguria” gëzojnë liri të plotë akademike, por me kushtin e vetëm që kur shkruajnë, të zbatojnë legjislacionin përkatës, si të komunikimit edhe atë profesional, i cili nuk cenon të drejtat e ndryshme. Autorët janë të vetëdijshëm dhe mbajnë përgjegjësi individuale lidhur me problemet e plagjiaturës. Çdo shkelje në këtë drejtim i ngarkon ata me përgjegjësi sipas ligjeve në fuqi.

Revistën e drejton kryetari i bordit editorial të saj, i cili është i emëruar si i tillë nga urdhri i drejtorit të Përgjithshëm të Akademisë së Sigurisë, nr. 639, datë 23.7.2015, “Për botimin e revistës shkencore të Akademisë së Sigurisë”. Bordi i revistës shkencore “Policimi dhe siguria” dhe Qendra e Kërkimeve Shkencore, me punën e tyre, synojnë që publikimet në këtë revistë, të përmbushin standardet më të larta të kërkimit shkencor e të integritetit, dhe të jenë në përputhje me standardet etike e normat ndërkombëtare mbi pronësinë intelektuale.

Artikujt e botuar nga stafi i AS-së në revistë, përfshijnë kryesisht këto tematika: rendi dhe siguria publike, siguria kombëtare, parandalimi i kultivimit të lëndëve narkotike, kriminologjia, kriminalistika, mjekësia ligjore, siguria kibernetike, policimi në komunitet, menaxhimi policor, arsimimi dhe trajnimi policor, parandalimi i radikalizmit dhe lufta kundër terrorizmit, parandalimi dhe lufta kundër krimit të organizuar, etj. Revista ka publikuar studime origjinale, punime konceptore, analiza e skenarë të trajtuar sipas natyrës studimore, kërkime empirike, studime teknike në lidhje me fusha të ndryshme që ndërthuren me policimin, analiza librash e të tjera, që pasqyrojnë punën kërkimore ndër vite të një pjese të personelit pedagogjik e kërkimor të AS-së. Këto shembuj gjenden në faqet e revistës dhe në botimet e konferencave shkencore (*proceedings*).

3. Botimet shkencore, tregues i rëndësishëm i plotësimit të standardeve që kërkohen për Institucionet e Arsimit të Lartë

Akademia e Sigurisë vepron e orientuar prej dokumenteve të saja kryesore strategjike. Njëri prej tyre, ose kryesori, është “Strategjia zhvillimore e AS-së”. Mbështetur në këtë strategji, ngrihet dhe strategjia me të cilën vepron QKSH-ja, e cila përcakton prioritetet kryesore: “Strategjia e AS-së për veprimtari kërkimore dhe zhvillimore”. Prioritetet e veprimtarisë së saj kërkimore-shkencore, janë në përputhje me fushën e sigurisë publike dhe botimet që realizon QKSH-ja janë treguesit e aktivitetit të saj.

Këto botime reflektojnë aktivitetet e AS-së, e cila veprimtarinë e saj kërkimore e përshtat me prioritetet strategjike të kërkimit shkencor kombëtar. Veprimtaria përputhet me prioritetet afatgjata rajonale, kombëtare e ndërkombëtare, dokumentet kryesore strategjike të Policisë së Shtetit, prioritetet kombëtare të strategjive të ndryshme dhe në vetë dokumentet strategjikë të vetë AS-së.

Nëse bëjmë një analizë, jo shumë të gjatë, mbi ecurinë e botimit të revistës “Policimi dhe siguria”, si periodik shkencor, por edhe të librave të konferencave, do të duhet të përmendim në mënyrë të përmblodhur rëndësinë dhe problematikën e punës që kanë botime e AS-së:

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

- revista "Policimi dhe siguria" (përfshirë te ajo edhe botimet e konferencave) është e vetmja revistë shkencore institucionale që trajton çështjet e sigurisë në rrafshin publik dhe të sigurisë kombëtare në vendin tonë;

- nuk ka asnjë revistë tjetër shkencore në Shqipëri, që të analizojë në mënyrë shkencore punën dhe problematikën saj në Policinë e Shtetit;

- nuk ka asnjë institucion sigurie në Shqipëri, që të ketë një revistë shkencore të tillë, të ngjashme ose edhe thjesht shkencore;

- Akademia e Sigurisë, përmes botimeve të saja i ka siguruar Policisë së Shtetit fillimin e një procesi botues afatgjatë, që mund të shndërrohet në traditë të botimeve shkencore në polici;

- standardizimi i botimeve të AS-së me ISBN dhe ISSN, përbën ngritjen e në një stad të ri të përfaqësimit të kërkimit dhe të mendimit brenda radhëve të autorëve të policisë e më gjerë: të fushës së sigurisë;

- të qenit thuajse unik në këtë drejtim, nuk përlligj me doemos cilësinë e shkrimeve, por përlligj vazhdimësinë e krijimit të një hapësire ku të zhvillohet mendimi kritik shkencor në fushën e sigurisë;

- interesi i vazhdueshëm për të shkruar në faqet e kësaj reviste është tregues se botime të tilla nuk janë të tepërta;

- reformimi i institucionit të Akademisë së Sigurisë, si institucion i arsimit të lartë, sjell nevojën e pandashme, të padiskutueshme dhe të këshillueshme, të zhvillimit të kërkimit shkencor në një rrafsh më të lartë;

- nuk mund të konceptohet kërkimi shkencor pa pasur botime shkencore;

- revista shkencore "Policimi dhe siguria" e krahasuar me revista të ngjashme, të mëparshme apo edhe aktuale, qëndron në pozita serioze dhe reflekton një angazhim dhe një punë e cila motivon kërkimin shkencor;

- shpërndarja e botimit fizik të kësaj reviste shkencore në një sërë institucioneve kombëtare dhe rajonale, ka prodhuar një përshtypje tejet pozitive për punën e AS-së dhe të Policisë së Shtetit në tërësi;

- nisur nga shkëmbimi i mendimeve me kolegë të stafeve pedagogjike të institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë, në konferenca e aktivitete të ndryshme të realizuara nga AS-ja, mund të thuhet me siguri, se vlerësimi për revistën ka qenë me tonet më pozitive dhe përgëzimet nuk kanë munguar;

- vështirësitë e botimit të kësaj reviste nuk kanë munguar dhe duke ruajtur me korrektësi datat e thirrjeve e të botimit, është punuar shpeshherë në skajet më të shtyra kohore, e kjo gjë ka sjellë tek-tuk probleme të caktuara teknike;

- revista "Policimi dhe siguria" e ka përmbushur misionin e saj me sukses dhe ka lënë pas një prodhim të dallueshëm i cili është krijuar falë punës së palodhur të sektorit të botimeve, të drejtorit të QKSH-së dhe falë vizionit e mbështetjes së rektorit të AS-së;

- gjatë periudhës pesëvjeçare 2015-2020, revista "Policimi dhe siguria" e Qendrës Kërkimore Shkencore të Akademisë së Sigurisë, ka lënë një gjurmë historike serioze që ka lidhje me botimet dhe kërkimin shkencor, brenda Policisë së Shtetit e më gjerë.

Mund të përmendim lidhur me botimet shkencore në fushë e sigurisë dhe kryesisht ato të AS-së, edhe një element i cili ka rëndësi të veçantë: detyrimet që duhen plotësuar për të qenë një institucion i akredituar i arsimit të lartë. Aktiviteti i botimeve shkencore është një prej treguesve më të domosdoshëm që lidhen me kërkimin shkencor të një instituti. Për këtë arsye, shumë nga pikat e fushës që lidhen me kërkimin shkencor, kur zhvillohet procesi i vlerësimit të brendshëm e të jashtëm të një institucioni arsimor,

lidhen me botimet shkencore dhe me standardet e tyre. Në mbyllje të këtij materiali të shkurtër, mund të themi me siguri se botimet dhe kërkimi shkencor janë të pandashëm nga njëri-tjetri, dhe botimet shkencore në fushën e sigurisë publike, përbëjnë një aset me vlerë për aspektin vlerësues të Akademisë së Sigurisë si një institucion i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë. Për këto arsye, duhet të mbështeten botimet shkencore dhe të zbatohet një strategji e mirëfilltë për zgjerimin e tyre prej kërkuesve, stafit pedagogjik të AS-së, ose edhe prej pjesëtarëve të ndryshëm nga Policia e Shtetit dhe agjenci të tjera që lidhen me prioritetet strategjike të AS-së.

Kërkimi shkencor dhe institucionalizimi i tij në Akademinë e Sigurisë

(Nga tradita e kërkimit shkencor shqiptar në kërkimin
shkencor në Akademinë e Sigurisë)



Prof. asc. dr. Zaho GOLEMI

Shef i sektorit të kërkimit shkencor, QKSH, Akademia e Sigurisë

Hyrje

Kërkimi shkencor në planin konceptor, ligjor dhe administrativ në vendin tonë po ecën në një trend të ri. Me të njëjtin hap po ecën edhe në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Përballimi i sfidave të kohës, duke e vlerësuar arsimin e lartë si përgjegjësi publike të dorës së parë, duke i konsideruar institucionet arsimore të sigurisë dhe të mbrojtjes, si institucione unike të edukimit akademik, vlerësohen më shumë kur mbështeten në dy gjymtyrë të së njëjtës rëndësi: “Mësimdhënie dhe kërkim shkencor”. Kjo do të ishte edhe përgjigjja efikase edhe ndaj kërkesave më të larta juridike, administrative dhe akademike.

Kërkimi shkencor është shndërruar në kriter i vlerësimit institucional, renditjes (rankimit) e financimit, një zhvillim i pritshëm për gjithë IAL-të. Institucionet e arsimit të lartë për siguri dhe mbrojtje janë tashmë të institucionalizuar edhe në fushën e kërkimit shkencor pasi kanë bërë hapat të rëndësishëm të vendosjes në struktura organike të qëndrueshme me emërtime të ndryshme, por me misione të përbashkëta, veprimtari që sinergjojnë, fokusohen dhe orientohen drejtë për të sotmen dhe në përballimin e sfidave të së ardhmes.

IAL të sigurisë e mbrojtjes duke qenë të vetme në Shqipëri kanë nevojë për bashkëpunime rajonale dhe frymëmarrje evropiane, për të funksionuar në mënyrë të standardizuar kryerja e kërkimeve, studimeve shkencore e botimeve cilësore në fushën sigurisë publike si dhe të menaxhojë veprimtarinë kërkimore e shkencore në përputhje

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

me nevojat, vizionin, objektivat dhe prioritetet strategjike.

Fushat e kërkim-zhvillimit për siguri publike dhe mbrojtje kanë tashmë njësitë e tyre, të cilat janë themeluar prej pak vitesh, janë organizuar e riorganizuar për nga natyra dhe fusha e kompetencës si unike në vend, ndërkohë që kryerja dhe stimulimi i veprimtarisë kërkimore shkencore e hulumtuese përbën një nga sfidat kryesore të ardhmërisë. Institucionet e arsimit të lartë për siguri dhe mbrojtje në vitet e fundit kanë rritur vetëdijen se kërkimi shkencor dhe zhvillimi janë pjesë e pandashme e sistemit të arsimit të lartë, por edhe me rëndësi jetike për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, shoqëror si dhe për sigurinë tërësore të vendit.

Kërkimi shkencor një mision gjithmonë e më i domosdoshëm

Kërkimi shkencor në Akademinë e Sigurisë ka qenë mbi bazën e legjislacionit që prej krijimit si IAL, gjysmë shekulli më parë, por në mënyrë të institucionalizuar vetëm ngritur vetëm në vitin 2015, kur brenda strukturës organike të AS-së u fut Qendra Kërkimore Shkencore me dy sektorë me shtatë vetë si personel akademik kërkimor shkencor. QKSH-ja u institucionalizua që prej shtatë vjetësh dhe produkti i saj ka qenë domethënës. Bazuar në ligjin e arsimit të lartë, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në vitin 2015, një ndër misionet e arsimit të lartë është integrimi i mësimdhënies me kërkimin shkencor. Përveç rolit si krijues dhe rregullator i institucioneve të arsimit të lartë, shteti ka gjithashtu detyrimin ligjor për të financuar kërkimin shkencor. Strukturat shtetërore të sigurisë së brendshme Ministria e Brendshme e Policia e Shtetit e financojnë kërkimin shkencor nga buxheti i shtetit, ose nëpërmjet projekteve që mbështeten nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Dikur para tre dekadash kërkimi shkencor, sikurse gjithë fushat e jetës shqiptare kanë qenë të planifikuara dhe kontrolluar, ku gjithçka ishte e planifikuara nga fondet, nga kërkesat për kërkimin shkencor, por pas shndërrimit të sistemeve kërkimi shkencor fitoi një farë pavarësie, por që kërkon mbështetje financiare. Por kërkimi shkencor nuk është as luks, dhe as privilegj. Në tre dekadat e fundit, duke pasur parasysh dhe nevojat e mësimdhënies me vështirësi financimi, ku gjenerimi i fondeve për kërkimin shkencor ka qenë i limituar, edhe kur nevoja e kërkimit shkencor ka qenë në rritje. Fakt është se buxheti dhe infrastruktura është sfida e së ardhmes, - si për çdo institucion të arsimit të lartë, - edhe për edukimin policor në Shqipëri për fushën e kërkimit shkencor.

Akademia e Sigurisë që prej vitit të riorganizuar të saj më 2015, përmes QKSH-së kapërceu skepticizmin për punën, organizimin dhe funksionalitetin e kërkimit shkencor duke synuar që në veprimtarinë kërkimore të kapërcejë abstrakten dhe të adresojnë problemet themelore që ka fusha e rendit dhe e sigurisë publike dhe shoqëria. Nga ana tjetër në AS kërkimi shkencor nuk ka synuar të matet me publikime të artikujve shkencorë, por t'ju referohet realitetit të zhvillimeve në Policinë e Shtetit për probleme të mprehta, që kërkojnë angazhim e zgjidhjen e tyre edhe përmes rekomandimeve. Financimi i kërkimit shkencor është në shërbim të tatimpaguesve, prandaj edhe institucioni i Akademisë së Sigurisë kontributin e jep në interes të zgjidhjeve institucionale për rritjen e sigurisë publike në Shqipëri.

Akademia e Sigurisë si një nga katërmëdhjetë IAL-të në Shqipëri¹ ka synuar

¹ Akademia e Sigurisë është një ndër 14 IAL publik në Shqipëri, krahas UT, UPoliteknik, UB, UM, UA, US, AFA, Universitetet publike në Durrës, Shkodër, Elbasan, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë. Në rang vendi 12.1% në IAL janë me titull akademik "Prof", 27.3% janë me titull "Prof. Asoc", 7.5% janë Docentë, 59.5% janë doktorë të shkencave (ku përfshihen edhe ata që janë rritur më tej në titull akademikë).

institucionalizimin dhe forcimin e kërkimit shkencor duke e parë nga këndvështrimi organik organizativ, mënyra e financimit si dhe mekanizma që nxisin produktivitetin përfshi kolonat bazë: “Projekte, aktivitete, tetë konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, të 11 projekteve të financuara nga Akademia e Sigurisë dhe një nga AKKSHI”. Institucionalizimi i kërkimit shkencor në vetëm shtatë vite është vënë në provë dhe mbi këtë bazë vizioni i AS-së për të ardhmen është kalimi nga QKSH në institut të kërkimit shkencor në të ardhmen, që gjykohet se përmirësimi i cilësisë së kërkimit shkencor do ta tejkalojë ekspertizën e deritanishme shtatëvjeçare. Ky konkludim lidhet me fuqinë, mundësinë dhe kapacitetet e QKSH-së për rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor në Akademinë e Sigurisë.

AS-ja si Institucion i Arsimit të Lartë përmes strukturave të vartësisë në shtatë vitet e fundit ka synuar vendosjen e standardeve duke rritur cilësinë e edukimit akademik policor duke vetëvlerësuar programet akademike dhe duke i përmirësuar ato në vijimësi, duke e përdorur strukturën e QKSH-së jo vetëm si element të rëndësishëm të kërkimit shkencor, por edhe si strukturë lidhëse të kërkimit dhe të pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në mësimdhënie në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit.

Aktualisht bazuar në statistikat zyrtare shtetërore stafi akademik i kërkimit shkencor në Akademinë e Sigurisë zë një përqindje kombëtare prej 0.9%.² Kapacitetet njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore janë përllëgaritur sipas manualit të Fraskatit.³

Bazuar në këto statistika edhe Akademia e Sigurisë zë vendin e saj brenda sistemit të arsimit të lartë shqiptar dhe i vetëm në fushën e policimit dhe sigurisë publike. Nga analiza e buxhetit të projekteve kërkimore shkencore në Shqipëri rezulton se vlerësimi për kërkimin gjithmonë e më shumë vlerësohet si baza e arsimit të lartë dhe edukimit, motor për ndryshim, inovacion, rritjen e konkurrencës dhe cilësisë në mësimdhënie. Në AS edukimi policor dhe kërkimi shkencor ka një lidhshmëri që vijon të jetë në trendin evropian, që gjykohet se paralelisht do shoqërohet edhe me buxhet, duke kapërcyer statistikat zyrtare shqiptare.⁴ Akademia e Sigurisë në ardhmërinë e saj pretendon të jetë më prezente në publikimet shkencore në spektrin kombëtar e ndërkombëtar, ndërkohë që vetëm në shtatë vite në mënyrë të institucionalizuar ka prodhuar mijëra faqe me disa dhjetëra-qindra autorë në dhjetëra numra revistash mbi Sigurinë dhe Policimin. Vijimësia në institucionalizim të kërkimit shkencor për Akademinë e Sigurisë është vijimësi në strukturim, organizim, meritokraci dhe vlefshmëri në kërkim shkencor, komunikim e shpërndarje të rezultateve të kërkimit shkencor. Institucionalizimi i kërkim zhvillimit edhe për fushën e sigurisë publike parakupton aplikimin e bibliometrisë si një metodë kërkimore e përdorur në shkencën e bibliotekave dhe të informacionit, e cila përdor analiza dhe statistika sasiore. Kërkimi me format e reja edhe për AS-në është ecuri në dy fusha të rëndësishme sikurse është në bibliometri dhe në menaxhimin e të dhënave të kërkimit dhe publikimeve. Kërkimi shkencor ja ka dalë të kthehet në vlerë e shtuar për edukimin policor në Shqipëri, që kanë prioritet

² Stafi Akademik i kapaciteteve njerëzore në fushën akademike e kërkimore-shkencore sipas IAL zënë në grafikun kombëtar 0.9%. (sipas: <https://kërkimi-shkencor.rash.al/Statistika/Detajet/22>).

³ Bazuar në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, <https://www.geo.edu.al/skedaret/ligji-ri-arsimit.pdf>; <http://isiknoëledge.com>. Manuali Frascati është dokumenti që parashtron metodologjinë për mbledhjen e statistikave rreth kërkimit dhe zhvillimit; që është përgatitur dhe publikuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik, ku në vitin 2002 ka bërë edhe fushat e klasifikimit të shkencës.

⁴ Nga 11 universitete publike në Shqipëri faktet flasin se, nga viti 2015 deri në vitin 2019, buxheti i shtetit dhe AKKSHI financuan në total 110 milionë lekë për kërkimin shkencor në vend, nga të cilat të paktën 41.9 milionë

sigurinë kombëtare, hartimin e raporteve, prognozave dhe përfundimeve e rekomandimeve për strukturat e lidershipit policor në Shqipëri. QKSH-ja në Akademinë e Sigurisë ka marrë profilin e vërtetë të kërkimit shkencor me përgjegjshmëri të plotë publike dhe trendi i kërkimit shkencor në fushën e policimit që është misionare në objektivat finale për të ulur krimin dhe kriminalitetin në vend, për gjetjen e rekomandimeve përkatëse për këtë fushë.

Rrugëtimi i kërkimit shkencor në Shqipëri

Akademia e Sigurisë përgjatë rrugëtimit të saj mbi gjysëmshkullor si institucion i arsimit të lartë dhe i vetëm i sigurisë publike dhe policimit në Shqipëri, kërkimin shkencor për më shumë se dyzetë vite e kanë parë si pjesë të arsimit dhe të shkrirë bashkë me mësimdhënien. Nëse i bëjmë një rezymë kërkimit shkencor në Shqipëri rezultojnë se tendencat e para të ngritjes institucionale të krijimit strukturor të kërkimit shkencor janë në vitet '30-'40-të të shek. XX.

Një ndër stacionet e arsimit në kuadrin e zhvillimit të edukimit policor shqiptar është periudha kur arsimimi policor ngrihej në nivel kursiv njëvjeçar, më 21.5.1938,⁵ një periudhë kur ende nuk kishte shkollë të larta në Shqipëri dhe as që bëhej fjalë për kërkim shkencor të institucionalizuar. Fakt është se kërkimet shkencore në Shqipëri nisin më vonë për shkak të vonës në krijimin e shtetit të pavarur shqiptar që u realizua 110 vite më parë, më 1912. Edhe pas krijimit të shtetit shqiptar u desh kohë që të formoheshin disiplinat shkencore të fushave shoqërore e natyrore të cilat fillojnë veprimtarinë nën pushtim më 1940-tën. Kështu krijohet "Instituti Mbretënor i Studimeve Shqiptare", shkurt "Instituti i Studimeve Shqiptare" (1940-1944) ka qenë një institut shkencor e kulturor i vendosur përgjatë Mbretërisë së përbashkuar italo-shqiptare. Ky është instituti që i parapriu krijimit të instituteve të shkencave të pas LIIB. Veprimtaria e Institutit të Studimeve Shqiptare ishte një ambicie e intelektualëve shqiptarë. Më 8.4.1940 Sekretari i Përgjithshëm i Kryesisë së Këshillit të Ministrave miratoi krijimin e fondacionit "Skanderbeg" si dhe statutin e Institutit të Studimeve Shqiptare. Sipas këtij statuti, Instituti i Studimeve Shqiptare kishte për qëllim t'i jepte hov e të bashkërendonte lëvizjen intelektuale shqiptare në fushën e shkencës, të letrave e arteve. Të përkujdesej për pasurimin e kulturës kombëtare, duke marrë si shembull kombet e përparuara të Evropës, por duke ruajtur njëkohësisht dhe karakterin kombëtar sipas mendësive dhe traditave më të mira kombëtare⁶.

Organizimi i ISSH-së përfshinte katër komisione kryesore dhe secili prej tyre kishte disa nënkomisione sipas shkencave përkatëse: "Shkenca morale e historike", "Shkenca fizike, matematike dhe natyrore", "Gjuhë dhe letërsi", "Arte". Instituti kishte 48 anëtarë të përjetshëm që formonin edhe Këshillin e Përgjithshëm të ISSH-së. Kryetar i Institutit ishte Ernest Koliqi, ndërsa sekretar i përgjithshëm At Zef Valentinin.⁷ Anëtarët e Institutit të Studimeve Shqiptare ishin emra të njohur të intelektualizmit shqiptar, tërësisht të arsimuar në fusha të ndryshme si dhe mjaft produktiv në fushën e vet, figura të shquara të inteligjencies shqiptare të kohës.⁸ Kur ende po vijonte lufta në Shqipëri, në korrik

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

⁵ Kursi një vjeçar i policisë⁵; Fletore Zyrtare nr.44/v.1938; AQSH "Akademi e Policisë "Arben Zylyftari", Tiranë, 2002, f.13.

⁶ AQSH, Fondi dokumentar nr. 200, Viti 1940, Dosja 10.

⁷ DP e AQSH, Fondi dokumentar nr. 200, Viti 1941, Dosja nr 4.

⁸ Disa nga figurat e inteligjencës erudite shqiptare të viteve '40-të ishin: Eqrem Çabej, Aleksandër Xhuvani, At Anton Harapi, Karl Gurakuqi, Lasgush Poradeci, Namik Resuli, At Zef Valentinin, Dom Lazër Shantoja, Filip Fishta, At Justin Rrota, Ilo Qafëzezi, Anton Paluca, Xhevat Korça, Kolë Kamsi, Ekrem Vlora, Ernest Koliqi, Sotir Kolea, Vangjel Koça, Dhimitër Berati, etj. Sipas AQSH, Fondi dokumentar 200, Viti 1940, Dosja 1.

1944 Instituti i Studimeve u riorganizua dhe pranoi në gjirin e vet shumë intelektualë të kohës⁹, por me përfundimin e luftës në Shqipëri përfundon edhe veprimtaria e ISSH-së. Ndërprerja e veprimtarisë dhe goditja e intelektualizmit pas LIIB në Shqipëri lidhej me fillimin e një regjimi të ri të diktaturës së proletariats, që edhe ajo pakicë intelektuale e kohës e çau rrugën e kërkimit shkencor përmes peripecish dhe përndjekjesh që e dëmtuan rëndë kërkimin shkencor.

Por periudha e arsimit shqiptar më 1945 ka qenë tejet e rëndë dhe nuk bëhej fjalë për kërkimin shkencor të përparuar.¹⁰ Dy vjet pas çlirimit të Shqipërisë, në vitin 1946 me vendim të Qeverisë Shqiptare krijohet “Instituti i Shkencave” me një strukturë të përafërt me atë të Institutit të Studimeve Shqiptare në gjirin e të cilit punonin një pjesë e mirë e ish-anëtarëve të Institutit të mëparshëm. Gjatë viteve 1946-1956 funksiononin në Tiranë gjashtë institute të larta: Instituti Pedagogjik, Instituti Politeknik, Instituti Mjekësor, Instituti Bujqësor, Instituti Ekonomik dhe Instituti Juridik. Në vitin 1949 miratohet ligji për arsimin, ndërkohë që elita intelektuale kishte hedhur vështrimin tek arsimit i lartë dhe kërkimi shkencor.¹¹ Ndërsa me VKM nr. 207 datë 30.05.1957, u krijua Universiteti Shtetëror i Tiranës.¹² Një vit më vonë më 1958 u krijua Shkolla e Naltë Ushtarake¹³ që mbulonte arsimimin e lartë në fushën e Mbrojtjes dhe sigurisë së jashtme të vendit. Stafi pedagogjik dhe kërkimor shkencor kishte studiuar në akademitë ushtarake më të njohura sovjetike, që sollën një përvojë për ngritjen e Shkollës së Lartë Ushtarake shqiptare.

Vëmendja ndaj arsimit dhe cilësisë faktikisht po rritej.¹⁴ Këshillit të Ministrave e vlerësonte “..arsim i lartë ushtarak”, dhe që u reflektua me rritje në formën organizative me plane e programe mësimore, me kërkesa në rritje ndaj formave të mësimdhënies, të aplikimit të kriterëve bashkëkohore si dhe të kërkimit shkencor që ishte e shkrirë brenda stafit mësimdhënës, pa strukturë organizative më vete. Veprimtaria kërkimore e shkencore ishte pjesë e misionit të IAL-ve dhe shpejt u bë pjesë e pandarë e veprimtarisë së ASHP-së, fitoi të drejtën e “qytetarisë” në fillim të vitit 1975, kohë kur u krijua dega shkencore, që mbulonte, strategjinë, historinë, sigurinë e brendshme dhe të jashtme. U ngrit sektori i studimeve shkencore, që përbënte një strukturë më vete në përbërje të ASHP, ku ndërmori studime të mirëfillta në fusha të ndryshme sipas nevojave akademike të kohës, punime dinjitoze, ku një pjesë e këtyre punimeve u publikuan në shkallë kombëtare. Stafi i kërkimit shkencor ishte i përzgjedhur nga shkalla më e lartë e

⁹ Disa ndër intelektualët që u pranuan në ISSH ishin: Fan Stilian Noli, Ali Asllani, Mit'hat Frashëri, Kristo Floqi, Krist Maloki, Dom Ndoci Nikaj, At Pashk Bardhi, Hasan Dosti, Hamdi Sulçebe, Hamit Kokolari, Spiro Konda, Vasfi Samimi, Rexhep Krasniqi, Odise Paskali, Arshi Pipa, Vedat Kokona, Dedë Gostani, Gaspër Shoshi, Gjellosh Luli, Llukë Karafilii, Gjush Sheldia, etj. AQSH, Fondi dokumentar 200, Viti 1940, Dosja 1.

¹⁰ Sipas regjistrimit të 30.9.1945, popullsia shqiptare ishte 1.122.044 banorë, numri i analfabetëve: 911.410 banorë, ose 81.22% e popullsisë. Fondi dokumentar të MPB-së, Dosja nr.2/48, viti 1945, sipas Protokoll nr 961/1 datë 1 tetor 1945.

¹¹ Ligji i arsimit të vitit 1949 detyronte moshat deri në 40 vjeç të merrnin bazat e shkrimit dhe këndimit. Nga një regjistrim i 1949-ës rezultoi se pasnë 5 vjet kishin mësuar shkrim e këndim rreth 130.000 vetë dhe kishin mbetur ende 420.000 analfabetë; më 1955 u shpall publikisht se në Shqipëri ishte likuiduar analfabetizmi deri në moshën 40-vjeç. Të dhënat arkivore flasin se një pjesë e popullsisë nuk arriti të mësonte shkrim e këndim, sidomos moshat e mëdha.

¹² UT në 1957 kishte 15 specialitete me 3613 studentë e rreth 320 pedagogë, ndërsa sot ka 6 fakultete, 2 Institute, 174 Programe mësimore; 800 pedagogë dhe 24.000 studentë. <https://unitir.edu.al/historiku/>, sipas VKM nr. 207 datë 30.05.1957, “Për krijimin e Universitetit Shtetëror të Tiranës”. Përmbledhje Ligjesh e VKM-ve, Tiranë, 1957.

¹³ Vendim i Byrosë Politike të Komitetit të Partisë me atributet e Këshillit të Mbrojtjes së Republikës Nr. 136, më datë 10.05.1958, “SHNU u hap për herë të parë në vendin e quajtur “Rrapi i Treshit” (10.5.1958 deri më 30.6.1966) në Tiranë. Në zbatim të Vendimit 136 dt.10.5.58, ka dalë Urdhëri nr.400 datë 19.12.1958 i Ministrit të Mbrojtjes, “Mbi formimin e SHNU”

¹⁴ Më 1965, arsimit i detyruar kaloi nga 7 në 8 vjet dhe arsimit i mesëm i përgjithshëm u shtri në 12 vjet.

intelektualizmit në fushën e sigurisë.¹⁵ Në Akademi u punuan një varg temash dhe rregullore bazë për sigurinë e brendshme dhe të jashtme, që prej vitit 1969, nisi organizimin edhe të veprimtarive të karakterit shkencor, diskutime e sesione e konferenca shkencore.

Në vitin 1972 në Shqipëri themelohet Akademia e Shkencave¹⁶, që e kishte detyrim edhe përthithjen e kontingjenteve për bashkëpunim nga strukturat e fushës së sigurisë dhe mbrojtjes. Akademia e Shkencave¹⁷ i ka rrënjët në të kaluarën e largët kur shqiptarët punonin në fusha të ndryshme shkencore. Nga viti 1973 Akademisë ju dha e drejta për dhënien e gradave shkencore, ku ndërmjet tyre edhe fusha e policimit dhe sigurisë së brendshme përfshi edhe çështjet e kufirit shtetëror. Në vitin 1975 Akademia Ushtarake cilësohet nga Këshilli i Ministrave institucioni i vetëm për kualifikimin e oficerëve të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes,¹⁸ ndërsa në vitet '90 ju dha e drejta e propozimeve për tituj shkencorë, si “Profesor i asociuar”, “Profesor” dhe “Drejtues i kërkimeve shkencore”, për gjithë spektrin e gjerë të lektorëve të fushës së Mbrojtjes dhe të Sigurisë, përfshi edhe policinë dhe kufirin. Kështu Akademia u bë një qendër studimore-shkencore e përpunimit të mendimit shkencor dhe mbështetëse e fuqishme e trupës pedagogjike mësimdhënëse.¹⁹ Thënia proverbiale e Tomas Fuller se, “E sotmja është nxënëse e së djeshmes”, mbetet me vlerë për gjithë kohët, sepse si do të jenë idetë e vizioni për kërkim zhvillimin sot ashtu do të jetë ai nesër. Kjo është e vërtetuar praktikisht edhe për edukimin policer në tërësi, sepse këmbana e arsimimit sot tingëllon për 30-40 vite rresht. Prandaj institucionalizimi sot merr vlerë të shumëfishtë për ardhmërinë jo vetëm të arsimimit por dhe të kërkimit shkencor dhe shpërndarjes së këtij kërkimi në interes të misionit për të prodhuar më shumë dhe më cilësisht siguri për publikun.

Institucionalizimi i Kërkimi Shkencor në Akademinë e Sigurisë

Në mënyrë të institucionalizuar Kërkimi Shkencor si drejtori më vete është ngritur pas daljes së VKM-së për ngritjen e Akademisë së Sigurisë si dhe urdhrit nr. 294 datë 5.6.2015 i ministrit të Punëve të Brendshme, “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë” si dhe urdhrit nr. 91/45.6.2015 i ministrit të Punëve të Brendshme, “Për miratimin e strukturës dhe limitit të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të ndryshuar”.²⁰ Fakt është që në organigramën e Akademisë së Sigurisë “Qendra Kërkimore Shkencore” është në nivel njësie kryesore në AS, me tre

¹⁵ Sektori krijoi një përvojë të mirë për punën studimore shkencore dhe një brez punonjësish shkencorë të njohur si: Dr. Refik Kucaj, Prof. Dr. Hasan Çipuri, Prof. Dr. Shahin Leka, Prof. Dr. Proletar Hasani, Dr. Vangjel Kasapi, Dr. Arjan Qirjako, Dr. Myzafer Bonaj, Prof. Dr. Pajtim Ribaj, Dr. Virgijil Janku, Dr. Taqo Trajçe, etj.

¹⁶ Akademia e Shkencave u themelua më 1972, gjysëm shekulli më parë me 17 anëtarë dhe 5 akademikë korrespondentë. Aktualisht ka 24 akademikë, 10 ak asoc, dhe 26 anëtarë nderi.

¹⁷ Akademisë së Shkencave i paraprinjë faza e Akademisë së Voskopojës, e Rilindjes, periudha mes dy luftërave, dhe faza pas çlirimit deri te formimi i plotë i Akademisë së mirëfilltë.

¹⁸ Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.200 datë 30.07.1979, “Për dhënien e titujve shkencorë kuadrove ushtarakë”, ku tituli “Profesor” ju dha Spiro Themistokli Adhami – Komandant i AM, Mendu Habil Backa drejtor i xhenios; Titulli “Bashkëpunor i vjetër shkencor” ju dha Abedin Muharrem Galanxhi, Alfred Spiro Moisiu, Gaqo Ilo Pojani dhe Arian Llambi Qirjako”; VKM-ja është nën firmën e Mehmet Shehut dhe Sekretarit të Përgjithshëm Kiço Kasapi. Sipas AQFA, Fondi 100/3, viti 1979, dosja 5, faqe 32 dhe 33.

¹⁹ Nga viti 1984 e deri sot janë mbrojtur mbi 180 doktoratura të fushave të ndryshme, 11 Prof. Asoc., 10 Prof. Dr.; shumica e të cilëve pedagogë e punonjës shkencorë të AFA-së dhe AS-së, midis tyre dhe “Doktorë”, “Profesorë të Asociuar” e “Profesorë”. Që të gjithë mbulonin fushat e poshtëshënuara: të Sigurisë, mbrojtjes, strategjisë, policimit, kufirit, historisë së artit ushtarak shqiptar dhe botëror, gjeopolitikën. Në 63 vite studiuat dhe u diplomuan mbi 8000 oficerë; ndërsa në Akademinë e Sigurisë në gjysëm shekulli ka përgatitur rreth 5400 oficera policie.

²⁰ Të dy urdhërat janë dërguar në Akademinë e Sigurisë me shkresë 2947/3 të datës 08.06.2015, nga Drejtues Mador Haki Çako në funksionin e drejtorit të Policisë së Shtetit.

sektorë.²¹ Ndërkohë që në shtrirjen e parë organike QKSH-ja kishte një personel pedagogjik prej 9 (nëntë) vetësh, nga 47 që kishin dy fakultetet bashkë me QKSH-në.

Por pas një viti Akademia e Sigurisë riorganizohet sërish me urdhri nr. 180 datë 15.4.2016 të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për riorganizimin institucional të Akademisë së Sigurisë”, duke e bërë atë me dy njësi kryesore: Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit dhe, Kolegji profesional i lartë “Kolegji i Policisë”.

Ndërsa urdhri 491 datë 5.9.2016 “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 294 datë 5.6.2015 të ministrit të Punëve të Brendshme, “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”, të ndryshuar, Qendra e Kërkimit Shkencor ngelet si e tillë me të njëjtat funksione nën vartësinë e drejtorit të përgjithshëm të Akademisë së Sigurisë, por në këtë strukturë i është hequr sektori i përkthimeve dhe ka ngelur me shtatë vetë personel pedagogjik.²² Në organikën e shtatorit të vitit 2016 janë parashikuar: drejtori i QKSH-së: drejtues i parë; shefi i sektorit të kërkimeve shkencore: personel pedagogjik i kategorisë “Profesor” (prof. dr/prof. asc.), asistent lektor kryekomisar, asistent lektor (sociolog, psikolog, kriminolog); sektori i botimeve me shefin e sektorit të kategorisë “Profesor/Docent”, lektor redaktor shkencor me gradë shkencore “Doktor”, teknik shtypshkronje, dizajner/operator.

Në vijimësi edhe në vitin 2017 ka dalë një VKM nr. 370 datë 26.4.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit Profesional të Lartë”, si dhe gjithë veprimtaria e KLP bazohet në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, pika 17.²³ Në radhë kronologjike në vitin 2017 kemi një strukturë të re të Akademisë së Sigurisë bazuar në urdhrin nr. 288 datë 19.5.2017, “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”.²⁴

Por me këtë strukturë QKSH-ja e ruajti statuskuonë, me të njëjtën mision, funksion dhe detyra, pa ndryshuar struktura e saj si dhe përbërja e stafit, çka vërtetonte edhe qëndrueshmëri dhe produktivitet duke u bërë gjithnjë e më e njohur përballë të gjitha strukturave të shumta të ngritura dhe shkrirë në tre vite të AS-së me tre struktura të reja.²⁵ Në këtë periudhë shuma totale e AS-së ishte 162 vetë, nga të cilët për kërkimin shkencor kishte të angazhuar 7 personel pedagogjik ose 4.3% e efektivit të AS-së ishin angazhuar me Kërkimin shkencor në mënyrë të drejtpërdrejtë. Urdhër nr. 176 datë 13.3.2018, “Për disa ndryshime në urdhrin të MPB-së, nr. 288 datë 19.5.2017, “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”, të regjistruar me nr. 2225 datë 13.3.2018 të MPB-së, që lidhet vetëm me disa shkurtime në departamentin e ruajtjes dhe të sigurisë si dhe të Kolegjit Profesional të Lartë “Kolegji i Policisë”, që në fakt lidhet me numrin e punonjësve sipas njësive shpenzuese në Policinë e Shtetit, por nuk prek numrin e Qendrës së Kërkimit Shkencor të punonjësve kërkimorë shkencorë në Akademinë e Sigurisë.

Pas daljes së VKM-së 881 datë 28.10.2020, nga strukturat drejtuese Politiko-policore të MPB-së dhe Policisë së Shtetit është reflektuar me daljen e urdhrin nr. 385 datë 21.12.2021 i ministrit të Punëve të Brendshme, “Për miratimin e strukturës dhe organikës

²¹ Në organigramën e vitit 2015 Qendra Kërkimore Shkencore ka pasur Sektorin e Studimeve dhe të kërkimeve, Sektorin e Botimeve dhe Sektorin e Përkthimeve, Dok arkivuara, Organigrama e AS-së, 2015, faqe 4.

²² Në organigramën e vitit 2016 Qendra Kërkimore Shkencore ka pasur Sektorin e Kërkimeve Shkencore, Sektorin e Botimeve dhe Sektorin e Përkthimeve, Dok arkivuara, Organigrama e re e AS-së, 2015, faqe 4 dhe faqe 7.

²³ VKM nr. 370 datë 26.04.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit profesional të lartë”, Tiranë, 2017, faqe 3.

²⁴ Urdhëri i majit të vitit 2017 shfuqizoi Urdhërin nr. 294 datë 05.06.2015 të Ministrit të Punëve të Brendshme, “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë”, të ndryshuar”, sipas pikës 3.

së Akademisë së Sigurisë”, që pritet të hyjë në fuqi me fillimin e efekteve administrative “në përfundimin e vitit akademik 2021-2022” (pika 3). Por me këtë strukturë të re të Akademisë së Sigurisë ka një ndryshim thelbësor në vartësi.

Ndërkohë që QKSH-ja nga viti 2015 deri më 2022 ka qenë në vartësi të drejtpërdrejtë të rektorit të AS-së, pas tetorit 2022 QKSH-ja kalon në vartësi të dekanatit të Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit, duke u rikthyer me tre sektorë: sektori i kërkimit shkencor, sektori i botimeve dhe sektori i gjuhëve të huaja. Vartësia strukturore do të përcaktojë edhe vendin dhe rolin që do të luajë në vijimësi QKSH-ja në planin e kërkimit shkencor dhe realizimit në tërësi të misionit të kërkimit shkencor për Akademinë e Sigurisë. Në Lidhjen nr. 1 “Organika e Akademisë së Sigurisë”, që nga 7 bëhet me 10 personel pedagogjik (Shih faqe 3 e organikës së re).²⁶ Porë në këndvështrimin e vendit që zë në pikëpamje numerike QKSH-ja në AS është në masën 6.4%, ndërsa nëse përllogaritjen e bëjmë në FSH, nga 39 personel pedagogjik që është në total fakulteti 10 personel pedagogjik i ka QKSH-ja, pra 25.6% i përkasin Kërkimit shkencor, botimeve dhe sektorit të përkthimeve.

Në këtë formë organizimi për Akademinë e Sigurisë duhet fuqizuar shumë kërkimin shkencor në Fakultetin e Sigurisë dhe Hetimit është hera e parë që po aplikohet dhe pritshmëria e arritjeve do të jetë në fokus të zhvillimeve të ardhshme të Akademisë së Sigurisë, që me ritmet e punës për akreditim institucional, por edhe programeve institucionale të Akademisë së Sigurisë do të ketë rritje dhe zhvillim të qëndrueshëm dhe të konsoliduar, konsolidim që do ta sjellë në radhë të parë akreditimi institucional i AS-së sipas parametrave të kërkuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 824 datë 24.12.2021 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë”. Kërkimi shkencor si në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri ka faturë financiare, që nga viti 2015 e në vijimësi ka ngelur e njëjtë. Llogaritur në përqindje kërkimi shkencor në mënyrë të institucionalizuar është zë më vete në buxhetin e Akademisë së Sigurisë. Në mënyrë tabelore është në këtë mënyrë:

Nr.	Viti	Buxheti financiar i Akademisë së Sigurisë në total	Buxheti financiar i AS-së shprehur në përqindje	Buxheti për Kërkimin shkencor të institucionalizuar (QKSH)	Buxheti financiar i shprehur në përqindje
1	2015	303,780,562 lekë	100 %	3,756,180 lekë	1.236%
2	2016	254,626,293 lekë	100 %	4,469,340 lekë	1.75 %
3	2017	314,345,000 lekë	100 %	4,215,540 lekë	1.34%
4	2018	269,044,668 lekë	100 %	4,620,180 lekë	1.71%
5	2019	304,974,804 lekë	100 %	4,216,908 lekë	1.56 %
6	2020	266,314,567 lekë	100 %	4,128,180 lekë	1.55%
7	2021	268,425,000 lekë	100 %	4,556,180 lekë	1.69%
8	2022	257,983,300 lekë	100 %	4,556,180 lekë	1.77%

Akademia e Sigurisë zhvillon 76 programe mësimore, të akredituara të studimeve për ciklet e studimit në fushën e policimit, rendit dhe sigurisë publike si dhe programe të trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme me të gjithë aktorët e sigurisë në Shqipëri.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

«Kërkimi shkencor dhe siguria publike»

²⁵ Sipas Urdhërit të MPB-së, nr. 288 datë 19.05.2017, “Për miratimin e strukturës organike të Akademisë së Sigurisë” dhe organikës së AS-së bashkëlidhur urdhërit. Rregjistruar në drejtorinë e policisë së shtetit me nr.529/8 datë 19.05.2017; rregjistruar në MPB me nr. 500/18 datë 19.05.2017, (QKSH-ja: I/4;I/4.1; I/4.2, faqe 5.)

²⁶ Sipas Urdhërit nr. 385 datë 21.12.2021 i Ministrit të Punëve të Brendshme, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Akademisë së Sigurisë”, Tiranë, 2022, faqe 5 dhe faqe 10. Struktura e AS-së është firmosur gjithashtu nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Drejtues Madhor Gledis Nano, ku shuma totale e personelit në AS është 156 vetë.

Studimet për ciklin e parë dhe të dytë janë pjesë integrale e programeve të karrierës, por çdo program lidhshmëria me kërkimin shkencor është domosdoshmëri, për një të ardhme të sigurisë publike dhe policimit bashkëkohor në Shqipëri. Kërkimi shkencor për IAL sikurse është edhe AS-ja kërkon akreditim.²⁷ Hartimi i dokumentacionit për akreditimin institucional të AS-së është pasaporta e diturisë dhe vula e besueshmërisë institucionale, ndërkohë që edhe kërkimi shkencor është institucionalizuar. Akademia e Sigurisë gjatë veprimtarisë së saj ka hedhur hapa cilësorë, duke u shndërruar në një qendër mësimdhënëse cilësore, por njëherësh edhe studimore shkencore të evidentimit, studimit dhe përpunimit të mendimit bashkëkohor për policimin dhe sigurinë publike. Forcimi i lidhjeve dhe bashkëpunimi me institucionet shkencore të vendit dhe të huaja, ka mundësuar përmirësimin e kurrikulimit, duke e harmonizuar tematikën e programeve mësimore edhe me disa akademi homologe Perëndimore të policimit dhe sigurisë.

Në vijimësi është reformuar në strukturë, emërtim e në programet e procesit mësimor, në përputhje me misionin e saj nga periudha në periudhë, duke bërë që nga viti 2015 e në vijimësi të jetë solide si në strukturë edhe në produktivitet në fushën e kërkimit shkencor. Kërkimi shkencor i institucionalizuar dhe stacionuar plotësisht në Akademinë e Sigurisë është një ndër sfidat e ardhmërisë, por dhe nevojë për produktivitet dhe vlefshmëri bashkëpunimi me stafin mësimdhënës. Bazuar në standardet dhe kriteret e vlerësimit shkencor të konkretizuar në botime, artikuj shkencorë, revistë shkencore, projekte kërkimore, ku origjinaliteti, risia, metodologjia dhe rëndësia të maten me dobinë për sigurinë publike shqiptare.

Produkti i QKSH-së nga 2015 deri 2022. Qendra Kërkimore Shkencore (QKSH) është një ndër njësitë kryesore të Akademisë së Sigurisë, e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 185 datë 25.2.2015, “Për organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Sigurisë”. QKSH, gjatë kësaj periudhe, me kërkuesit e saj shkencor, ka realizuar 10 projekte kërkimore shkencore sipas kërkesës së Akademisë së Sigurisë, Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme në funksion të forcimit të Policisë së Shtetit, rendit dhe sigurisë publike në Shqipëri. Kërkimi shkencor i QKSH-së është i dukshëm përmes aktiviteteve në pjesëmarrje, bashkëpunim dhe prezantim me punime shkencore në shtatë konferenca ndërkombëtare shkencore të organizuara nga Universitete dhe institucione të tjera arsimore e kërkimore shkencore jashtë vendit. Në bashkëpunim me Universitete, e institucione të tjera kërkimore shkencore brenda e jashtë vendit, janë realizuar 5 konferenca shkencore ndërkombëtare me tematike të fushës së rendit e të sigurisë. Në bashkëpunim me Universitete e institucione të tjera kërkimore shkencore brenda, janë realizuar 2 konferenca shkencore kombëtare me tematike të fushës së rendit e të sigurisë.

QKSH-ja ka realizuar botime shkencore të njohura dhe me vlerë për Policinë e Shtetit. Nga viti 2015 janë përgatitur dhe botuar njëzetekatër numra të revistës “Policimi dhe siguria”, revistë periodike shkencore e Akademisë së Sigurisë, ndërkohë që puna vijon për të pasur vazhdimësi pune kërkimi shkencor dhe publikimesh në Akademinë e Sigurisë. Këto botime kanë pasur ndikim dhe kanë ngjallur interes jo vetëm në qarqet akademike dhe intelektuale në vend e rajon, por edhe në radhët e punonjësve të Policisë së Shtetit. Në këto botime, gjithnjë e më tepër, po publikojnë shkrimet e tyre studiues e kërkues shkencorë nga sektorë të ndryshëm të Policisë së Shtetit dhe jo vetëm. Përveç

²⁷ Fjala “Akreditim” rrjedh si origjinë nga anglishtja dhe nënkupton “procesin e njohjes zyrtare të një institucioni që plotëson standardet në ushtrimin e një aktiviteti”.

botimeve fizike (letër) të revistës “Policimi dhe siguria”, ka vazhduar publikimi i tyre edhe elektronik (*online*). Për këtë janë njoftuar të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit për të pasur qasje në to. Është përgatitur, miratuar dhe botuar fjalori shqip anglisht, me terminologjinë policore, në shërbim të punonjësve të policisë që janë në vijën e parë të kontaktit me të huaj që vijnë në Shqipëri. Fokus i kërkimit shkencor në fushën e sigurisë publike ka synuar fuqi, besueshmëri, produktivitet dhe ardhmëri. Kërkim zhvillimi në AS është gjithmonë në rritje dhe pjesë e prirjeve të vendeve më të zhvilluara evropiane, por edhe fushëveprimet bashkëpunues që QKSH-ja e ka mundësuar këtë për institucionin dhe mësimdhënien policore. Kërkimin shkencor në AS sikurse në gjithë IAL në vendin tonë, por dhe vendet më të zhvilluara të botës, bazë kanë arsimin e lartë dhe edukimin, si motor të inovacionit, konkurrencës dhe cilësisë e efektivitetit të mësimdhënies. Është dashur një kohë relativisht e gjatë për të “thërrmuar” mentalitetin, edhe pse kërkimi shkencor ka fituar qytetarinë dhe teza se: “nuk mund të ndahet edukimi nga kërkimi shkencor” dhe se kërkimi është një element i domosdoshëm dhe shumë karakteristik është gjithëpranuar.

Akademitë, universitetet, IAL-të konsiderohen gjithnjë e më shumë si institucionet më të përshtatshëm për zhvillimin e kërkimit shkencor, për dy arsye bazë: lidhja e drejtpërdrejtë e kërkimit shkencor me procesin e mësimi; dhe integrimi i kërkimit me një institucion që është më afër tregut të punës, që duam të themi edhe policimi është një treg pune. Kërkimi shkencor nuk mund e nuk duhet të bëjë pa komunikimin si dhe shpërndarjen e produktivitetit shkencor. “Komunikimi shkencor” shpjegon mënyrën se si hulumtuesit/kërkuesit mbasi kanë bërë kërkime, i publikojnë dhe i shpërndajnë rezultatet e kërkimeve, i vënë në dispozicion të kolegëve, komunitetit akademik e arsimor, madje edhe më gjerë. Në këtë proces hyjnë edhe të drejtat e autorit, procesi i shqyrtimit të artikujve nga departamentet, kolegët, burimet ekonomike të IAL, modelet e reja të publikimit sikurse është qasja e hapur (*open access*), e drejta e aplikimit për projektet, ruajtja e vlerave intelektuale të kërkuesve etj.

Kërkimi shkencor dhe produktiviteti i tij vazhdon të jetë një sfidë jo vetëm në AS por në të gjitha IAL në Shqipëri. Tendencat e futjes në agjendën e plotë institucionale të kërkimit shkencor në Shqipëri ka më shumë se një dekadë, që është në kërkim të rrugëve për produktivitetin dhe vlefshmërinë e kërkim zhvillimit tashmë në mënyrë të institucionalizuar, pa ja lënë më spontanitetit, apo vetëm departamenteve mësimorë. Një sfidë që fillon në piramidën e shtetit në Këshillin e Ministrave, MASR, vijon tek IAL-të, universitetet dhe akademitë. Në këtë aspekt është miratuar marrëveshje midis qeverisë së Shqipërisë dhe BE-së, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programin e “Horizon Union”, me fokus kërkimin shkencor dhe inovacionin. Sfidë shqiptare lidhet sot edhe me kërkimin shkencor dhe inovacionin për zhvillimin e qëndrueshëm, ku BE synon të krijojë një zonë të përbashkët, për kërkimin shkencor dhe inovacionin duke nxitur e promovuar bashkëpunimin midis universiteteve, apo institucioneve të kërkimit shkencor si dhe për të promovuar lirinë akademike dhe kërkimit shkencor.

MASR paguan një tarifë vjetore, në mënyrë që të gjitha institucionet tona të arsimi të lartë, apo ato kërkimore shkencore, të kenë mundësi që të marrin pjesë dhe të konkurrojnë me projekte të përbashkëta me institucionet e BE-së. Sfidë shqiptare është përthithja e fondeve në raport me kontributin financiar që paguajmë. Konkurrenca është e lartë pasi universitetet dhe akademitë shqiptare konkurrojnë drejtpërdrejtë me universitetet apo institucionet shkencore evropiane. Ekspertiza është domosdoshmëri për të rritur kapacitetet shqiptare për hartimin e projekteve. Ndërkombëtarizimi duke

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

«Kërkimi shkencor dhe siguria publike»

bashkëpunuar me IAL të Evropës në drejtim të organizimit të konferencave të përbashkëta apo në punë kërkimore shkencore.

Në Akademinë e Sigurisë sfida dokumentare dhe puna konkrete për realizimin e misionit të kërkimit shkencor është e lidhur me produktivitetin, me marrëdhëniet e ngushta dhe bashkëpunimin me stafin mësimdhënës të Fakultetit të Sigurisë dhe Hetimit si dhe Kolegjin e Lartë Profesional të Policisë nën vartësinë e Akademisë së Sigurisë. Mbi njëzetë marrëveshje bashkëpunimi dhe dritare të hapura të reja që e bëjnë institucionin e Akademisë së Sigurisë një institucion të hapur e bashkëpunues në interes të plotësimit të misionit edhe pse kërkimi shkencor është sfidë themelore për ta bërë atë një trend në rritje dhe zhvillim, për tu bërë më atraktivë dhe rezultativë që produktet e saj të jenë, të ngelen dhe të përsosen si kontribut për ngritjen cilësore të arsimit profesional policor dhe të krejt fushës së sigurisë publike në Shqipëri. Këtu nuk bëhet fjalë thjesht për të plotësuar misionin në mënyrë shabllone por për të gjetur rrugë dhe hapësira që kërkimi shkencor të jetë një vlerë e përhershme e institucionalizuar dhe e racionalizuar që me strukturën aktuale dhe mundësisht të bashkimit me QKSH edhe të një sektori/zyre për projektet, të bëjë të mundur që Akademia e Sigurisë pas akreditimit të bëhet edhe më e njohur dhe më prezent në fushën e kërkimit shkencor në rang kombëtar, rajonal, pse jo edhe në atë evropian.

Diskutimet dhe tendencat që QKSH-ja në AS të mundësohet dhe të kthehet në Institut Kërkimor Shkencor bazohet pikërisht në veprimtarinë shtatëvjeçare të suksesshme të QKSH-së si e para njësi strukturore e kërkimit shkencor në AS për vetë produktivitetin në Konferenca shkencore kombëtare e ndërkombëtare, në publikim revistash, në pjesëmarrje të stafit të saj në konferencat kombëtare që organizojnë institucionet më prestigjioze të vendit, në përfundime e rekomandime të vlefshme për legjislativin, Ministrinë e Brendshme dhe Policinë e Shtetit. Trendi bashkëkohor rajonal, evropian dhe botëror në çështjet e sigurisë publike dhe policimit shkon në përputhshmëri të plotë dhe është në rritje dhe vlerësim për të garantuar siguri publike. Projektet e binjakëzimit kanë hapur dritare të reja dhe kanë sjellë shembuj në Shqipëri që janë të prekshëm dhe konkretë në fushën e sigurisë publike, edukimit policor dhe sidomos të kërkimit shkencor. Përvoja shqiptare ka vërtetuar se decentralizimi institucional i njërive të kërkimit shkencor e ka ulur vlerën kërkimore-shkencore dhe produktiviteti ka qenë jo gjithmonë efektiv.

Kontributi i drejtpërsëdrejti i kërkuesve shkencorë në mësimdhënie e ka rritur efektivitetin e kërkimit shkencor. Kjo është vërtetuar edhe në Akademinë e Sigurisë ku gjithë stafi i QKSH-së është i përfshirë në mësimdhënie, pra kërkimi shkencor nuk ka qenë kurrë i shpëputur nga procesi mësimor. Shqipëria ka dy Akademi në spektrin të Sigurisë (AS) dhe të Mbrotjtjes (AFA), ku njëra prej tyre AFA ka krijuar Institutin Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU) me 64 anëtarë,²⁸ që ka nisur rrugëtimin e kërkimit shkencor me një trend të ri rritës në strukturë, buxhetim dhe vlerësim, ndërsa QKSH-ja në Akademi të Sigurisë me strukturën e re ja kanë ndryshuar drejtimin strukturor dhe e ka lënë me të njëjtin numër pavarësisht pozicionimit në strukturën e re të AS-së. Kërkesa për një sektor projektsh e rekomanduar edhe nga specialistët finlandezë dhe estonezë të projektit

²⁸ Bazuar në VKM Nr 156, datë 19.02.2020, "Për dhënie të statusit të veçantë AFA-së".

²⁹ Më 26.04.2022 u zhvillua konferenca shkencore ndërkombëtare "Kërkimi shkencor dhe siguria publike", në ambientet e "Xheko Imperial Hotel", nga Akademia e Sigurisë, në bashkëpunim me Projektin e Binjakëzimit të financuar nga BE, "Për forcimin e kapaciteteve dhe efikasitetit të Akademisë së Sigurisë", me pjesëmarrje ekspertësh nga Shqipëria, Kosova, Finlanda dhe Estonia.

të Binjakëzimit është një rekomandim i bazuar në nevojat aktuale dhe perspektive të Akademisë së Sigurisë²⁹ që pas procesit të akreditimit institucional të realizojë misionin, edhe përmes projekteve të nivelit kombëtar e ndërkombëtar të fushës së sigurisë publike e policimit me qëllim që të rritë vlefshmërinë e produktivitetin në uljen e kriminalitetit. Institucionalizimi dhe debati për raportin e kërkimit shkencor në funksion të sigurisë publike i shërben forcimit të përgjithshëm institucional të së ardhmes së qëndrueshme, për të krijuar një institucion të edukimit policor në nivelin evropian, të mbështetur fuqimisht nga Qendra e Kërkimit Shkencor. Këtu qëndron edhe gurmtheli i zhvillimit të konkurrencës edhe në kërkim që lidhet me cilësinë e sistemit të arsimit në fushën e sigurisë, duke prodhuar më shumë siguri publike, integritet, sinergji që në mijëvjeçarin e tretë, në shekullin XXI, IAL të plotësojë nevojat për “fuqi punëtore të specializuar” të fushës së sigurisë publike.

Burimet

1. Periodiku i Revistës teoriko-shkencore “Policimi dhe Siguria”, Tiranë, 2015-2022.
2. Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave, Shtëpia Botuese “Kristalina KH”, Tiranë, 2009.
3. Buletini Arkivor Ushtarak, Nr.1/Mars 2011 dhe 2./Qershor 2011.
4. Gazeta “Atdheu”, publikuar më Nr. 12 datë 25.5.1913.
5. Teki Selenica, “Shqipëria në vitin 1927”, Tiranë, 1928.
6. Akte Juridike të arsimit të lartë veçanërisht të Fushës së Sigurisë dhe Mbrojtjes;
7. Urdhërat e Ministrave të Brendshëm për miratimin e strukturave organike të AS-së;
8. Vendim të Këshillit të Ministrave nr.200 datë 30.07.1979, “Për dhënien e titujve shkencorë kuadrove ushtarakë”;
9. VKM nr. 370 datë 26.04.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e Kolegjit profesional të lartë”, Tiranë, 2017;
10. Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, <https://www.geo.edu.al/skedaret/ligji-ri-arsimit.pdf>; <http://isiknowledge.com>;
11. Fletore Zyrtare nr.44/v.1938; AQSH “Akademi e Policisë “Arben Zylyftari”, Tiranë, 2002, f.13.
12. Vendim i Byrosë Politike të KQP me atributet e Këshillit të Mbrojtjes së Republikës Nr. 136, më datë 10.05.1958;
13. Fondit dokumentar të MPB-së, Dosja nr.2/48, viti 1945, sipas Protokoll nr 961/1 datë 1 tetor 1945;
14. AQSH, Fondi dokumentar nr. 200, Viti 1940, Dosja 10;
15. DP e AQSH, Fondi dokumentar nr. 200, Viti 1941, Dosja nr 4.
16. Referime në Konferenca shkencore ndërkombëtare “Kërkimi shkencor dhe siguria publike”, Tiranë, 26.4.2022.
17. Urdhërat të Ministrave të Brendshëm për strukturat organike të Akademisë së Sigurisë të ngritura me urdhër të MPB-së nr. 294 datë 5.6.2015; urdhër të MPB-së nr. 91/4, datë 5.6.2015; urdhër të MPB-së nr. 491 datë 5.9.2016; urdhër të MPB-së nr. 288 datë 19.5.2017; urdhër të MPB-së nr. 176 datë 13.3.2018; urdhër të MPB-së nr. 385 datë 21.12.2021.

AKADEMIA E SIGURISË

Konferencë shkencore ndërkombëtare:

«Kërkimi shkencor dhe siguria publike»



~ *Sesioni II* ~

Kërkimi shkencor dhe siguria publike
(këndvështrimi dhe përvoja finlandeze)

Kërkim, zhvillim dhe inovacion në Kolegjin Universitar të Policisë (POLAMK)



Dr. Vesa MUTTILAINEN

Shef i sektorit të kërkimit shkencor, Kolegji Universitar i Policisë, Finalndë (POLAMK)

1. Prezantimi

Identiteti i dyfishtë i Kolegjit Universitar të Policisë (POLAMK) si një njësi policore kombëtare dhe një institucion i arsimit të lartë i jep Kolegjit një status dhe mision unik midis institucioneve finlandeze të arsimit të lartë. Ky rishikim përshkruan aktivitetet e Kolegjit për kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin (KZHI), duke u fokusuar në disa këndvështrime strategjike, mundësi financimi dhe tema të projektit. Rishikimi është një version i përditësuar i artikujve të mëparshëm për të njëjtën temë (Mutttilainen & Houtsonen 2018 dhe 2021).

2. Pikëpamjet strategjike

Ligji për Kolegjin Universitar të Policisë (1164/2013, seksioni 2) përcakton se një detyrë statutorë e kolegjit është “të angazhohet në kërkimin dhe zhvillimin e aplikuar, duke i shërbyer planifikimit dhe zhvillimit të policisë dhe sigurisë së brendshme, si dhe arsimit në Kolegjin Universitar të Policisë. “ (Figura 1).



Figura 1. Mandati ligjor i aktiviteteve të KZHI në POLAMK

Udhëzimet e KZHI (2020) specifikojnë detyrat statutores. Ata synojnë 1) të prodhojnë kërkime dhe inovacione në një mënyrë afatgjatë për zhvillimin e një shoqërie të sigurt dhe të drejtë, 2) të ndërtojnë një bazë njohurish për edukimin policor dhe ekspertizën policore, dhe 3) të jenë një kolegji universitar i shquar dhe ndërkombëtar dhe një partner projekti në sektorin e sigurisë. Udhëzimet e KZHI theksojnë qasjet largpamëse, bashkëpunimin e brendshëm, partneritetet solide dhe përgjegjësinë sociale.

Aktivitetet e KZHI përfshijnë kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin, të tilla si projekte KZHI, publikime, analiza, teza dhe projekte studentore (shih Kërkim dhe zhvillim 2021). Ato përfshijnë gjithashtu përpilimin dhe prezantimin e historisë së policisë, aktivitete të caktuara të CEPOL-it, projekte për ndërtimin e kapaciteteve dhe disa pjesë të shërbimeve arsimore të bazuara në tarifa. Mbi 30 ekspertë me kohë të plotë të punësuar në pozicionet e KZHI korrespondojnë me rreth 15 përqind të ngarkesës së kolegjit. Gati gjysma e këtyre ekspertëve janë duke punuar në projekte KZHI bazuar në financimin thelbësor buxhetor ose financimin e jashtëm nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare.

Një perspektivë e bazuar në kërkim, financimi kombëtar dhe qasje sociologjike dhe kriminologjike karakterizuan profilin e aktiviteteve të KZHI në POLAMK deri në fillim të viteve 2010. Që kur u shfaq, aspektet kanë përfshirë një perspektivë më jetike zhvillimore, dimension teknologjik, financim ndërkombëtar dhe një qasje shumëdisiplinore (FINEEC 2018; projektet KZHI 2021).

Aktualisht, operacionet e projektit në POLAMK përbëhen nga projekte kërkimore dhe projekte të fokusuar në zhvillim dhe inovacion. Zakonisht, të dyja qasjet mund të përfshihen në të njëjtin projekt. Projektet e orientuara nga kërkimi synojnë të publikojnë rezultatet e kërkimit në forume shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare dhe në forume të tjera. Projektet e orientuara drejt zhvillimit prodhojnë gjithashtu rezultate të

**AKADEMIA
E SIGURISË**

*Konferencë
shkencore
ndërkombëtare:*

«Kërkimi
shkencor dhe
siguria publike»

ndryshme nga publikimet, p.sh., testet e teknologjive, mjetet e vlerësimit të rrezikut ose materialet edukative.

3. Aktivitetet e KZHI me pak fjalë

Të dhënat empirike, të tilla si regjistrat, anketat dhe materialet e intervistave në projekte që theksojnë kërkimin, përdoren zakonisht. Disa nga këto projekte lejojnë përsëritjen e një dizajni kërkimor të krijuar më parë. Projektet e mëposhtme sasiore përsëriten rregullisht dhe bazohen kryesisht në financime thelbësore nga buxheti i shtetit (Tabela 1).

Tabela 1. Shembuj të projekteve të përsëritura të orientuara nga kërkimi

Projekti	Përmbajtja	Shpeshtësia
Barometri i personelit policor	Anketa për punonjësit e policisë për mirëqenien në punë	Një herë në 3-4 vjet
Barometri i policisë	Një sondazh qytetar mbi aktivitetet e policisë dhe sigurinë e brendshme	Dy vjetore
Efektiviteti i arsimit policor	Vlerësimet e arsimit në nivel diplome bazuar në mendimet e studentëve dhe materialet të tjera	Vjetore/dy vjetore
Përdorimi i forcës	Karakteristikat e situatave të përdorimit të forcës në dosjet e policisë	Vjetore
Krimet e urrejtjes	Karakteristikat e rasteve të krimeve të urrejtjes në dosjet e policisë	Vjetore
Krimi i korrupsionit	Karakteristikat e rasteve të krimit të korrupsionit në dosjet e policisë	Një herë në 4-5 vjet
Ambienti operativ i policisë	Koleksione artikujsh me tema të ndryshme që lidhen me policinë dhe sigurinë e brendshme	Vjetore

Shumë projekte të veçanta afatshkurtra përfaqësojnë gjithashtu një qasje të bazuar në kërkime. Vitet e fundit, këto projekte janë realizuar me tema si krimi i urrejtjes, imigracioni, krimi kibernetik, pastrimi i parave, krimi mjedisor, korrupsioni, trafikimi i qenieve njerëzore, dhuna në familje, krimet ndaj fëmijëve, elasticiteti, gatishmëria për kriza dhe kërcënime, barazia gjinore, dhe siguria në trafik. Gama e temave të projekteve të KZHI është plotësuar nga koleksionet e artikujve mbi mjedisin operativ të policisë (p.sh., Muttillainen & Huotari 2018; Huotari 2021).

Përveç këtyre temave, POLAMK kujdeset për studentët e doktoraturës që përgatisin disertacionet e tyre universitare duke ofruar lehtësira. Zakonisht, këta studentë mbështeten me financime nga fondacione të ndryshme. Gjithashtu, disa anëtarë të stafit aktualisht janë në proces doktorature.

Marrja e fondeve shtesë është kthyer në një zgjedhje të shkëlqyer strategjike. Në vitet e fundit, financimi i jashtëm për projektet e kërkimit dhe zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve ka qenë rreth 1.5 milionë euro në vit. Ky financim ka bërë të mundur punësimin e stafit të KZHI me afat të caktuar për zbatimin e projekteve. Më poshtë janë renditur projektet më të rëndësishme të kohëve të fundit, në vazhdim ose të ardhshëm bazuar në financimin e BE-së dhe financime të tjera të jashtme (Tabela 2).

Projekti	Përmbajtja	Financimi
Binjakëzimi i Shqipërisë	Forcimi i Kapaciteteve dhe Efikasitetit të Akademisë së Sigurisë - Shqipëri	Binjakëzimi i BE-së
ARICA	Vlerësimi i treguesve të riskut të abuzimit seksual të fëmijëve	BE ISF-P
BuildERS	Ndërtimi i qëndrueshmërisë dhe kapitalit social të komuniteteve evropiane	Horizont i BE-së 2020
IMPROVE	Përmirësimi i aksesit në shërbime për viktimat e dhunës në familje	EU Horizon Europe
FERMI	Zbutës i riskut të lajmeve të rreme	EU Horizon Europe
Procsead	Parandalimi i abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në Darknet	KB
Kyber-Eop	Ofrimi i arsimit të synuar për nëpunësit civilë të angazhuar në parandalimin e krimit kibernetik	BE ISF-P
Movi	Krijimi i modeleve të politikave për policinë për të mbështetur menaxhimin e planifikuar të veprimeve me shumë autoritete	MPB, Finlandë
Cepol	Agjencia e Bashkimit Evropian për Aktivitetet e trajnimit të Agjencive të Zbatimit të Ligjit	BE
Digital Twin	Modelimi 3D i zonës së trajnimit në POLAMK	MPB, Finlandë
Virvotieto	Shkëmbimi vullnetar i informacionit ndërmjet autoriteteve	Qeveria finlandeze
Proosa	Zhvillimi i kompetencës së projektit në degën administrative të Ministrisë së Brendshme	MPB, Finlandë
Digniteas	Sfidat në ndërhyrjen në dhunën digjitale ndaj grave në punën e policisë, procedurat penale dhe shërbimet mbështetëse	Qeveria finlandeze
Viesti	Modelet ndërkombëtare të komunikimit publik të policisë dhe shfrytëzimi i tyre në Finlandë	MPB dhe NPB, Finlandë

Tabela 2. Projektet më të rëndësishme me financim të jashtëm 2022

Financimi i projektit nga Ministria e Brendshme ose Bordi Kombëtar i Policisë ka mundësuar tradicionalisht aktivitetet e projekteve kombëtare. Megjithatë, siguri i një financimi të tillë ka rënë gjatë zvogëlimit të burimeve të administratës publike dhe krijimit të instrumenteve të reja të financimit ndërsektorial. Kjo është arsyeja pse financimi i jashtëm ndërkombëtar ka dalë të jetë gjithnjë e më kritik për POLAMK.

